

SEKSIONI I TRETË
Çështja XHOXHAI k. SHQIPËRISË
(Aplikimi nr. 15227/19)

VENDIM

Neni 6/1 (aspekti civil) - Organe të ngritura për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të luftuar korrupsionin, që përbëjnë gjykata të pavarura dhe të paanshme të ngritura me ligj. - Masa mbrojtëse të mjaftueshme. - Mospërfaqësimi i gjyqtarëve në detyrë në përputhje me natyrën dhe frymën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit, shoqëruar me kërkesa ligjore strikte për zgjedhëse. - Rishikim i plotë i juridiksionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Neni 6/1 (aspekti civil) - Proces i rregullt. - Mungesë të kufizimeve me ligj sa i takon vlerësimit të pasurisë, duke mos shkelur mbi parimin e sigurisë ligjore, duke pasur në konsideratë natyrën dhe kontekstin e saj *sui generis*.

Neni 6/1 (aspekti civil) - Proces i rregullt. - Informacioni i duhur, koha e mjaftueshme dhe lehtësira në përgatitjen e mbrojtjes në bazë të vlerësimit dhe arsytimit të mjaftueshëm për vendimin e dhënë nga trupa gjykuese të rivlerësimit. - Natyra e procesit nuk kërkon shqyrtimin në seancë publike të ankimit.

Neni 8 - Jeta private. - Shkarkim i justifikuar i gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese, bazuar në gjetjet nga vlerësimi i pasurisë. - Përjashtimi proporcional nga rihyrja në sistemin e drejtësisë për shkelje të rënda etike.

STRASBURG

9 shkurt 2021

Vendimi do të marrë formë të prerë sipas dispozitës së nenit 44/2 të Konventës. Ai mund t'u nënshtrohet redaktimeve gjuhësore.

Në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i tretë), si një Kolegj i përbërë nga:

Paul Lemmens, *kryetar*

Georgios A. Serghides,

Dmitry Dedov,

Georges Ravarani,

Maria Elósegui,

Darian Pavli,

Peeter Roosma, *gjyqtarë,*

dhe Milan Blaško, *sekretar,*

duke pasur parasysht:

aplikimin me nr. (nr. 15227/19) kundër Republikës së Shqipërisë, u depozitua në Gjykatë bazuar në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetase shqiptare, znj. Altina Xhoxhaj (“kërkuesja”), më datë 8 mars, 2019;

vendimin për njoftimin e aplikimit qeverisë shqiptare (“Qeveria”);

parashtrimet me shkrim mbi pranueshmërinë dhe themelin, të paraqitura nga qeveria dhe kërkuesja;

komentet e palëve të treta të marra nga Komisioni Evropian dhe Respublica, të cilave u ishte dhënë leje nga kryetari për të bërë ndërhyrje me shkrim (neni 36/2 i Konventës dhe rregulli 44/3);

Pas diskutimeve me dyer të mbyllura, më 15 dhjetor 2020 dhe më 19 janar 2021,

Jep vendimin e mëposhtëm, i miratuar në datën e përmendur më të fundit:

HYRJE

1. Kjo çështje ka të bëjë me përfundimin e procesit të rivlerësimit (referuar ndryshe si “veting”) kundër kërkueses, që çoi në shkarkimin e saj nga posti i gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese. Ajo

është pjesë e një sërë aplikimesh të depozituara pranë Gjykatës që kanë ngritur çështje të ngjashme faktike dhe ligjore sipas neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës.

FAKTET

2. Kërkuesja ka lindur në vitin 1970 dhe adresa e saj në formularin e aplikimit jepet sikur është në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kërkuesja u përfaqësua nga z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë me seli në Romë.

3. Qeveria u përfaqësua nga agjenti i saj, z. A. Metani, dhe më pas nga znj. E. Muçaj nga Avokatura e Shtetit.

I. KONTEKSTI I ÇËSHITJES

4. Në vitin 2014 u krijua një komision parlamentar *ad hoc*, i cili do të ishte përgjegjës për reformën në sektorin e drejtësisë. Më pas, ai miratoi një raport mbi vlerësimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri (“Raporti i Vlerësimit”). Raporti i Vlerësimit iu referua një numri sondazhesh të opinionit publik dhe anketave të kryera për gjykatat për vitet 2009 dhe 2015, sipas të cilave kishte një perceptim të gjerë publik se sistemi i drejtësisë ishte i mbytur nga korrupsioni, ndikime të jashtme të parregullta, mungesa të praktikave transparente ligjore, procedura tepër të gjata dhe mosekzekutim i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Sipas opinionit publik, disa gjyqtarë dhe prokurorë duhej të paguanin ryshfet për t’u emëruar ose transferuar në pozicione të lira në kryeqytet ose në qytete të tjera të mëdha. Të dhënat jozyrtare treguan se cikli i pagimit të ryshfeteve – kryesisht me përfshirjen e një “ndërmjetësi”, të tillë si një anëtar i familjes, një mik apo avokat ishte i përhapur mes aktorëve kryesorë, siç janë oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe gjyqtarët. Si pasojë, kjo kishte penguar dhënien e drejtësisë: oficerët e korruptuar të policisë gjyqësore merrnin ryshfet në mënyrë që të shkatërronin provat në skenën e krimit, prokurorët e korruptuar pranonin pagesa për të shmangur fillimin e procedimeve penale ose ngritjen e akuzave, dhe gjyqtarë të korruptuar vononin mbajtjen e seancave ose kushtëzonin dhënien e vendimeve me marrjen e ryshfeteve. Niveli i ulët i profesionalizmit i demonstruar nga palët kryesore të sistemit të drejtësisë ishte i dukshëm, ashtu si edhe dështimi i sistemit arsimor në fushën ligjore për të formuar qytetarët, për t’i njohur ata me të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore dhe për rëndësinë e njohjes dhe respektimit të ligjit. Raporti i Vlerësimit iu referua, gjithashtu, një numri raportesh monitorimi të kryera nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kishin vënë theksin te probleme të ndryshme që prekin sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

5. Raporti i Vlerësimit shërbeu si gur themeli për përgatitjen dhe miratimin e një strategjie për reformën e sistemit të drejtësisë (“Strategjia e Reformës”) që kishte si qëllim, midis të tjerave: i. përmirësimin e sistemit për zbulimin dhe verifikimin e pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe konfliktin e interesit për të identifikuar rastet e përvetësimit të pasurive të paligjshme; ii. futjen e dispozitave ligjore që e bëjnë të detyrueshëm verifikimin e hollësishëm të pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe konfliktin e interesit përpara marrjes së tyre në detyrë; iii. rritjen e transparencës për zbulimin e pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke mundësuar përfshirjen e aktorëve të tjerë (të tillë si publiku dhe shoqëria civile) në sigurimin e informacionit, fakteve dhe të dhënave të tjera që do të lehtësonin verifikimin e tyre; dhe iv. kërkesa me ligj e inicimit të procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për fshehje apo deklarim jo të plotë të pasurive, si dhe konflikt interesi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

6. Si rezultat i Strategjisë së propozuar të Reformës, në vitin 2016 u ndryshua Kushtetuta dhe u miratuan një sërë ligjesh thelbësore, një prej të cilëve ishte ligji i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i referuar ndryshe si ligji nr. 84/2016. Për qëllimet e këtij vendimi, termat “ligji i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe “ligji nr. 84/2016” kanë kuptim të njëjtë. Po kështu, termat “proces/procedura të vetingut” dhe “procesi/procedurat e rivlerësimit” përdoren në mënyrë të njëjtë.

7. Procesi i rivlerësimit të cilit do t’i nënshtroheshin të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë do të kryhej nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në shkallën e parë dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në apel, që do të rivlerësonte tri kritere, përkatësisht: vlerësimin e pasurive, kontrollin e integritetit të figurës për të zbuluar lidhje me krimin e organizuar dhe vlerësimin e aftësive

profesionale. Të gjithë personat që do të verifikoheshin, u kërkohej nga ligji të paraqisnin tri deklarata të veçanta, të bashkëngjitura ligjit nr. 84/2016, në lidhje me secilin kriter rivlerësimi.

II. RRETHANAT E ÇËSHTJES

8. Faktet e çështjes, siç janë parashtruar nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë.

9. Karriera gjyqësore e kërkueses filloi në muajin mars 1995, kur ajo u emërua në pozicionin e gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Në vitin 2006, ndërsa vazhdonte të punonte si gjyqtare, ajo u zgjodh anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organi përgjegjës për emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të gjykatave të rrethit dhe apelit, si dhe përfundimin e shërbimit të tyre, ku ajo shërbeu për katër vjet. Më datë 25 maj 2010, ajo u emërua si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, për një mandat nëntëvjeçar të parinovueshëm.

10. Në përputhje me ligjin për deklarimin e pasurive, kërkuësja paraqiti deklaratat vjetore të pasurisë mes viteve 2003 dhe 2016, ashtu si dhe bashkëjetuesi i saj, i cili ishte një nëpunës civil.

A. Procesi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

11. Në përputhje me ligjin nr. 84/2016, kërkuësja paraqiti deklaratën e pasurisë. Ajo dhe bashkëjetuesi i saj deklaruan se kishin në pronësi tri prona: i. një apartament me sipërfaqe 101 m² të përfituar nëpërmjet një kontrate sipërmarrjeje të nënshkruar më datë 8 mars 2005 dhe të regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në muajin dhjetor 2011 pas nënshkrimit të kontratës së shitjes; ii. një apartament me sipërfaqe 59 m² i blerë më datë 5 tetor 2010 (kontratë sipërmarrjeje datë 5.10.2010); dhe iii. një truall me sipërfaqe 221,9 m². Të dy bënë përshkrime të detajuara të burimit të të ardhurave, si dhe të kursimeve të tyre. Kërkuësja deklaroi, gjithashtu, se kishte llogari bankare në Shtetet e Bashkuara, të cilat ishin hapur në vitet 2015 dhe 2016. Ajo ka dorëzuar, gjithashtu, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin e vetëvlerësimit profesional (shih paragrafët 133 dhe 134 më poshtë).

1. Hetimi administrativ

12. Më datë 14 nëntor 2017, duke qenë se kërkuësja ishte në listën e personave me prioritet për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, pasi ajo ishte gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (KPK) vendosi të kryejë një hetim të thelluar administrativ për të tria deklaratat e plotësuara nga ana e saj.

13. Më datë 30 nëntor 2017 u hodh shorti në KPK-në për përbërjen e trupës gjyqësore prej tre anëtarësh dhe ndërkohë u njoftua edhe kërkuësja.

14. Ndërmjet datave 15 dhjetor 2017 dhe 5 mars 2018, KPK-ja i kërkoi kërkueses t'i përgjigjej një numri të detajuar pyetjesh. Ajo u përgjigj ndërmjet datave 26 dhjetor 2017 dhe 6 mars 2018.

15. Më datë 19 mars 2018, KPK-ja, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, informoi kërkuesen për përfundimin e hetimit administrativ dhe i paraqiti asaj gjetjet përkatëse paraprake, përfshirë dokumentet që kishin shërbyer si bazë për ato gjetje. Në veçanti, në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m², gjetjet theksuan: i. se kishte mospërputhje në lidhje me burimin e të ardhurave që ishin përdorur për të blerë apartamentin, kur krahasohej deklarata e pasurisë e vitit 2005 dhe deklarata e rivlerësimit, dhe në lidhje me mjetet me të cilat ajo ishte krijuar, në veçanti, ekzistencën e një kontrate sipërmarrjeje të lidhur në vitin 2003; dhe ii. që kishte mungesë të dokumenteve mbështetëse në lidhje me burimin e fondeve që ishin përdorur për të blerë apartamentin. Sa i përket situatës financiare të kërkueses (likuiditetet), gjetjet theksuan se ajo nuk kishte pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në vitet 2007, 2009 dhe 2015 për të justifikuar sasinë e tepërt të likuiditeteve. Për sa i përket truallit me sipërfaqe 666 m², të cilin ajo e kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, por nuk e kishte përfshirë në deklaratën për rivlerësim, gjetjet theksuan se kishte mospërputhje në lidhje me pjesën e saj takuese në atë truall. Për më shumë, asaj iu kërkua të jepte shpjegime në lidhje me një ankesë të bërë nga një individ në lidhje me dështimin e saj për të hequr dorë nga shqyrtimi i një ankese kushtetuese.

16. Sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, KPK-ja i kaloi barrën e provës kërkueses, e cila kishte njëzet ditë kohë për të paraqitur argumente në mbështetje të mbrojtjes së saj. Ajo, gjithashtu, u njoftua për të drejtat e saj sipas neneve 35–40 dhe 45–47 të Kodit të Procedurës Administrative, përfshirë të drejtën për t'u njohur me dosjen e çështjes, për paraqitjen e provave shtesë dhe thirrjen e dëshmitarëve.

17. Më datë 21 mars 2018, kërkuesja bëri një kërkesë për t'u njohur me dosjen e saj, duke kërkuar informacion në lidhje me metodologjinë e përdorur për të përllogaritur shpenzimet e bëra gjatë udhëtimeve të saj jashtë vendit. KPK-ja u përgjigj përkatësisht në datat 23, 27 dhe 30 mars 2018. Më tej, që nga data 6 janar deri më 5 dhjetor 2017, organet ndihmëse të cilat ishin autorizuar nga ligji nr. 84/2016 për të ndihmuar organet e rivlerësimit, përkatësisht Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit ("ILDKPKI"), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ("DSIK") dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ("IKLD"), ishin shprehur në favor të deklarimeve të kërkueses.

18. Më datë 7 prill 2018, kërkuesja parashtroi argumente të shumta, si dhe prova në mbështetje të mbrojtjes së saj.

19. Më datë 16 prill 2018, pas parashtrimeve të kërkueses, KPK-ja i kërkoi asaj të paraqesë informacion shtesë, në mënyrë që të përcaktoheshin rrethana të caktuara faktike.

20. Më datë 17 prill 2018, KPK-ja informoi kërkuesen se në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 do të mbahej një seancë publike. Ajo, gjithashtu, u informua për të drejtat e saj sipas neneve 35–40 të Kodit të Procedurës Administrative. Seanca publike u zhvillua më datë 23 prill 2018. Kërkuesja, e cila u përfaqësua nga mbrojtësi i saj, bëri parashtrime të mëtejshme me shkrim dhe verbalisht.

21. Më datë 25 prill 2018, KPK-ja shtyu seancën pa marrë një vendim për çështjen e kërkueses, në mënyrë që të kishte më shumë kohë për të shqyrtuar provat shtesë që ajo kishte paraqitur me *e-mail* më datë 18 prill 2018 dhe i kishte vënë në dispozicion në seancë.

2. Vendimi i KPK-së

22. Më datë 4 qershor 2018, KPK-ja, duke pasur parasysh raportet e paraqitura nga organet ndihmëse, provat e tjera me shkrim që kishte marrë gjatë hetimit administrativ, parashtrirat e bëra në përgjigje nga kërkuesja dhe dy ankesat e bëra nga publiku, dha vendimin e tij të arsyetuar në çështjen e kërkueses. Dispozitivi i tij ishte bërë publik më datë 3 maj 2018.

a) Gjetjet sa i takon vlerësimit të pasurisë

i. Sa i takon apartamentit me sipërfaqe 101 m²

23. KPK-ja, pasi shqyrtoi provat në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m² që i përkiste kërkueses dhe bashkëjetuesit të saj, konstatoi që "*në lidhje me ligjshmërinë e burimit të deklaruar të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, deklarim të rremë dhe fshehje të të ardhurave*".

24. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, KPK-ja konstatoi se ekzistonte një mospërputhje midis deklaratës së rivlerësimit të pasurisë së kërkueses dhe deklaratës së pasurisë së bashkëjetuesit të saj të depozituar në vitet 2003 dhe 2005 në lidhje me burimin e të ardhurave që ishte përdorur për blerjen e pasurisë. Në deklaratën "veting", kërkuesja deklaroi se burimi i të ardhurave, i përdorur për blerjen e apartamentit, kishin qenë të ardhurat e bashkëjetuesit të saj nga punësimi fitimprurës në Itali dhe paratë e bursave të përfituara nga ai. Ndërsa në deklaratat e pasurisë së bashkëjetuesit të saj, të depozituar në vitin 2005, ai kishte deklaruar për herë të parë se apartamenti ishte blerë me të ardhurat e shitjes së një banese tjetër me sipërfaqe 93 m², si dhe nga kursimet vjetore. Në deklaratën e tij të pasurisë, të depozituar në vitin 2003, ai deklaronte se apartamenti me sipërfaqe 93 m² ishte blerë me të ardhurat e përfituara nga shitja e një banese tjetër dhe kursimet nga punësimi i tij në Itali. Si pasojë, sipas KPK-së, banesa me sipërfaqe 101 m² ishte blerë me të ardhurat e siguruara nga shitja e mëparshme e një apartamenti me sipërfaqe 93 m².

25. KPK-ja iu referua më tej një kontrate sipërmarrjeje të lidhur para noterit më datë 7 mars 2005, sipas së cilës kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj kishin rënë dakord për të transferuar pronësinë e banesës me sipërfaqe 93 m² te një palë e tretë, e cila kishte paguar plotësisht çmimin e shitjes. Në kontratë thuhej se si kërkuesja, ashtu edhe bashkëjetuesi i saj kishin marrë çmimin e shitjes. Aty thuhej: "më datë 31 mars 2003, kompania e ndërtimit lidhi një kontratë sipërmarrjeje [me kërkuesen dhe bashkëjetuesin e saj] në lidhje me një apartament... me sipërfaqe 93 m²". Duke u mbështetur në këtë kontratë, KPK-ja arriti në përfundimin se si kërkuesja, ashtu edhe bashkëjetuesi i saj, kishin përfituar apartamentin me sipërfaqe 93 m². Edhe pse kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj nuk kishin jetuar së bashku në atë kohë, KPK-ja u shpreh se kërkuesja nuk mund të përjashtohet nga detyrimi

për të deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 pasurinë në kontratën e sipërmarrjes në të cilën ajo kishte qenë palë dhe në bazë të së cilës ajo kishte fituar të drejtat e pronësisë dhe kishte bërë një pagesë në lidhje me apartamentin. Ndërkohë, transaksioni ishte kryer me anë të një kontrate sipërmarrjeje, qëllimi i një transaksioni të tillë ishte shitblerja e pronës së paluajtshme. Prandaj, burimi i vërtetë i fondeve për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 101 m² kishin qenë të ardhurat nga shitja e një apartamenti të mëparshëm me sipërfaqe 93 m², të cilin të dy, edhe kërkuesja edhe bashkëjetuesi i saj, e kishin blerë në vitin 2003 përmes një kontrate sipërmarrjeje. KPK-ja konstatoi se ajo kishte qenë bashkëpronare e banesës dhe se ajo nuk e kishte deklaruar apartamentin me sipërfaqe 101 m² në ndonjë prej deklaratave periodike të pasurive ndërmjet viteve 2005 dhe 2011 (shih paragrafin 11 më lart). Sipas KPK-së, “*fshehja e veprimeve materiale nga ana e subjektit të rivlerësimit pasqyron mosdeklarim me vërtetësi të burimit të krijimit të pasurisë-veting*”.

26. Sa i përket pretendimit të kërkueses se ajo kishte kontribuar në blerjen e apartamentit, KPK-ja, duke bërë një vlerësim të provave në dosjen e çështjes, konstatoi se kërkuesja nuk kishte poseduar mjete të mjaftueshme likuide: në vitin 2003, pasuritë e saj likuide arrinin në 783,964 lekë (6,251 euro), me kursin aktual të këmbimit dhe më 2004 në 25,000 lekë (200 euro). Për më tepër, ajo kishte hua të marra në vitet 2003 dhe 2004.

27. Më tej, KPK-ja hodhi poshtë pretendimin e kërkueses se apartamenti ishte blerë me të ardhurat e bashkëjetuesit të saj, ndërsa ai kishte qenë duke studiuar, punuar dhe jetuar në Itali nga viti 1992 në vitin 2001. Duke bërë një vlerësim të provave të dosjes së çështjes, KPK-ja, duke pasur parasysh faktin që vetëm të ardhurat që i nënshtrohen tatimit mund të konsiderohen të ligjshme, vlerësoi se situata financiare e bashkëjetuesit të saj kishte qenë negative. Pavarësisht kësaj, KPK-ja kreu një vlerësim tjetër në bazë të të ardhurave të tij të deklaruara dhe arriti në përfundimin se të ardhurat e tij neto (206,399 lekë – 1,646 euro) ishin të pamjaftueshme për të blerë apartamentin. KPK-ja mori parasysh fitimet e marra nga punësimi i bashkëjetuesit të saj si kamerier. Në mungesë të ndonjë dokumenti mbështetës, KPK-ja nuk mori parasysh fitimin që do të llogaritej si komision në bazë të një kontrate që ai kishte lidhur me një kompani italiane. Gjatë përcaktimit të shpenzimeve të jetesës, KPK-ja i bazoi vlerësimet e saj në informacionin e publikuar nga Instituti Italian i Statistikave për periudhën 2002–2004.

28. KPK-ja deklaroi se kërkuesja nuk kishte paraqitur ndonjë dokument mbështetës për të justifikuar pamundësinë e bashkëjetuesit të saj për të siguruar dokumente që datojnë nga vitet 1990, në përputhje me nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Ajo nuk e kishte informuar KPK-në se, në funksion të marrëdhënies që bashkëjetuesi i saj kishte pasur me bankën në të cilën ai kishte një llogari në Itali, kompania italiane që ishte ende funksionale apo Instituti Kombëtar Italian i Sigurimeve Shoqërore, dokumentet mbështetëse mungonin, ishin humbur ose nuk mund të riprodhoheshin në ndonjë mënyrë tjetër. Së fundmi, KPK-ja konstatoi se nuk kishte asnjë dokument në dosjen e çështjes për të demonstruar se paratë e bursës, të cilat Ministria Italiane e Punëve të Jashtme ia kishte dhënë bashkëjetuesit të saj, të ishin transferuar në llogarinë e tij. KPK-ja konsideroi se paratë nga bursa e përfituar, dhënë për një qëllim të veçantë, nuk mund të ishin shkak për kurtime të konsiderueshme që mund të përdorëshin për të blerë një apartament. Më tej, konsideroi që të ardhurat që bashkëjetuesi i saj pretendonte të kishte fituar duke punuar në tregun e zi, nuk ishin “burime të bindshme për justifikimin e kësaj pasurie”.

ii. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 58.75 m²

29. KPK-ja konstatoi se kërkuesja nuk kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në vitin 2010, për të blerë apartamentin me sip. 58.75 m² përfituar me anë të kontratës së sipërmarrjes.

iii. Në lidhje me truallin me sipërfaqe 221.9 m²

30. KPK-ja u shpreh se kërkuesja kishte përfituar një sasi trualli (221.9 m²) më shumë se sa i takonte ligjërisht (që ishte 128.89 m²) si rezultat i transferimit të pronësisë në vitin 2013.

iv. Në lidhje me situatën financiare të kërkueses dhe të bashkëjetuesit të saj

31. KPK-ja, pasi përcaktoi burimet e pasurive dhe detyrimet e kërkueses dhe bashkëjetuesit të saj, konstatoi se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar likuiditetet e saj¹ në vitet 2007, 2009 dhe 2015 në një shumë totale prej 1,972,969 lekësh (15,750 eurosh). Gjatë përcaktimit të situatës financiare, KPK-ja kishte parasysh bilancin e gjendjes së likuiditeteve të kërkueses dhe bashkëjetuesit të saj në fillim të çdo viti dhe të ardhurat e tyre të dokumentuara. Detyrimet përfshinin shpenzimet e jetesës të përcaktuara nga ILDKPKI-ja, shpenzimet e udhëtimit, të përlllogaritura duke iu referuar shumës 180 euro për biletë avioni me kosto të ulët, 300 euro për një biletë vajtje-ardhje dhe 50 euro për shpenzime ditore, ripagimin e hipotekës, të cilat ishin llogaritur në bazë të dokumenteve të paraqitura nga bankat dhe barra të tjera.

32. Në përcaktimin e likuiditeteve, KPK-ja, duke u bazuar në dokumentet mbështetëse që kishte paraqitur kërkuesja, pranoi arsyetimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të caktuara, për shembull të ardhurat e përfituara nga bashkëjetuesi i saj, disa shpenzime udhëtimi të paguara nga punëdhënësi i saj dhe shpenzimet arsimore për fëmijën e saj. Komisioni rrëzoi disa pretendime të tjera të bëra nga kërkuesja për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse.

33. KPK-ja konstatoi më tej faktin se bashkëjetuesi i saj kishte mbajtur 15,000 euro *cash* në shtëpi, çka është në kundërshtim me dispozitat ligjore për deklarimin e pasurisë, që parashikon që ai duhet t'i depozitonte paratë *cash* të mbajtura në shtëpi në një llogari bankare para se të paraqiste deklaratën vjetore të pasurisë (shih paragrafin 202 më poshtë).

v. Sa i takon hipotekës në shumën 40,000 (USD)

34. KPK-ja u shpreh se kërkuesja ka fshehur natyrën e vërtetë të kredisë hipotekare në shumën 40,000 USD, të cilën e kishte marrë në vitin 2003, dhe se marrja e kësaj kredie është fiktive.

vi. Sa i takon tokës bujqësore me sipërfaqe 666 m²

35. KPK-ja konstatoi se, në bazë të dokumentacionit të çështjes, kërkuesja kishte bërë një deklaram të pasaktë në vitin 2003 në lidhje me pjesën e saj të tokës me sipërfaqe 666 m², e cila, në përputhje me kontratën e shitjes dhe certifikatën e pronësisë, ishte regjistruar vetëm në emër të nënës së saj.

vii. Sa i takon apartamentit me sipërfaqe 89.16 m²

36. KPK-ja është shprehur se kërkuesja ka bërë deklaram të rremë sa u takon të ardhurave që kishte përfituar si bashkëpronare nga shitja e apartamentit në vitin 2003.

b) Gjetje sa u takon kritereve të tjera të rivlerësimit

37. KPK-ja mbështeti gjetjet pozitive të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë sa u takon aftësive profesionale dhe etikës.

38. KPK-ja konstatoi më tej se, pas një denoncimi të paraqitur nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 (shih paragrafin 148 më poshtë), kërkuesja nuk kishte deklaruar një konflikt interesi dhe heqjen dorë nga shqyrtimi i një ankese kushtetuese në lidhje me një sërë procedimesh civile para gjykatave më të ulëta, në përputhje me nenin 36 (1) (c) të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile (shih paragrafët 199 dhe 197 më poshtë). Sipas KPK-së, konflikti i interesit qëndronte në faktin se babai i saj kishte qenë relator i një çështjeje në një gjykatë apeli, e cila kishte shqyrtuar çështjen e kufizimeve ligjore në një set të veçantë procesesh penale kundër palëve të treta, një ankesë e cila është paraqitur nga i njëjti person që kishte depozituar ankimin pranë Gjykatës Kushtetuese. Në atë grup procesesh penale, gjykata e apelit kishte vendosur që çështja ishte parashkuar. Palët e treta kishin qenë, gjithashtu, palë e interesuar në procesin kushtetues.

¹ Për qëllimet e këtij aktgjykimi, "likuiditete" do të thotë: (A) gjendja e kursimeve *cash* në fund të një viti të caktuar kalendarik, siç përcaktohet nga organet e rivlerësimit, i cili duhet të jetë i barabartë me (B) bilancin e parave të mbartura të kërkueses dhe bashkëjetuesit të saj nga viti i kaluar kalendarik, plus (C) të ardhurat vjetore të kërkueses dhe bashkëjetuesit të saj të krijuara gjatë vitit kalendarik raportues, të mbështetura me dokumente ligjore/zyrtare, minus (D) çdo shpenzim (përfshirë, por pa u kufizuar në, shpenzimet e jetesës, shpenzime udhëtimi, këste hipotekimi). Çdo mospërputhje kur (A) është më e lartë se (B + C - D) do të krijonte likuiditete të pajustificueshme që nuk mbështeten nga rrjedha e parave të përcaktuara nga dokumentet në dosjen e çështjes.

39. Sa i përket sjelljes së kërkueses, KPK-ja u shpreh se ajo kishte bashkëpunuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe kishte dhënë shpjegime, siç kërkohet. Sidoqoftë, KPK-ja doli në përfundimin se dokumentet që ajo kishte siguruar ishin të një natyre deklarative.

c) Konkluzion i përgjithshëm

40. KPK-ja, duke pasur parasysh konstatimet në lidhje me vlerësimin e pasurive të kërkueses dhe mosdeklarimin nga ana e saj të një konflikti interesi, vendosi me shumicë votash shkarkimin e saj nga detyra sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 (shih paragrafin 151 më poshtë).

d) Mendimi i pakicës

41. Një nga anëtarët e KPK-së (G.T.) paraqiti një opinion kundër, duke u shprehur se mospërputhjet për deklarimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 101 m² (shih paragrafin 24 lart) nuk përbënin prova të mjaftueshme për shkarkimin nga detyra të kërkueses; dhe as pasaktësitë në deklarimin e pasurisë nuk mund të konsiderohen si mosdeklarim pasuric. Sipas mendimit kundër të G.T., ishte e provuar që apartamenti me sipërfaqe 101 m² ishte blerë me të ardhurat e fituara nga shitja e një apartamenti tjetër, i cili, nga ana tjetër, ishte blerë në vitin 2003 me të ardhurat nga punësimi i bashkëjetuesit të kërkueses në Itali dhe paratë e tij të bursës. Si pasojë, të ardhurat kishin origjinën nga fondet e bashkëjetuesit të saj dhe nuk mund të përbënin shkak për mospërputhje në deklaratat e paraqitura në vite të ndryshme.

42. Meqenëse bashkëjetuesi i saj i kishte fituar të ardhurat mbi njëzet vjet më parë, kishte qenë objektivisht e pamundur që kërkuesja të merrte dhe të paraqiste dokumente për të verifikuar burimin e tyre. Vlerësimi financiar, i bërë në lidhje me bashkëjetuesin e saj, nuk kishte marrë parasysh të ardhurat që ai kishte akumuluar në vitet 1996, 1998 dhe 1999, ndërsa punonte në tregun e zi në Itali. Dihet botërisht se studentëve shqiptarë në Itali, ose diku tjetër jashtë vendit, u duhej të punonin në tregun e zi për të fituar të ardhura të tjera, pavarësisht çdo burse që u jepej. Në të vërtetë, ligji nr. 84/2016 favorizonte të ardhurat e ligjshme që u nënshtroheshin taksave. Ligji *favorizon subjektet duke legjitimuar deri në dyfishin e pasurisë së ligjshme*. Pasuritë totale të kërkueses nuk kishin tejkaluar dyfishin e pasurive të ligjshme. Mendimi i pakicës nuk bashkohet me mendimin e shumicës në lidhje me paratë nga bursa; si dhe nuk mbështeti gjetjet e shumicës në lidhje me aktin noterial të nënshkruar në vitin 2003, për aq kohë sa KPK-ja nuk kishte marrë ndonjë provë për të treguar që kërkuesja kishte kontribuar në blerjen ose përfitimin nga shitja e asaj banese.

43. Sa u përket likuiditeteve të kërkueses në vitet 2007, 2009 dhe 2010, anëtari kundër konsideroi se pasaktësitë në plotësimin e deklarimit të pasurisë nuk mund të konsiderohen si deklarim i rremë ose mungesë e të ardhurave të ligjshme. Për më shumë, sipas mendimit të saj, kredia hipotekare prej 40,000 USD ishte paguar drejtpërdrejt në llogarinë bankare të kompanisë së ndërtimit. Ky fakt mjaftonte për të treguar se kredia ishte marrë për blerjen e apartamentit dhe kërkuesja nuk mund të fajësohej për gabime materiale në aktin noterial. Në tërësi, mendimi kundër përfundon se duke iu referuar parimit të proporcionalitetit, kërkuesja kishte pasuri të besueshme.

44. Së fundmi, kërkuesja nuk ishte përballur me një konflikt interesi në lidhje me ankimin e bërë nga anëtari i publikut në lidhje me pjesëmarrjen e babait të saj në një çështje penale, si anëtar i një gjykate apeli.

B. Procesi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

1. Ankimi i kërkueses

45. Më datë 19 qershor 2018, kërkuesja paraqiti një ankim prej 42 faqesh kundër vendimit të KPK-së pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA), duke ngritur dy linja argumentesh: e para lidhur me pretendimet në lidhje me shkelje procedurale ose thelbësore të ligjit dhe, e dyta, kundërshtimin e gjetjeve të KPK-së. Kërkuesja përsëriti të njëjtat argumente në parashtrimet e saj të mëtejshme me shkrim të datave 21 shtator dhe 15 tetor 2018.

a) Pretendimet në lidhje me shkeljet procedurale dhe materiale të ligjit

46. Kërkuesja pretendoi që asaj nuk i ishte dhënë mundësia të mbrohej në lidhje me gjetjet përfundimtare të KPK-së se ajo kishte pasur fshehje dhe deklarim të rremë ose të pasaktë të pasurive të saj, dhe se asnjë gjetje e tillë nuk ishte bërë në përfundim të hetimit administrativ.

47. KPK-ja kishte luajtur një rol aktiv në mbledhjen e fakteve, provave dhe informacionit, duke tejkaluar rolin standard të një gjykate, e cila zakonisht do të jepte një vendim pasi të dëgjonte të

gjitha argumentet e palëve. Më pas, ajo nuk kishte arritur të siguronte garancitë procedurale në procesin ndaj saj, të tilla si barazia e armëve. Komisioni kishte qenë selektiv në provat që kishte përdorur dhe mbështetur kundër saj dhe nuk kishte marrë parasysh analizën, provat dhe argumentet që ajo kishte paraqitur në përgjigje të gjetjeve të hetimit administrativ.

48. KPK-ja nuk ka kompetenca për të interpretuar deklaratat e mëparshme të pasurisë që ajo kishte depozituar në përputhje me ligjin për deklarimin e pasurive, të cilat ishin vlerësuar pozitivisht nga ILDKPKI-ja. Për këtë arsye, ajo argumentoi që KPK-ja kishte zbatuar në mënyrë retroaktive nenin 31 të ligjit nr. 84/2016 për deklaratën e pasurisë të vitit 2003.

49. KPK-ja kishte kaluar në mënyrë të paarsyeshme barrën e provës mbi të për fakte në lidhje me të cilat ajo nuk ishte e detyruar të paraqiste ndonjë dokument mbështetës. Për më tepër, nuk kishte marrë në konsideratë pamundësinë objektive që kërkuesja të merrte të gjitha dokumentet mbështetëse të nevojshme për të vërtetuar burimin e të ardhurave të bashkëjetuesit të saj.

50. Së fundmi, KPK-ja nuk ishte shprehur se ajo posedonte më shumë se dyfishin e shumës së pasurive të saj të ligjshme, gjë që do të garantonte shkarkimin e saj nga detyra, në përputhje me nenin D, pika 4 e aneksit të Kushtetutës. Në fakt, pasuritë e saj kishin qenë sa gjysma e shumës së të ardhurave të saj të ligjshme.

b) Pretendimet në lidhje me gjetjet e gabuara në lidhje me kriteret e rivlerësimit

51. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m², kërkuesja parashtrroi tri argumente. Së pari, ajo argumentoi që KPK-ja kishte keqinterpretuar ligjin duke barazuar nënshkrimin e një transaksioni ligjor (veprimi juridik) – duke iu referuar kontratave të sipërmarrjes të viteve 2003 dhe 2005 – me përfitimin e një “pasurie”. Ajo nuk kishte pasur asnjë detyrim për të deklaruar transaksionet ligjore, përfshirë kontratat e sipërmarrjes, të cilat nuk kishin kontribuar në përfitimin e një pasurie sipas ligjit për deklarimin e pasurive dhe ligjit nr. 84/2016.

52. Së dyti, ishte bashkëjetuesi i kërkueses që kishte kryer të gjitha transaksionet ligjore në vitet 2003 dhe 2005, dhe se kërkuesja nuk kishte qenë palë në to. Ai kishte bërë deklarimin e pronave që kishte përfutur, përfshirë origjinën e të ardhurave të përdorura, në deklaratat e pasurisë të viteve 2003 dhe 2005, pa asnjë fshehje të tyre. Ajo kishte deklaruar bashkëpronësinë e tyre në deklaratën e pasurive të vitit 2011, pasi bashkëjetuesi i saj kishte vendosur atë si pronare të përbashkët me pjesë takuese 50% të apartamentit në regjistrimin e asaj prone pranë autoriteteve. Në lidhje me këtë, ajo i bashkëlidhi ankimit të saj një vërtetim të lëshuar nga kompania shqiptare me të cilën bashkëjetuesi i saj kishte lidhur një kontratë sipërmarrjeje në vitin 2003 dhe një vërtetim të lëshuar nga ish-punëdhënësi italian i bashkëjetuesit të saj, që vërtetonte se ai kishte punuar për të nga viti 1995 deri në vitin 2001.

53. Së treti, për sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të jetesës së bashkëjetuesit të saj në Itali nga viti 1992 deri në qershor 1995, KPK-ja ishte mbështetur në shifra që korrespondojnë me periudhën 2002 deri më 2004, kur kostoja e jetesës ishte rritur si rezultat i inflacionit të shkaktuar nga zëvendësimi i liritës italiane me euron. Për më tepër, bashkëjetuesi i saj ishte punësuar në mënyrë të ligjshme nga korriku 1995 deri në korrik 2000, siç dëshmohet nga kopjet e kontratës së tij të punësimit dhe disa mandatpagesa. Sipas një vlerësimi empirik të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkëjetuesit të saj, ai kishte kursyer 3,444,871.32 lekë (27,586 euro), gjë që justifikon blerjen e banesës në vitin 2003.

54. Sa u përket likuiditeteve, KPK-ja nuk e kishte marrë parasysh faktin se shpenzimet e disa udhëtimeve për qëllime pune ishin përballuar nga punëdhënësi i saj ose institucionet pritëse ose që shpenzimet e disa udhëtimeve personale ishin përballuar nga familjet pritëse. Ai ia kishte atribuar asaj padrejtësisht të gjitha ato shpenzime. Duke bërë vlerësimin e saj për vitet 2007, 2009 dhe 2015, ajo argumentoi se ajo kishte pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme.

55. Në lidhje me denoncimin e bërë nga një individ, kërkuesja parashtrroi që personi përkatës kishte bërë një denoncim penal në prokurori kundër dy individëve privatë, duke pretenduar falsifikimin e dokumenteve zyrtare. Pas procedimit penal nga Prokuroria, në të cilin ky individ nuk kishte qenë palë, në vitin 2011 një trupë e Gjykatës së Apelit, anëtar i së cilës ishte dhe babai i saj,

kishte vendosur që ndjekja penale e këtyre personave ishte parashkruar dhe nuk kishte shqyrtuar çështjen në themel.

56. Procesi kushtetues, i shqyrtuar nga një trupë e Gjykatës Kushtetuese, anëtare e së cilës kishte qenë dhe kërkuesja, kishte të bënte me një kërkesë të paraqitur nga i njëjti individ në lidhje me rezultatet e një sërë procesesh civile në lidhje me pavlefshmërinë e një kontrate shitblerjeje të lidhur midis atij personi dhe një personi juridik në vitin 1999. Meqenëse procesi kushtetues nuk kishte asnjë lidhje me procesin penal, ajo nuk ishte në konflikt interesi dhe në këtë mënyrë nuk mund të jetë subjekti i konstatimit se ajo kishte minuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, siç përcaktohet në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

57. Në kontekstin e argumenteve të mësipërme, kërkuesja u shpreh që shkarkimi i saj nga detyra kishte qenë joproporcional dhe se procesi para KPK-së ishte kryer në shkelje të parimeve të ligjshmërisë, drejtësisë, paanësisë, barazisë para ligjit dhe proporcionalitetit.

2. Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

58. Më datë 16 korrik 2018, u hodh shorti për përbërjen e trupës prej pesë anëtarësh të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, për këtë, u njoftua përkatësisht kërkuesja. Më pas, ajo u informua se ankimi i saj do të shqyrtohej në dhomë këshillimi më datë 24 tetor 2018.

59. Më 24 tetor 2018, Kolegji dha vendimin e tij, duke shqyrtuar procedurën e zbatueshme, si dhe shkaqet e ankimit të kërkueses. Ajo u njoftua për vendimin më datë 23 nëntor 2018.

a) Gjetjet paraprake

60. Sipas një vlerësimi të përgjithshëm, Kolegji konfirmoi se procedimi para saj u bazua në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47, 49 dhe 51 të ligjit për gjykatat administrative (shih paragrafët 153 dhe 194–196 më poshtë). Në përputhje me nenet 47 dhe 49, pika 2 e ligjit për gjykatat administrative, Kolegji nuk pranoi marrjen e provave të reja të paraqitura nga kërkuesja. Kolegji arsyetoi se ajo nuk kishte paraqitur ndonjë shkak për pamundësinë e saj për të paraqitur provat e reja pranë KPK-së. Gjithashtu, Kolegji nuk pranoi të merrte prova të tjera të paraqitura më 15 tetor 2018, në përputhje me nenin 49, pika 6/a e ligjit nr. 84/2016 (shih paragrafin 146 më poshtë). Kolegji vendosi të mos pranojë denoncime shtesë të bëra nga anëtarë të tjerë të publikut pas vendimit të KPK-së, pasi nuk kishte shkaqe për hetim.

61. Edhe pse kërkuesja nuk kishte kërkuar në ankim mbajtjen e një seance publike, Kolegji konsideroi se nuk ishte e nevojshme të mbahej një e tillë, pasi: i. KPK-ja kishte bërë një vlerësim të saktë dhe gjithëpërfshirës të fakteve; ii. nuk kishte asnjë nevojë për të pranuar prova të reja ose për të vlerësuar fakte të reja; iii. KPK-ja nuk kishte bërë ndonjë shkelje serioze procedurale ose deklarim të gabuar ose jo të plotë të fakteve; dhe iv. nuk kishte nevojë për të rishqyrtuar provat që ishin pranuar nga KPK-ja.

62. Kolegji sqaroi se, bazuar në nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin Ç, pika 4 dhe nenin D të aneksit të Kushtetutës, organet e vlerësimit kishin kompetenca për të vlerësuar deklaratat e pasurive të një individi të bëra që nga viti 2003, me qëllim verifikimin nëse personi që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit zotëron më shumë pasuri sesa ai ose ajo mund të posedonte ligjërisht ose nëse personi kishte bërë deklarim të saktë dhe të plotë të pasurive të tij dhe të personave të tjerë të lidhur me të. Meqenëse dispozitat ligjore u kishin dhënë një vlerë provuese deklaratave periodike të pasurive, ato mund të konsiderohen se kanë të njëjtën rëndësi si deklaratat e pasurisë së rivlerësimit. KPK-ja dhe Kolegji do t'i konsiderojnë këto deklaratat, së bashku me provat e tjera, në tërësi, në mënyrë që të përcaktojnë rrethanat e çështjes dhe të marrin një vendim të drejtë. KPK-ja, gjithashtu, do të shqyrtojë raportin e hartuar nga ILDKPKI-ja për të përcaktuar provueshmërinë dhe vërtetësinë e tij.

63. Kolegji sqaroi më tej se, pas mbylljes së hetimit administrativ, KPK-ja kishte informuar kërkuesen për gjetjet paraprake në lidhje me secilën pasuri dhe ia kishte kaluar asaj barrën e provës. Konstatimet përfundimtare në lidhje me fshehjen ose deklarimin e pasaktë të pasurive duhej të bëheshin pasi subjekti i rivlerësimit të kishte paraqitur argumente dhe prova në mbrojtjen e tij ose të saj. Në lidhje me këtë, subjektit të rivlerësimit i kërkohet të demonstroi bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të tij ose të saj dhe të mos fshehtë ose të deklaronte në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedimin ose në përdorim të tij apo saj. Procesi i rivlerësimit është një

procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), që ka për qëllim të japë të gjitha garancitë për një proces të rregullt ligjor.

64. Në rastin e kërkuases, Kolegji i Posaçëm i Apelit vuri në dukje se përfundimi i hetimit administrativ kishte të bënte vetëm me gjetjet paraprake të bëra nga KPK-ja, në mungesë të ndonjë argumenti të parashtruar nga kërkuësja. KPK-ja e kishte informuar atë për gjetjet e saj dhe e kishte ftuar të paraqiste argumente dhe prova për të kundërtën, në vijim të të cilave kishte vazhduar hetimin. KPK-ja kishte shtyrë seancën publike të datës 25 prill 2018, në mënyrë që të shqyrtonte plotësisht parashtrësit shtesë me shkrim që ajo kishte paraqitur në të njëjtën datë, si dhe provat e tjera mbështetëse që ajo i kishte vënë në dispozicion më datë 18 prill 2018. Këto veprime garantuan të drejtën e kërkuases për një proces të rregullt. KPK-ja nuk mund të merrte një vendim në lidhje me fshehjen ose deklarin të rremë të pasurive gjatë hetimit administrativ, për aq kohë sa procesi ishte ende në vijim, ishte caktuar një seancë publike dhe kërkuësja kishte të drejtën të paraqiste prova dhe parashtrime. Sikur ta kishte bërë këtë, KPK-ja do të kishte parajgykuar rezultatin e çështjes pas kalimit të barrës së provës të kërkuësja, e cila ishte ftuar të paraqiste prova për të kundërtën.

65. Kolegji konsideroi se KPK-ja e kishte shkarkuar nga detyra kërkuesen për deklarin të pamjaftueshëm të pasurive dhe për faktin se ajo, pas shqyrtimit të përgjithshëm të procedurave, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Ajo nuk e ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit për efekt të kalimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme. Për më shumë, fakti që ajo kishte marrë një vlerësim pozitiv për figurën nuk e vuri në pikëpyetje papërshtatshmërinë e deklarin të rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurive që ajo kishte bërë. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 nuk kërkonte që të dyja këto kritere të vlerësoheshin negativisht, pasi secili prej tyre përbente një shkak të veçantë për shkarkimin nga detyra.

66. Së fundmi, ai konstatoi se KPK-ja i kishte siguruar kërkuases të drejtën për t'u njohur me dokumentet e mbledhura gjatë hetimit administrativ; çështja e saj ishte dëgjuar publikisht brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. KPK-ja kishte marrë vendimin pasi kishte marrë argumentet, dokumentet dhe provat e kërkuases. Për këtë arsye, ishte respektuar e drejta e saj për një proces të rregullt ligjor.

b) Gjetjet në lidhje me vlerësimin e pasurisë

i. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m²

67. Kolegji përcaktoi që me anë të kontratave të sipërmarrjes, kërkuësja kishte përfituar të drejta *in rem* (të drejta reale) në apartamentin objekt të kontratës. Legjislacioni i brendshëm parashikon që lidhja e një kontrate ligjore është një mënyrë për të fituar një pronë ose të drejta *in rem*. KPK-ja kishte arritur në përfundim të saktë, pas një shqyrtimi të dokumenteve në dosjen e çështjes, se kontratat e sipërmarrjes të viteve 2003 dhe 2005 kishin të bënin me transferimin e të drejtave *in rem* në një apartament që do të ndërtohej në të ardhmen kundrejt pagimit të një çmimi. Kërkuësja dhe bashkëjetuesi i saj, të cilët kishin nënshkruar të dyja kontratat e sipërmarrjes të vitit 2003 dhe 2005 që kishin specifikuar objektin dhe çmimin të paguar më pas, me nënshkrimin e saj kishin fituar të drejta *in rem*. Prandaj, kërkuësja duhet të kishte deklaruar përfitimin e kësaj pasurie të veçantë në kohën e duhur, domethënë, në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, në vend që të priste ta deklaronte atë në deklaratën e pasurisë 2011, pasi bashkëjetuesi i saj e kishte regjistruar edhe atë si pronare të përbashkët me 50% të pjesës takuese të apartamentit.

68. Pas një vlerësimi të dokumentacionit të dosjes së çështjes, të tilla si fatura bankare, vërtetime pagash dhe pagesa në lidhje me bursën në Itali, Kolegji konstatoi se bashkëjetuesi i saj nuk ka provuar bindshëm ligjshmërinë e të ardhurave për periudhën 1992 deri 2000 për blerjen e banesës në vitin 2003. KPK-ja nuk kishte gabuar në përlogaritjen e shpenzimeve të bashkëjetuesit të saj gjatë kohës që ishte student në Itali.

69. Në lidhje me të ardhurat e bashkëjetuesit të kërkuases nga punësimi i tij në Itali gjatë periudhës 1995–2000, kërkuësja nuk kishte paraqitur dokumente të mjaftueshme mbështetëse ose prova të tjera për të justifikuar që të ardhurat ishin të ligjshme, domethënë, i ishin nënshtruar pagimit të taksave, pasi bashkëjetuesi i saj kishte punuar në tregun e zi. Nuk kishte asnjë informacion se si të ardhurat ishin transferuar në Shqipëri dhe kërkuësja nuk ndodhej në kushtet e

pamundësisë objektive, e cila mund të justifikonte dëmtimin ose humbjen e dokumenteve mbështetëse që provojnë ekzistencën e të ardhurave të ligjshme. Deklarimet e kërkuases, sa i takon burimit të të ardhurave, *mbeten në nivel deklarativ dhe nuk justifikohet ligjshmëria e tyre.*

70. Së fundmi, duke marrë parasysh deklaratat e bëra nga bashkëjetuesi i kërkuases dhe duke marrë parasysh të gjitha të ardhurat që ai mund të kishte fituar gjatë qëndrimit të tij në Itali, kursimet e tij nuk mund të ishin të mjaftueshme për të blerë apartamentin. As kërkuësja nuk kishte mjete të mjaftueshme financiare në vitin 2003 për blerjen e apartamentit. Ajo nuk kishte parashtruar ndonjë argument që kundërshtonte vërtetësinë e kontratës së sipërmarrjes të vitit 2003 ose pagesën e shumës së treguar në të.

71. Kolegji arriti në përfundimin se kërkuësja dhe bashkëjetuesi i saj nuk kishin pasur fonde të mjaftueshme për të blerë apartamentin me sipërfaqe 101 m² me të ardhura të ligjshme, siç deklarohet prej tyre. Prandaj, kërkuësja kishte bërë një deklaram të rremë dhe kishte fshehur pasurinë.

ii. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 58.75 m²

72. Kolegji konstatoi se, duke pasur parasysh situatën financiare të kërkuases, siç është evidentuar në deklaratën e pasurisë të vitit 2009, ajo kishte të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Kolegji konstatoi se konstatimi i KPK-së sa i takon kësaj pasurie nuk është i saktë.

iii. Në lidhje me truallin me sipërfaqe 221.9 m²

73. Kolegji konstatoi se kërkuësja nuk mund të fajësohej për përfitimin nga rregullimi i një trualli më të madh ku çmimi dhe madhësia e tij ishin të përcaktuar nga autoritetet publike në vitin 2013, kur në fakt ajo kishte kërkuar që e drejta e saj mbi pronën të rregullohej në kuadër të një trualli më të vogël. Kjo gjetje e KPK-së është e pabazuar.

iv. Në lidhje me situatën financiare

74. Kolegji theksoi se kërkuësja nuk kishte ankimmuar në KPK metodologjinë e aplikuar prej tij për përcaktimin e situatës financiare. Ajo nuk kishte parashtruar ndonjë argument ku kundërshton përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës.

75. Kolegji mbështeti vendimin e KPK-së për mospranimin e deklaratës noteriale të hartuar jashtë vendit, pasi kjo deklaratë nuk përmban elementet për t'u konsideruar e vlefshme sipas legjislacionit të brendshëm dhe e përdorur gjatë procesit. Sa u takon disa prej shpenzimeve për udhëtime, Kolegji konstatoi se kërkuësja nuk ka paraqitur dokumente mbështetëse bindëse për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të përdorura për të mbuluar këto shpenzime. Sa u takon shpenzimeve të tjera të udhëtimit, Kolegji u shpreh se KPK-ja nuk i ka marrë ato në konsideratë në llogaritjen e shpenzimeve të bëra nga kërkuësja. Sa i takon shumës në *cash* (15,000 euro), të cilën bashkëjetuesi i saj nuk e kishte deklaruar ndër vite, Kolegji konstatoi se ai kishte vepruar në kundërshtim të detyrimeve ligjore.

76. Kolegji kreu një rivlerësim të pasurive të kërkuases dhe të bashkëjetuesit të saj dhe të detyrimeve për vitet 2007, 2009, 2015 dhe 2016, ku rezultati ishte i ndryshëm si me atë të KPK-së, ashtu edhe me atë në parashtrimet e kërkuases. Përsëri u konstatua se kërkuësja nuk kishte të ardhura të ligjshme për të justifikuar likuiditetet e saj në shumën totale prej 1,288,258.27 lekësh (afërsisht 10,277 euro krahasuar, gjithashtu, me konstatimin e KPK-së në paragrafin 31 më lart).

77. Kolegji iu referua ekzistencës së dy llogarive bankare që posedonte kërkuësja dhe bashkëjetuesi i saj gjatë viteve 2015 dhe 2016 (shih paragrafin 11 lart), duke deklaruar se nuk ishte e qartë se si paratë ishin depozituar ose transferuar, pasi ajo nuk i kishte deklaruar llogaritë në deklaratat vjetore të pasurive. Kërkuësja dhe bashkëjetuesi i saj nuk kishin deklaruar se si i kishin hapur ato llogari dhe se si i kishin kryer transaksionet financiare.

78. Kolegji doli në përfundimin, se: “kërkuësja nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të këtyre shumave monetare, përpiqet të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në likuiditete, si dhe ajo vetë dhe personi i lidhur me të nuk kanë justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave për këto shuma monetare”.

iv. Në lidhje me kredinë hipotekare prej 40,000 US dollarë

79. Kolegji konstatoi se kredia ishte paguar për qëllimin që ishte marrë dhe se gjetja e KPK-së në këtë drejtim nuk ishte e bazuar.

v. Në lidhje me truallin me sipërfaqe 666 m²

80. Kolegji mbajti të njëjtin qëndrim, si dhe KPK-ja se kërkuesja kishte bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e vitit 2003 sa i takon pjesës së saj takuese në truallin me sipërfaqe 666 m², e cila i përkiste vetëm nënës së saj.

vi. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 89.16 m²

81. Kolegji u shpreh se sa i takon apartamentit me sipërfaqe 89.16 m², kemi të bëjmë me një deklaram të pasaktë në deklaratën e dorëzuar nga kërkuesja në vend të një deklarimi të rremë, siç u shpreh KPK-ja në gjetjen e saj.

c) Gjetjet në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale

82. Kolegji mbajti të njëjtin qëndrim me KPK-në se, sipas një denoncimi nga një anëtar i publikut, kërkuesja nuk hoqi dorë nga procesi në Gjykatën Kushtetuese. Sipas vendimit të KPA-së, kërkuesja, në cilësinë e anëtares së trupës së Gjykatës Kushtetuese kishte shqyrtuar një ankim të paraqitur nga një individ në kundërshtim me ligjin e proceseve civile në lidhje me vlefshmërinë e një kontrate shitblerjeje të lidhur ndërmjet një personi publik me një subjekt ligjor. Anëtari i publikut kishte vënë në dispozicion të Gjykatës Kushtetuese një vendim të dhënë në vitin 2011 nga një trup gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë, në të cilin babai i kërkueses kishte qenë relator, i cili kishte vendosur që procedimi penal ndaj dy individëve, të cilët ishin dënuar nga gjykata e shkallës së parë për falsifikim të një vendimi administrativ pronësie, ishte parashkruar.

83. Ndërsa në shikim të parë kishte dy grupe të veçanta procesesh, njëri penal dhe tjetri civil, palët ishin pothuajse të njëjta, por në pozicione të ndryshme procedurale. Lënda e të dy grupeve të proceseve duket të jetë e ndryshme; megjithatë, shkaku kryesor i saj ishte privatizimi i një ndërtese dhe vlefshmëria e titullit të pronësisë së një trualli, në lidhje me të cilën ishte ngritur procesi penal kundër disa individëve dhe më pas ai u deklarua i parashkruar. Kërkuesja nuk kishte hequr dorë nga shqyrtimi i ankesës kushtetuese, edhe pse një kopje e vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit, në përbërjen e të cilit babai i kërkueses kishte qenë relator, ishte përfshirë në dosjen e çështjes së Gjykatës Kushtetuese. Dështimi i kërkueses për të hequr dorë nga procesi nuk kishte respektuar parimin e paanësisë dhe kishte ngritur dyshime në lidhje me testin objektiv, si rezultat i të cilit besimi i publikut në sistemin e drejtësisë ishte cenuar. Sipas këndvështrimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, përjashtimi i kërkueses nuk do të kishte penguar shqyrtimin e ankesës kushtetuese nga një kuorum i Gjykatës Kushtetuese, siç kërkohet nga ligji.

d) Përfundim

84. Kolegji la në fuqi vendimin e KPK-së për shkarkimin nga detyra të kërkueses.

e) Mendimi i veçantë

85. Një gjyqtare e KPA-së (I.R.) doli me një mendim të veçantë (*mendim paralel*), i cili nuk ndikoi me votën e saj në favor të shkarkimit të kërkueses nga detyra. Ajo iu referua kryesisht gjetjeve në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m². Sipas këndvështrimit të saj, kontratat e sipërmarrjes, të cilat nuk ishin kontestuar nga kërkuesja, përbënin prova të forta se ajo pasuri nuk ishte fituar vetëm me të ardhurat e bashkëjetuesit të saj. Si rezultat, kërkuesja ishte përpjekur të bënte deklaram të pasaktë të pasurive dhe deklaram të rremë të burimit të përdorur për krijimin e tyre.

86. Për sa i përket situatës financiare të kërkueses, mendimi paralel shprehet se Kolegji nuk kishte marrë në shqyrtim një sërë parashtrimesh të saj në lidhje me disa shpenzime udhëtimeve që ajo kishte bërë gjatë viteve. Ato shpenzime, të cilat nuk ishin përballuar nga kërkuesja dhe për të cilat ajo kishte paraqitur prova, i ishin atribuar gabimisht asaj. Ato shpenzime duheshin zbritur nga shuma totale e përcaktuar nga Kolegji (shih paragrafin 76 më lart), dhe shuma që rezulton do të ishte 478,392 lekë (afërsisht 3,849 euro) ose më pak. Si pasojë, në pikëpamje të vlerës relativisht të ulët dhe të përvojës së gjatë profesionale të kërkueses, argumenti në lidhje me mungesën e të ardhurave për të justifikuar likuiditetet e saj nuk mund të përbënte një *premisë të qëndrueshme* për ta konsideruar atë si një shkak për shkarkimin nga detyra, sipas kuptimit të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 61, pika 3 dhe 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

87. Opinioni i veçantë pranoi riklasifikimin e Kolegjit si “deklaram i pasaktë” për truallin me sipërfaqe 666 m² dhe apartamentin me sipërfaqe 89,16 m². Sidoqoftë, ajo nuk konsideroi që ato gjetje, të cilat kishin të bënin me deklaratat e pasurisë të viteve 2003 dhe 2004, ishin të mjaftueshme

për të krijuar baza për shkarkimin e kërkuases nga detyra, për aq sa ajo nuk kishte pasur qëllim për të fshehur pasurinë ose për të bërë një deklaram të rremë.

88. Mendimi paralel nuk i pranoi gjetjet e Kolegjit në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuases. Pas analizimit të nenit 36, pika 1, germa “c” e ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, mendimi paralel argumentoi se, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të proceseve para Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte qëllim të shqyrtonte vetëm mungesën e paanësisë në një sërë procedimesh civile dhe jo zbatimin e së drejtës materiale, ligji vendës nuk parashikonte një situatë si ajo në fjalë, në të cilën kërkuesi kishte pasur një konflikt interesi në lidhje me proceset penale në të cilat babai i saj kishte qenë relator i çështjes ku në fund ishte vendosur që procedurat penale ishin parashkruar. Ky individ nuk kishte ngritur ndonjë ankim në lidhje me pjesëmarrjen e kërkuases në trupën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Asnjë interes privat, që i përkiste kërkuases ose babait të saj, nuk ishte prekur si rezultat i proceseve kushtetuese në të cilat kërkuësja kishte qenë anëtare e trupës së Gjykatës Kushtetuese.

89. Në këndvështrim të arsyesimit se nuk kishte pasur konflikt interesi, mendimi paralel konsideroi se përfundimi se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë ishte cenuar, ishte i pabazuar. Mendimi paralel vazhdoi më tutje se “fakti që një palë në një sërë procesesh është e pakënaqur, e zhgënjyer ose ka mosbesim nga një vendim i dhënë nga një trupë gjyqësore në të cilën kërkuësja ishte anëtare, nuk përbën domosdoshmërisht një element të mjaftueshëm për ta marrë atë si minimin e besimit të publikut, i cili... duhet të përfshijë një numër të madh individësh të cilët nuk duhet të bien në kategorinë e palëve në atë grup procesesh...”.

C. Ngjarjet pas komunikimit të çështjes

90. Më datë 16 korrik 2020, kërkuësja informoi Gjykatën se kundër L.D. ishte nisur një procedurë penale për falsifikim të dokumenteve për fshehjen e informacionit të rëndësishëm gjatë procesit që çoi në emërimin e tij si anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. L.D. ishte anëtar i trupës së Kolegjit që kishte shqyrtuar ankimin e kërkuases.

91. Më datë 24 korrik 2020, pas procedimit penal ndaj L.D., Kolegji urdhëroi pezullimin e tij nga detyra².

92. Ndërkohë, duket se më datë 1 dhjetor 2020³, GJKKO-ja shpalli fajtor L.D. për falsifikim dokumentesh dhe e dënoi atë me 6 muaj burgim, të konvertuar në 12 muaj dënim me kusht. Është raportuar se L.D. ka ankimuar këtë vendim.

KUADRI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE LIGJORE

I. MATERIALET E BRENDSHME

A. Kushtetuta

93. Në zbatim të Raportit të Vlerësimit dhe Strategjisë së Reformës, qëllimi i parlamentit ishte miratimi i ndryshimeve kushtetuese, të cilat do të mbulonin disa fusha, përfshirë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (“vetingu”).

1. Opinioni i Komisionit të Venecias

94. Pas një kërkesë për një mendim mbi përputhshmërinë e draftndryshimeve kushtetuese me standardet ndërkombëtare, nga kryetari i Komisionit Parlamentar *ad hoc*, më datë 14 mars 2016, Komisioni Evropian për Demokraci përmes ligjit (“Komisioni i Venecias”) miratoi një opinion përfundimtar mbi draftin e ndryshuar të ndryshimeve kushtetuese (opinion nr. 824/2015 – CDL-AD (2016) 009), pas një opinionit të ndërmjetëm më 21 dhjetor 2015 (CDL-AD (2015) 045).

95. Komisioni i Venecias e konsideroi të përshtatshme strukturën institucionale të propozuar për kryerjen e procesit të rivlerësimit, duke theksuar se u takonte ligjvënësve kombëtarë të hartonin kontrolle dhe ekuilibra, pasi një sistem i prekur nga korrupsioni i përhapur gjerësisht mund të ketë nevojë për më shumë mekanizma të kontrollit të jashtëm sesa një sistem më i shëndetshëm. Komisioni i Venecias konstatoi se projektndryshimet kushtetuese ishin në përgjithësi koherente dhe

² Marrë nga faqja e KPA-së: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/vendim-nr.14.2020.pdf>

³ Siç raportohet dhe publikohet nga media lokale.

të pajtueshme me standardet evropiane, pasi ato përmbanin propozime të shëndosha për modelin e ardhshëm institucional të gjyqësorit shqiptar.

96. Në lidhje me masat e jashtëzakonshme për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioni i Venecias mbeti i mendimit se masa të tilla “[ishin] jo vetëm të justifikuara, por [ishin] të nevojshme që Shqipëria të mbrohej nga përhapja e korrupsionit e cila, nëse nuk adresohet, mund të shkatërronte plotësisht sistemin gjyqësor.” Komisioni i Venecias bëri vërejtje të përgjithshme në lidhje me mandatin e anëtarëve të KPK-së dhe KPA-së. Afati i propozuar prej nëntë vjetësh, pa të drejtë riemërimi, ishte i gjatë, duke marrë parasysh se rivlerësimi ishte “një masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme” dhe se i gjithë procesi i rivlerësimit “supozohet të zgjaste 11 vjet ose më pak nëse Shqipëria i bashkohej Bashkimit Evropian në një datë më të hershme”. Komisioni i Venecias deklaroi më tej se strukturat e rivlerësimit nuk duhet të zëvendësojnë organet e zakonshme kushtetuese; ndërkohë që ato mund të bashkëtojnë me ta për ca kohë, ato nuk duhet të shndërrohen në mekanizma paralelë pothuajse të përhershëm. Pas përmbylljes së punës së organeve të vetingut, institucionet dhe gjykatat e zakonshme mund të marrin çdo funksion të mbetur për proceset e rivlerësimit që nuk ishin përfunduar ende.

97. Komisioni i Venecias përshëndeti krijimin e një institucioni të veçantë apelimi, përkatësisht Kolegjit, i cili ishte në përputhje me rekomandimin e tij në opinionin e ndërmjetëm. Ai deklaroi si më poshtë:

“Ky organ është padyshim një lloj gjykate e specializuar, e cila nuk është një gjykatës i jashtëzakonshëm *ad hoc* – sepse nuk është krijuar në funksion të një çështjeje të veçantë – dhe supozohet të qëndrojë funksional gjatë gjithë kohëzgjatjes së [procesit] të rivlerësimit”.

98. Ndërkohë që Kolegji u bë një institucion qartazi i ndryshëm nga KPK-ja, Komisioni i Venecias rekomandoi, ndër të tjera, që gjyqtarët e Kolegjit të ishin në gjendje të integroheshin automatikisht në gjyqësor në fund të mandatit të tyre.

99. Në opinionin e ndërmjetëm, Komisioni i Venecias ka theksuar:

“në masën që ... rivlerësimi është një masë e përgjithshme, e zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë gjyqtarët, e vendosur në nivelin kushtetues, dhe e shoqëruar nga disa masa mbrojtëse procedurale dhe që nuk lidhen me ndonjë çështje specifike që një gjyqtar mund të ketë përpara tij, Komisioni i Venecias nuk sheh se si kjo masë mund të interpretohet që ajo ndikon në pavarësinë e gjyqtarit në një masë që nuk përputhet me nenin 6 [të Konventës]. Megjithatë, kjo nuk përjashton mundësinë që procesi i rivlerësimit mund të abuzojë në një rast të veçantë për të favorizuar pozicionin e një gjyqtari në një çështje të caktuar: nëse pretendime të tilla provoheshin, kjo mund të kërkonte rihapjen e asaj çështjeje pasi gjyqtari nuk do të ishte një ‘gjykatë e pavarur’.”

2. Raporti i Komisioni Parlamentar *ad hoc* mbi projektamendimet kushtetuese⁴

100. Komisioni parlamentar *ad hoc* theksoi se ndryshimet e propozuara kushtetuese mbi rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve përbënin një nga masat për të arritur profesionalizmin dhe për ta bërë sistemin e drejtësisë imun nga ndikimet e interesave politikë, praktikat korruptive dhe krimi i organizuar.

3. Mbi ndryshimet kushtetuese

101. Më datë 22 korrik 2016, parlamenti miratoi njëzëri një sërë ndryshimesh kushtetuese (ligji nr. 76/2016). Me rëndësi për çështjen aktuale janë neni 179/b i Kushtetutës dhe aneksi i Kushtetutës.

a) Neni 179/b i Kushtetutës

102. Neni 179/b parashikon krijimin e një sistemi rivlerësimi të të gjithë gjyqtarëve, përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, si dhe të të gjithë prokurorëve, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, me synimin për të “garantuar funksionimin e rregullit të ligjit, pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe rivendosjen e besimit të publikut në institucionet [e atij sistemi]”. Këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë duhet t’i nënshtrohen automatikisht rivlerësimit

⁴ E marrë nga faqja e Reformës në Drejtësi: <http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/relacion-shtesa-dhe-ndryshime-ne-ligjin-nr.-84172c-date-21.10.1998-kushtetura-e-r.sh-te-ndryshuar.pdf>

kalimtar. Dështimi për të kaluar procesin e rivlerësimit do të përbëjë një arsye për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, përveç shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët që kalojnë procesin e rivlerësimit do të qëndrojnë në detyrë ose do të emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas rastit.

103. Sipas nenit 179/b, rivlerësimi duhet të kryhet nga një Komision i Pavarur i Kualifikimit (KPK) në shkallë të parë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), i bashkëngjitur si një kolegji i veçantë i Gjykatës Kushtetuese, i cili do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të KPK-së. Si KPK-ja, ashtu edhe KPA-ja do të jenë të pavarura dhe të paanshme. Anëtarët e KPK-së dhe komisionerët publikë, të cilët përfaqësojnë interesin publik, do të shërbejnë për një mandat pesëvjeçar, ndërsa mandati i anëtarëve të Kolegji i Apelimit do të jetë nëntë vjet.

b) Aneksi i Kushtetutës

104. Aneksi i Kushtetutës, i cili i kushtohet tërësisht rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përbëhet nga dhjetë nene të emëruara sipas shkronjave të alfabetit shqiptar. Neni A parashikon që një numër i dispozitave kushtetuese, veçanërisht ato që lidhen me të drejtën për të respektuar jetën private dhe barrën e provës, do të kufizohen pjesërisht. Personat që kalojnë procesin e rivlerësimit do t'i nënshtrohen një sistemi të përhershëm llogaridhënieje, siç parashikohet në Kushtetutë dhe në statutet e tjera.

105. Neni B rregullon krijimin e një Operacioni Ndërkombëtar Monitorimi (ONM), i drejtuar nga Komisioni Evropian, për të mbështetur, monitoruar dhe mbikëqyrur procesin e rivlerësimit. ONM-ja do të emërojë vëzhgues ndërkombëtarë pasi të ketë njoftuar Qeverinë. Vëzhguesit ndërkombëtarë do të kenë të drejtën të: i. japin rekomandime në parlament për kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarëve të organeve të rivlerësimit ose pozicionin e komisionerit publik; ii. të bëjnë gjetje dhe të japin mendime mbi çështjet që merren në konsideratë nga organet e rivlerësimit; iii. t'i rekomandojnë komisionerit publik për të bërë një ankim kundër vendimit të KPK-së; dhe iv. të kenë qasje e të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për të monitoruar procesin e rivlerësimit në tërësinë e tij. Ata, gjithashtu, mund të kërkojnë nga organet e rivlerësimit që të marrin prova të reja ose mund të paraqesin prova të reja për shqyrtimin e tyre.

106. Neni C parashikon që KPK-ja do të përbëhet nga katër trupa, secila e përbërë nga tre anëtarë. Dy komisionerë publikë, të cilët do të përfaqësojnë interesin publik, mund të ankimojnë vendimin e KPK-së. Puna e KPK-së dhe e KPA-së do të drejtohet nga "parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional, të çliruar nga korrupsioni. Anëtarët e KPK-së dhe komisionerët publikë do të gëzojnë statusin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe anëtarët e KPA-së statusin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit C, pika 4, anëtarët e organeve të rivlerësimit dhe komisionerët publikë dhe anëtarët e stafit të tyre do të nënshkruajnë një autorizim duke iu nënshtuar një kontrolli vjetor të pasurive të tyre, monitorimit të rregullt të transaksioneve të tyre financiare dhe llogarive bankare dhe kufizimeve të së drejtës së tyre për konfidencialitet të komunikimeve gjatë mandatit të tyre.

107. Sipas nenit Ç, pika 1, rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Neni Ç, pika 2, parashikon që Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit publikojnë vendimet e tyre, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të marrë nga publiku. Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt. Komisioni ose Kolegji i Posaçëm i Apelimit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, komisionerit publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkruarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Sipas nenit Ç, pika 5, në rrethana të caktuara, barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal.

108. Neni D, i cili udhëheq vlerësimin e pasurive, citohet më poshtë.

Neni D – Vlerësimi i pasurive

“1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

109. Neni DH, pika 1, kërkon që subjektet e rivlerësimit të dorëzojnë një deklaratë dhe t'i nënshtrohen kontrollit të figurës, me qëllim “identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”. Kontrolli i figurës bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja. Sipas nenit DH, pika 2, subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. Sipas nenit DH, pika 3, nëse subjekti i rivlerësimit rezulton se “ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”. Neni DH, pika 4, parashikon që nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet.

110. Neni E parashikon që subjektet e rivlerësimit t'i nënshtrohen rivlerësimit të aftësive profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve. Sipas nenit E, pika 3, në rast se rezulton që subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Sipas nenit E, pika 4, në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

111. Neni E, pika 1 parashikon që Komisioni ose Kolegji i Posaçëm Apelimt, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Vendimi jepet i arsyetuar. Sipas nenit E, pika 3, shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet, mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim, sipas parashikimeve në ligjet procedurale.

112. Sipas nenit F, Kolegji i Posaçëm Apelimt përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij aneksi dhe ligjit. Kolegji vendos në trupa gjykuese me nga pesë anëtarë. Sipas nenit F, pika 3, Kolegji mund të

kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Neni F, pika 7 parashikon që Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim të arsyetuar me shkrim.

113. Neni G parashikon që subjekti i rivlerësimit mund të dorëhiqet dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet dhe subjekti “nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror ... për një periudhë 15-vjeçare”.

B. Ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (ligji nr. 84/2016 – “ligji i vetingut”)

114. Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, më 30 gusht të vitit 2016, parlamenti miratoi ligjin nr. 84/2016, i cili, pas botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më 8 tetor 2016.

1. Raporti i Komisionit të Posaçëm Parlamentar⁵

115. Raporti i Komisionit të Posaçëm Parlamentar citonte se projektligji ishte i nevojshëm për rregullimin e detajuar të parashikimeve kushtetuese të nenit 179/b të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës. Projektligji përcaktoi parimet e organizimit të procesit për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, metodologjinë dhe procedurat standarde të rivlerësimit, si dhe rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (“ONM”). Ai u hartua si pjesë e një grupi prej gjashtë ligjesh kyçe në lidhje me zbatimin e ndryshimeve kushtetuese.

116. Qëllimi kryesor i projektligjit ishte të garantonte funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Kjo do të arrihej duke kryer rivlerësimin kalimtar të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, me synimin për krijimin e një sistemi drejtësie të pavarur, eficient, të besueshëm dhe të ndershëm, i cili do të funksiononte me integritet dhe pa ndikime të jashtme nga krimi i organizuar dhe politika.

2. Relacioni shpjegues⁶

117. Relacioni i projektligjit citon se reforma në drejtësi, siç përshkruhet në raportin e vlerësimit, u nxit kryesisht nga nevoja për të adresuar problemet që kanë lindur nga shkalla e lartë e korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Ekzistenca dhe niveli i korrupsionit në drejtësi nuk është më vetëm një çështje e perceptimit nga publiku, por edhe një fakt i pranuar nga vetë gjyqtarët, sipas cilëve, sistemi i drejtësisë nuk është i çliruar nga influencat e jashtme. Arsye të tjera lidhen me nivelin e pakënaqshëm të cilësisë së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe me mosfunksionimin efektiv të mekanizmave ekzistues për kontrollin e tyre, në rastet e shkeljeve të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës, për vlerësimin e punës së tyre.

118. Qëllimi i projektligjit ishte përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe subjekteve të tjera që do të rivlerësoheshin sipas nenit 179/b të Kushtetutës. Ky proces do të shërbente për të vlerësuar përgatitjen e tyre profesionale, integritetin moral, si dhe për të zbuluar shkallën e pavarësisë në punën e tyre kundrejt ndikimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe pushtetit politik. Projektligji rregullonte parimet e organizimit dhe procedurat për rivlerësimin. Procesi i rivlerësimit do të kryhej me efektivitet, pa cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, me qëllim që rezultatet e këtij rivlerësimi të shërbenin për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, që funksionon me eficiencë dhe me besueshmëri, që pasqyron standardet më të larta të ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës.

119. Nga natyra e tij, ai do të ishte një ligj të posaçëm me fuqi të përkohshme deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve, të prokurorëve, si dhe të subjekteve të tjera të parashikuara nga Kushtetuta. Projektligji parashikonte ngritjen e një tërësie institucionesh për kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

3. Përmbledhje e ligjit nr. 84/2016

⁵ Marrë nga faqja zyrtare e Reformës në Drejtësi:

http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/raporti_i_komisionit_te_posacem_parlamentar.pdf

⁶ Marrë nga faqja zyrtare e Reformës në Drejtësi: <http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/280616relacion-rivleresimi.pdf>

120. Neni 1 parashikon që qëllimi i ligjit nr. 84/2016 është “përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit, për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi [...]”.

121. Neni 3 përmban disa përkufizime, nga të cilat, më poshtë janë cituar ato më me rëndësi për qëllim të këtij vendimi:

“Pasuri’ janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë – shih paragrafin 202 më poshtë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit;

‘Person i lidhur’ është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit;

‘Persona të tjerë të lidhur’ janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

a) Institucionet e rivlerësimit

122. Neni 5 detajon institucionet e përfshira në procesin e rivlerësimit, si: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK-ja”), Kolegji i Posaçëm i Apelimit (“KPA-ja”), komisionerët publikë dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (“ONM”).

123. Neni 6 përcakton kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit. Anëtar i institucioneve të rivlerësimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson, ndër të tjera kriteret, si: i. ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare (master i shkencave) për drejtësi; ii. të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës; iii. nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit; iv. ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, [apo] për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje [...]; v. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit; vi. nuk ka qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit përpara kandidimit; dhe vii. zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

124. Nenet 7 dhe 12 rregullojnë procedurën e aplikimit, përzgjedhjes paraprake, intervistimit dhe zgjedhjes së kandidatëve. Anëtarët e institucioneve të rivlerësimit zgjidhen nga parlamenti.

125. Neni 4, pika 2, parashikon që Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Sipas nenit 4, pika 5, Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm Apelimit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Sipas nenit 4, pika 6, kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin nr. 84/2016 nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Neni 27 parashikon që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit deklarohen dhe shmang çdo situatë konflikti interesi. Neni 28 parashikon që komunikimet e tyre elektronike dhe deklarimi i të ardhurave vjetore do të monitorohen sipas nënshkrimit të tyre për heqje dorë nga privatësia.

126. Neni 14 parashikon që Komisioni përbëhet prej dymbëdhjetë anëtarësh, të cilët i gjykojnë çështjet në trupa gjyquese të përbëra nga tre anëtarë secila. Shpërndarja e çështjeve në trupat

gjykuese bëhet me short, ku përcaktohet edhe anëtari relator. Neni 15 parashikon që Kolegji i Posaçëm i Apelit gjykon në trupa gjykuese të përbëra nga 5 gjyqtarë, të cilët caktohen me short për çdo çështje. Për çdo çështje caktohet një relator.

127. Neni 16 detajon shkaqet për përgjegjësi disiplinore për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, ndërsa neni 17 trajton procedurën për shkarkimin e tyre për shkak të një shkeljeje të pretenduar disiplinore. Vendimi në favor të masës disiplinore merret nga një trupë prej tre anëtarësh e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

128. Neni 18 parashikon që institucionet e rivlerësimit kanë diskrecion për vendimmarrje në lidhje me strukturën e tyre organizative dhe punësimin e personelit. Sipas nenit 19, ata propozojnë çdo vit projektbuxhetin e tyre pranë Kuvendit, i cili vendos në lidhje me të si pjesë integrale e buxhetit të shtetit. Neni 22 parashikon se pranë Komisionit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor që ushtron veprimtari ndihmëse në procesin vendimmarrës nga anëtarët e këtyre institucioneve.

b) ONM-ja

129. Sipas nenit 45, pika 2, vëzhguesit ndërkombëtarë, pjesë e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM-së), mund të kërkojnë informacion gjatë hetimit administrativ. Neni 50, pika 7 parashikon që ata, gjithashtu, kanë të drejtë të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar brenda kuadrit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në rrugë diplomatike. Neni 33, pika 3 parashikon që ata kanë të drejtë të aksesojnë të gjithë informacionin në zotërim të ILDKPKI-së. Sipas nenit 50, ata kanë të njëjtat të drejta aksesimi në informacion me institucionet e rivlerësimit.

130. Bazuar në nenin 49, pika 10, vëzhguesi ndërkombëtar mund të depozitojë gjetje në institucionet e rivlerësimit, të cilat i pranojnë si prova. Gjetjet janë të barasvlerëshme me mendimin e dhënë nga një ekspert dhe mund të refuzohen me anë të një vendimi të arsyetuar. Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë mund të ndikojë në procesin e vendimmarrjes, por nuk ka vlerën e provës.

131. Neni 55 citon se vëzhguesit ndërkombëtarë njoftohen paraprakisht për zhvillimin e seancës dëgjimore në KPK. Në bisedimet për marrjen e vendimit kërkohet prania e tyre dhe ata mund të shkruajë një mendim ndryshe/paralel që i bashkohet vendimit të KPK-së. Sipas nenit 65, pika 2, një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit mund t'i rekomandojë Komisionerit Publik të paraqesë një ankim kundër vendimit të Komisionit.

132. Neni 17 parashikon se vëzhguesit ndërkombëtarë mund, gjithashtu, të kërkojnë nisjen e hetimit disiplinor ndaj anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë komisionerët publikë.

c) Kriteret e rivlerësimit

133. Sipas nenit 4, pika 1, procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Neni 4, pika 2 parashikon se vendimi merret bazuar në “një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve (ose në vlerësimin tërësor të procedurave)”.

134. Subjekteve të rivlerësimit u kërkohet të depozitojnë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016, deklarin e pasurisë sipas aneksit 2 të këtij ligji, deklaratën e kontrollit të figurës sipas aneksit 3 të ligjit dhe formularin e vetëvlerësimit profesional sipas aneksit 4 të ligjit. Deklarimi i pasurisë përfshin informacione në lidhje me pasuritë e subjektit dhe origjinën e tyre, një përshkrim të të ardhurave dhe detyrimeve të subjektit dhe një listë të personave të tjerë të lidhur. Deklarata e kontrollit të figurës përfshin informacione në lidhje me të dhënat personale të subjektit, historikun e adresave, arsimin dhe kualifikimet e tjera, historikun e punësimit dhe pyetjet rreth lidhjeve me krimin e organizuar. Formulari i vetëvlerësimit profesional përmban informacion rreth historikut të punësimit të subjektit dhe pyetjeve në lidhje me përshkrimin e detyrave të subjektit, statistikave e numrit të çështjeve të shqyrtuara, pjesëmarrjes në trajnime dhe kualifikimeve të marra.

i. Vlerësimi i pasurisë

135. Neni 30 parashikon që objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Sipas nenit 31,

pika 1, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.

136. Në nenin 32, citohet si më poshtë:

“1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...].

[...]

4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit.”

137. Neni 33 parashikon që ILDKPKI-ja është institucioni përgjegjës për verifikimin e deklaramit të pasurisë. Sipas nenit 33, pika 5, ILDKPKI-ja, në përfundim të kontrollit, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar dhe, sipas rastit, konstaton se: i. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që subjekti nuk gjendet në situatë konfliktit interesi; ii. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii. është kryer fshehje e pasurisë; iv. është kryer deklarim i rremë; v. subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

ii. Kontrolli i figurës

138. Neni 34 parashikon se objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Sipas nenit 35, pika 1, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

139. Sipas nenit 36, pika 1, institucionet e rivlerësimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. Neni 36, pika 2 parashikon që Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, krijojnë një grup pune për kryerjen e kontrollit të figurës. Neni 36, pika 3 parashikon që DSIK-ja, me kërkesë të grupit të punës ose të institucioneve të rivlerësimit, ka të drejtë të komunikojë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar.

140. Neni 38 parashikon se kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe në informacione të tjera të disponueshme.

141. Sipas nenit 39, DSIK-ja i dorëzon një raport KPK-së, duke konstatuar: i. nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, dhe ii. nëse ka informacion në deklaramin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës. Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër.

iii. Vlerësimi i aftësisë profesionale

142. Neni 41, pika 1 kërkon që subjekti i rivlerësimit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, të dorëzojë pranë organit përgjegjës formularin vetëvlerësimit profesional.

Neni 41, pika 3 parashikon se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës. Megjithatë, neni 41, pika 4 shpreh se në varësi të disponueshmërisë së informacionit në lidhje me etikën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim.

143. Sipas nenit 43, vlerësimi i aftësive profesionale kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve. Neni 44 parashikon që pranë KPK-së paraqitet një relacion, relatori i të cilit propozon konstatimin e subjektit të rivlerësimit si i aftë, me mangësi, ose i papërshtatshëm.

d) Procedura e rivlerësimit

144. Sipas nenit 45, pika 1, anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Neni 45, pika 2 parashikon se ata mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit administrativ. Sipas nenit 46, ligji nr. 84/2016 i jep përparësi komunikimit me anë të postës elektronike në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

145. Neni 47 shpreh se të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35–40 dhe neneve 45–47 të Kodit të Procedurave Administrative. Sipas nenit 48, subjekti i rivlerësimit duhet të bashkëpunojë me institucionet e rivlerësimit, të cilat, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit.

146. Sipas nenit 49, pika 1, institucionet e rivlerësimit marrin dokumente ligjore, mbledhin deklarata nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku, si dhe dokumente të tjera shkrese për të përcaktuar faktet dhe rrethanat e çdo çështjeje. Neni 49, pika 6/(a) parashikon se institucionet e rivlerësimit mund të refuzojnë marrjen e provave të reja nëse, për shembull, marrja e provës është e panevojshme. Sipas nenit 49, pika 8, institucionet e rivlerësimit duhet të argumentojnë shkaqet e refuzimit të marrjes së provave të reja. Neni 51 parashikon se nëse subjekti i rivlerësimit nuk paraqet provat, si dhe kur provat e disponueshme janë të paplota, institucionet e rivlerësimit mund të vendosin bazuar në provat që disponojnë.

147. Neni 52 kërkon që institucionet e rivlerësimit të udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe i proporcionalitetit. Nëse ata arrijnë në përfundimin se provat e marra gjatë hetimit administrativ kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

148. Sipas nenit 53, çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit, të cilat hetojnë mbi pretendimet e ngritura në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

149. Neni 55 parashikon se pranë KPK-së mbahet një seancë dëgjimore. Anëtarët e KPK-së dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund t'i drejtojnë pyetje subjektit të rivlerësimit.

e) Masat disiplinore

150. Në përfundim të procedurës së rivlerësimit, KPK-ja jep një vendim të arsyetuar, duke konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, duke e pezulluar atë nga detyra për një periudhë prej një viti me detyrimin për ndjekjen e një programi trajnimi nga Shkolla e Magjistraturës, apo duke e shkarkuar atë nga detyra.

151. Sipas nenit 61, shkarkimi nga detyra për subjektin e rivlerësimit jepet si masë disiplinore në rastet:

“1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të;

2. Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës;

3. Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji;

4. Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale;

5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”.

f) E drejta për të ankimuar

152. Sipas nenit 63, të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit, në përputhje me ligjin për gjykatat administrative.

153. Neni 65, pika 1 shpreh se procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, 49, 51 dhe 55 të ligjit për gjykatat administrative. Neni 65, pika 3 parashikon se në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelimit e gjykon çështjen në seancë publike.

154. Neni 66 parashikon se Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me anë të një vendimi të arsyetuar, mund të vendosë lënien në fuqi, ndryshimin apo prishjen e vendimit të KPK-së.

4. Procesi pranë Gjykatës Kushtetuese

155. Në muajin tetor të vitit 2016, pranë Gjykatës Kushtetuese u paraqit një kërkesë për shqyrtimin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 84/2016. Kërkuesit, konkretisht anëtarët e parlamentit të partisë kryesore opozitare, pretendonin se ligji nr. 84/2016: i. cenonte parimet e ndarjes dhe balancës së pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit, pasi kishte zhvendosur kontrollin dhe hetimin e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve, nga organet e pavarura dhe të paanshme të krijuara me anë të ndryshimeve kushtetuese, në drejtim të institucioneve ekzistuese që pretendohet se kontrollohen nga qeveria, si: ILDKPKI-ja, DSIK-ja, Shkolla e Magjistraturës, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Ministria e Brendshme; ii. cenonte parimin e sigurisë juridike pasi formulimi i parashikimeve ishte i paqartë, konfuz dhe kontradiktor; iii. parashikonte kufizime të pajustificuara të të drejtave themelore të njeriut, në veçanti në lidhje me mbikëqyrjen e vazhdueshme të jetës private dhe kufizimet mbi të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese; dhe iv. nuk parashikonte ndonjë rregull specifik procedural që garanton të drejtën për proces të rregullt ligjor, të drejtën për ankim dhe respektimin e parimit të barazisë dhe të të drejtave themelore të njeriut, në veçanti pranueshmërinë e provave të marra nga publiku, siç parashikohet në nenet 53 dhe 54 të ligjit nr. 84/2016.

a) Opinioni *amicus curiae* i Komisionit të Venecias

156. Më 25 tetor 2016, Gjykata Kushtetuese, në konsideratë të pasojave të rënda dhe të pariparueshme për liritë dhe të drejtat themelore të personave ndaj të cilëve do të zbatohet ligji nr. 84/2016 dhe funksionimit të shtetit të së drejtës, vendosi të pezullojë zbatimin e tij.

157. Në vijim të një kërkesë të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese drejtuar Komisionit të Venecias për dhënien e një opinioni *amicus curiae* mbi përputhshmërinë e ligjit nr. 84/2016 me standardet ndërkombëtare, përfshirë Konventën, më 12 dhjetor 2016, Komisioni dha një opinion *amicus curiae* (Opinion nr. 868/2016 – CDL-AD (2016)036).

158. Komisioni i Venecias deklaroi se të dyja institucionet e rivlerësimit kishin karakteristika të organeve gjyqësore dhe se do të funksiononin dhe merrnin vendime në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Anëtarët e KPK-së dhe Komisioneri Publik do të kishin statusin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Posaçëm i Apelimit do të funksiononte si pjesë e Gjykatës Kushtetuese dhe anëtarët e tij do të gëzojnë statusin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Anëtarët e institucioneve të rivlerësimit do të kenë detyrimin për deklarimin e përvitshëm të pasurisë, e cila do të bëhet publike, llogaritë e tyre financiare do të monitorohen sistematikisht dhe privatësia e komunikimeve të tyre në lidhje me punën do të kufizohet. Ata mbajnë përgjegjësi disiplinore në përputhje me ligjin, i cili ka parashikuar deklarimin e konfliktit të interesit dhe shkarkimin e tyre.

159. Kriteret për emërim në KPK dhe KPA duket se janë të barasvlershme me kriteret e emërimeve në gjyqësor dhe, së paku, duken po aq të rrepta sa ato në fuqi për emërimet në detyrë të përhershme gjyqësore. Përgatitjet për kryerjen e emërimeve duket se ishin projektuar të siguronin, për aq sa mundej, emërimin e kandidatëve me kualifikimin e përshtatshëm, të cilët do të përmbushin kriteret. U garantuan procedurat për mundësimin e emërimeve me anë të shumicës së

cilësuar në parlament, me një mekanizëm zhbllokues. Përveç faktit që këto nuk do të ishin institucione të përhershme, duket se qëllimi i parashikimeve kushtetuese dhe ligjore ishte t'u jepte atyre karakteristikat kryesore të gjykatave. Pas përfundimit të mandatit të tyre, çdo çështje në pritje për t'u gjykuar, në vijim, do të shqyrtohet nga institucionet e përhershme gjyqësore dhe të prokurorisë.

160. Sipas Komisionit të Venecias, bazuar në ligjin nr. 84/2016, vlerësimi i çdo informacioni dhe prove të mbledhur nga organet ekzekutive i takon KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të cilët dalin në përfundime në mënyrë të pavarur. Në pikëpamjen e tij, është normale dhe në përputhje me standardet evropiane, që provat e paraqitura përpara gjykatës, fillimisht të merren nga organet ekzekutive si policia apo prokuroria. Kjo nuk do të përbënte ndërhyrje në pushtetin gjyqësor, me kusht që vlerësimi i tyre, d.m.th. vlerësimi i vërtetësisë së tyre dhe peshës që do t'u jepet, të jetë çështje për vlerësim gjyqësor. Për më tepër, KPK-ja dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit do të kishin kompetenca të gjera për t'i hetuar dhe verifikuar vetë çështjet. Fakti që në procesin e rivlerësimit u përfshinë organet ekzekutive, duket se pati funksione ndihmëse dhe instrumentale në dhënien e ndihmës për institucionet e vlerësimit për përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, kompetenca e vendimmarrjes duket se mbetet e KPK-së dhe e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të krijuara për këtë qëllim, në përputhje me parashikimet kushtetuese si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme.

161. Në lidhje me atë nëse ligji nr. 84/2016 garanton të drejtën për proces të rregullt ligjor, Komisioni i Venecias deklaroi se rregullat në lidhje me kualifikimet e kërkuara dhe mënyrat e emërimit të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit janë projektuar për të garantuar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre si gjykata. Për më tepër, institucionet e rivlerësimit do të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe ligjin për gjykatat administrative për gjykimin e çështjeve individuale. Për më tepër, neni Ç, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, i ka përcaktuar qartë KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit detyrën për të garantuar të drejtën për proces të rregullt ligjor. Megjithëse në procesin e rivlerësimit, në disa raste zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit, për të cilën subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën, neni Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, parashikon qartë se kjo zbatohet vetëm për procesin e rivlerësimit dhe jo për procese të tjera, në veçanti proceset penale. Të dyja institucionet e rivlerësimit do të funksionojnë me transparencë; ato do të vërtetojnë faktet dhe rrethanat për çdo çështje, seancat e të cilave janë publike dhe vendimet e tyre do të jenë të arsyetuara dhe me shkrim.

162. Në lidhje me çështjen nëse kontrolli i figurës do të përbënte ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën për respektimin e jetës private, Komisioni i Venecias shprehu se ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme ndërmjet gjyqtarëve dhe krimit të organizuar do të binte ndesh me interesat e sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike, me gjasë të inkurajojë sesa parandalojë mungesën e rendit dhe kriminalitetin dhe, ka të ngjarë, më tepër të kërcënojë sesa të mbrojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Deklarata e kontrollit të figurës do të shërbejë si bazë për kryerjen e kontrollit të figurës. Duhet theksuar se deklarata e kontrollit të figurës nuk do të përdoret në asnjë proces penal. Ndërsa rolin kryesor në kryerjen e kontrollit të figurës e ka një grup pune, përdorimi i vlerësimit do të ishte nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Sipas këndvështrimit të Komisionit të Venecias, fakti që një informacion i caktuar nuk bëhet publik, do të ishte i arsyeshëm në rast se është në favor të subjektit të rivlerësimit. Është tepër e rëndësishme që relatori i çështjes të ketë akses në të gjitha dokumentet dhe materialet në zotërim apo në kontrollin e grupit të punës dhe që përfaqësuesi i relatorit të ketë marrë pjesë në takimet e grupit të punës.

b) Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese

163. Me anë të vendimit nr. 2 të datës 18 janar 2017, Gjykata Kushtetuese vendosi që edhe pse gjyqtarët e saj automatikisht do t'i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit, të parashikuar në ligjin nr. 84/2016, ajo kishte kompetencë për shqyrtimin e kërkesës së depozituar nga deputetët opozitarë, për aq kohë sa ligji nr. 84/2016 nuk i pengonte gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët do të vepronin në mirëbesim, të ushtronin detyrat e tyre në interpretimin e parashikimeve ligjore.

i. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve

164. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, Gjykata Kushtetuese thekson se neni 179/b i Kushtetutës, qartazi i ka dhënë kompetenca KPK-së për kryerjen e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në shkallë të parë, me mundësinë e ankimit përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pjesë e Gjykatës Kushtetuese. Procesi kalimtar i rivlerësimit u krijua si “masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme” për t’u zbatuar nga organet e rivlerësimit të specifikuar në Kushtetutë. Ndërsa Kushtetuta nuk mund të përmbante parashikime shteruese dhe të detajuara në lidhje me organizimin e jetës sociale dhe politike, zbatim i tyre do të kushtëzohej në një ligj tjetër të zbatueshëm. Legjislatura pati diskrecion të gjerë për përcaktimin e çështjeve që do të mbulonte ligji i posaçëm. Gjykata Kushtetuese vijoi me shqyrtimin veçmas të çdo kriteri.

165. Duke iu rikthyer vlerësimit të pasurisë, Gjykata Kushtetuese u shpreh se neni D i aneksit të Kushtetutës i kishte dhënë kompetenca ILDKPKI-së për verifikimin e deklaramit të pasurisë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë ekspertizën e ILDKPKI-së, infrastrukturën dhe përgjegjësitë ekzistuese. Detajet në lidhje me ushtrimin e procesit të verifikimit janë parashikuar në ligjin nr. 84/2016, i cili nuk është në kundërshtim me parashikimet kushtetuese. Për me tepër, Gjykata Kushtetuese vlerësoi pavarësinë e ILDKPKI-së për mbledhjen dhe verifikimin e informacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

166. Sa i takon vlerësimit të aftësive profesionale, deklarata e vlerësimit profesional (formulari i vetëvlerësimit profesional), pas plotësimit dhe dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit, i nënshtrohet rivlerësimit nga organi përgjegjës, në përputhje me nenin E të aneksit të Kushtetutës. Përveç caktimit të Shkollës së Magjistraturës si përgjegjëse për testimin e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, Kushtetuta nuk ka parashikuar organe të tjera përgjegjëse për vlerësimin e aftësive profesionale. Këto organe, të krijuara nga ligje të tjera, hartojnë një raport të detajuar dhe të arsyetuar dhe e dorëzojnë atë pranë KPK-së, e cila kryen kontrollin e fundit të procesit dhe vendos nëse subjekti i rivlerësimit është i “aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”.

167. Vlerësimi i aftësive profesionale bazohet në një formular të plotësuar nga subjekti i rivlerësimit dhe prova të tjera, si vendimet nga gjykatat vendëse apo të huaja dhe kryhet në përputhje me nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Sipas nenit 36, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit, në bashkëpunim me DISK-në, janë përgjegjëse për vlerësimin e aftësive profesionale. Gjykata Kushtetuese pranoi se institucionet e përmendura në nenin 36 të ligjit nr. 84/2016 do të luanin një rol aktiv në kryerjen e vlerësimit profesional. Për këtë arsye, iu referua opinionit *amicus curiae* të Komisionit të Venecias, i cili citon si më poshtë:

“[...] nëse procesi i rivlerësimit kryhet apo kontrollohet nga pushteti ekzekutiv, i gjithë procesi i rivlerësimit kalimtar mund të komprometohet. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të garantohet se përfshirja e ekzekutivit, në ligj dhe në praktikë, të kufizohet deri në shkallën që është ngushtësisht e domosdoshme për funksionimin efektiv të organeve të rivlerësimit”.

168. Pas shqyrtimit të nenit Ç, pika 4 e aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45, 50 dhe 51 të ligjit nr. 84/2016, Gjykata Kushtetuese arriti përfundimin se organet e rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës. Krijimi i një grupi të tillë pune sipas nenit 36 të ligjit nuk shfaq probleme nëse ai përfshin edhe përfaqësues të KPK-së. Kjo mund të garantohet nga prania e këshilltarëve ligjorë, të cilëve relatori i çështjes mund t’u kërkojë të marrin pjesë në takime të tilla.

169. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese arriti përfundimin se organet e tjera të përfshira në procesin e rivlerësimit do të ndihmonin organet e rivlerësimit në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rrethanat, referuar nenit 4, pika 2 të ligjit të rivlerësimit dhe nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, vendimmarrja i përket KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të cilat krijohen si institucione të pavarura dhe të paanshme. Organet e rivlerësimit kryejnë funksione mbikëqyrje dhe vlerësimi dhe nuk kushtëzohen nga konstatimet e institucioneve ndihmëse. Për aq kohë sa agjencitë ligjzbatuese kanë rol ndihmës dhe aktiviteti i tyre i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe kontrollit nga organet e rivlerësimit, ata nuk mund të nisnin aktivitetin e tyre pa u konstituuar më parë organet e rivlerësimit.

170. Falë qëllimit të tyre, funksionimit, ekspertizës dhe detyrave, institucionet ndihmëse ndihmojnë organet e rivlerësimit në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe përmbushjes së misionit të tyre në emër të parimit të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit të të gjithë institucioneve të përfshira në procesin e rivlerësimit. Ata nuk mund t'i kryejnë detyrat e tyre jashtë kontrollit të KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Kjo është e rëndësishme për të evituar çdo ndërhyrje të mundshme nga organet në varësi të pushtetit ekzekutiv, veçanërisht në rastin e kontrollit të figurës, shqetësim ky i ngritur edhe në opinionin e Komisionit të Venecias.

171. Sipas Gjykatës Kushtetuese, organet e rivlerësimit janë institucionet e vetme me kompetencë për shkarkimin e një gjyqtari apo prokurori nga detyra. Vetëm ato mund të përcaktojnë nëse deklaratat janë depozituar brenda afateve të parashikuara. Në përfundim të procesit, ata marrin një vendim të arsyetuar, duke përshkruar të gjithë vendimmarrjen.

ii. Në lidhje me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike

172. Gjykata Kushtetuese u shpreh se sipas nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, të gjithë gjyqtarët në detyrë, përfshirë ata të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, si dhe prokurorët në detyrë, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, do t'i nënshtrohen vlerësimit të aftësive profesionale, i cili do të kryhet nga i njëjti institucion. Legjislacioni në lidhje me statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve do të zbatohet në mënyrën e duhur.

173. Pavarësisht institucioneve të përfshira në procesin e rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese u shpreh se parashikimet ligjore nuk përmbajnë paqartësi që mund të çojnë në keqinterpretimin apo keqzbatimin e tyre. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, KPK-ja jep një vendim të arsyetuar, i cili përmban provat që shërbejnë si bazë për përfundimet e tij. Në këndvështrimin e Gjykatës, është e domosdoshme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale.

174. Më tej, Gjykata Kushtetuese qartësoi se, si rregull, periudha kohore në lidhje me vlerësimin profesional do të mbulojë tri vitet e fundit të eksperiencës profesionale. Megjithatë, sipas nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit mund të vendosin në raste përjashtimore për shtrirjen e periudhës së rivlerësimit, duke filluar nga 1 janari i vitit 2006. Në raste të tilla, informacioni shqyrtohet nëse relatori apo vëzhguesi ndërkombëtar e çmon si të domosdoshëm për procesin e vlerësimit.

iii. Në lidhje me kufizimet e pajustificuara mbi të drejtat themelore të njeriut

175. Në lidhje me kufizimet e vendosura nga Kushtetuta mbi anëtarët e organeve të rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese u shpreh se ata nuk mund të jenë objekt i kontrollit kushtetues. Në lidhje me kufizimet e vendosura nga ligji nr. 84/2016, Gjykata Kushtetuese u shpreh se ndërhyrja ishte e justifikuar nga interesi publik i uljes së nivelit të korrupsionit dhe rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Gjykata theksoi se është detyrë e organeve të rivlerësimit të kërkojnë respektimin e standardeve dhe të jurisprudencës evropiane.

176. Në përgjigje të pretendimit për cenimin e së drejtës së ankimit, Gjykata Kushtetuese u shpreh se Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 parashikojnë të drejtën për të ankimuar vendimin e KPK-së pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili është një organ i posaçëm i ngritur për garantimin e një game të gjerë të drejtash dhe garancish që u njihen subjekteve të rivlerësimit, siç është theksuar në opinionin *amicus curiae* të Komisionit të Venecias (shih paragrafin 161 më lart).

Konsiderohet se, duke pasur parasysh funksionimin e tyre, zgjedhjen e anëtarëve dhe kompetencat e tyre, institucionet e rivlerësimit duket se ofrojnë garancitë e kërkuara nga e drejta për proces të rregullt ligjor. Për më tepër, Kolegji i Posaçëm i Apelimit vendos përfundimisht për themelin e çështjeve dhe nuk mund ta rikthejë çështjen për rishqyrtim në KPK. Si e tillë, mund të thuhet se e drejta e ankimit është garantuar mjaftueshëm.

177. Në lidhje me kufizimin e së drejtës për ankim kushtetues, Gjykata Kushtetuese u shpreh se ky pretendim nuk mund të ishte objekt i kontrollit kushtetues për aq kohë sa parashikohet në ndryshimet kushtetuese. Megjithatë, duke marrë parasysh kompetencat e Kolegjit të Posaçëm të

Apelimit, i cili rishikon vendimet e marra nga KPK-ja, konsiderohet se ky proces do të jetë objekt mbikëqyrje nga pikëpamja kushtetuese.

iv. Në lidhje me pretendimin për cenim të proces të rregullt ligjor

178. Gjykata Kushtetuese u shpreh se, sipas nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, KPK-ja dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë të paanshme dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, si dhe parimet e tjera që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor për subjektet e rivlerësimit. Ata zbatojnë edhe parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative dhe ligjit për gjykatat administrative. Për më tepër, ligji nr. 84/2016 ka parashikuar garantimin dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit në nenet 35 deri 40, 45 deri 47, 55, 57, 63 dhe 65.

179. Ndërkohë që ligji nr. 84/2016 nuk ka përcaktuar afate kohore specifike për shqyrtimin e çështjeve individuale, organet e rivlerësimit kanë detyrën ta kryejnë atë brenda një kohe të arsyeshme. Rivlerësimi është një masë e përgjithshme e cila zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, pa shkaktuar pabarazi përpara ligjit.

180. Në përputhje me nenin Ç, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, proporcionaliteti ndërmjet së drejtës për respektim të jetës private dhe detyrës për të hetuar, si dhe së drejtës për proces të rregullt, do të zbatohet kurdo që merret informacion nga publiku, sipas neneve 53 dhe 54 të ligjit nr. 84/2016.

v. Përfundim

181. Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh procedurën ligjore të ndjekur për miratimin e ligjit nr. 84/2016, si dhe arsyet e përshkruara më lart, vendosi me shumicë votash të rrezojë shkaqet e ngritura në kërkesën e paraqitur nga kërkuessit.

vi. Mendimi i pakicës

182. Dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese (B.I. dhe G.D.) dhanë mendim pakice. Në pikëpamjen e tyre, parashikimet ligjore e kanë transferuar hetimin dhe kontrollin e procesit të rivlerësimit nga organet e rivlerësimit drejt institucioneve ekzistuese të cilat kontrollohen nga pushteti ekzekutiv. Në mbështetje të këtij argumenti, ata theksuan se neni 35 i ligjit nr. 84/2016 kërkon që subjektet e rivlerësimit të depozitojnë pranë DSIK-së deklaratën e tyre të kontrollit, ndërsa neni DH, pika 2 e aneksit të Kushtetutës kërkon që këto subjekte ta depozitojnë atë deklaratë edhe pranë KPK-së. Për më tepër, DSIK-ja dhe organet e tjera, të cilat kontrollohen nga pushteti ekzekutiv, i nisën verifikimet e deklaratave të kontrollit të figurës në kohën kur organet e rivlerësimit nuk ishin konstituuar ende. Kështu, DSIK-ja do të kryente një verifikim *de facto* të deklaratës së kontrollit të figurës, pa mbikëqyrjen apo kontrollin e organeve të rivlerësimit.

183. Për më tepër, gjyqtarët në pakicë nuk u pajtuan me parashikimet ligjore në lidhje me shkarkimin nga detyra të subjektit në rast mosdorëzimi të deklaratës së pasurisë apo deklaratës së kontrollit të figurës brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016. Për aq kohë sa organet e rivlerësimit nuk ishin formuar ende, mbetej e paqartë se si do të zbatoheshin këto parashikime dhe se si mund të merreshin vendimet. Për këtë arsye, ata argumentuan se shprehja “brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi”, e përdorur në nenet 31, 35 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016, duhej të ishte shfuqizuar.

184. Së fundi, gjyqtarët në pakicë vlerësuan se fakti se periudha e vlerësimit të aftësive profesionale mund të shtrihet deri në dhjetë vjet, ose për një periudhë më të gjatë, krijon dyshime serioze në lidhje me respektimin e parimit të sigurisë juridike. Kjo, gjithashtu, mund të çonte në trajtim të pabarabartë të subjekteve të rivlerësimit.

5. Praktika gjyqësore e Kolegjit të Posaçëm të Apelit

185. Përmbledhja e vendimeve të mëposhtme, të marra nga Kolegji i Posaçëm i Apelit përpara dhënies së vendimit në çështjen e kërkuesses, është kufizuar në një përshkrim të çështjeve procedurale me qëllim shmangien e paragjyimit të rezultatit të procesit të brendshëm, në lidhje me të cilat subjektet e rivlerësimit, paraqitën një kërkesë pranë kësaj Gjykate.

i. Vendimi nr. 3 datë 17 korrik 2018 (nr. 3/2018)

186. Në vendimin e tij të parë të themelit (nr. 3/2018), Kolegji i Posaçëm i Apelit, sipas nenit 47 të ligjit për gjykatat administrative, refuzoi të pranonte të merrte provat e reja të ankuesit si pjesë

e dosjes së gjykimit, duke deklaruar se ai nuk kishte arritur të paraqiste shkaqe të arsyeshme për mosdepozitim të atyre provave pranë KPK-së. I njëjti konstatim u dha edhe në vendimin nr. 7/2008, ku Kolegji i Posaçëm i Apelit shprehu se, referuar nenit 49, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, provat e reja nuk ishin të rëndësishme për procesin e vendimmarrjes. Në vendimin nr. 3/2018, Kolegji i Posaçëm i Apelit vendosi të mos zhvillonte një seancë publike

187. Kolegji i Posaçëm i Apelit u shpreh se edhe pse procesi i rivlerësimit do të zhvillohej mbi bazën e vlerësimit të tri kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, vendimi përfundimtar mund të kufizohet në vetëm një prej tyre. Kjo qasje u mundësua nga formulimi i nenit 4, pika 2 i ligjit nr. 84/2016 dhe nuk kishte asnjë parashikim tjetër ligjor i cili pengonte një mënyrë të tillë të vepruari. Në çështjen e kërkuarit, KPK-ja vlerësoi se, bazuar në provat në dosje, rivlerësimi mund të përmbillet sa i takon vlerësimit të pasurisë, duke mos pasur nevojë për të vijuar me vlerësimin e kriterëve të mbetura. Një konstatim i tillë u dha edhe në vendimet nr. 4/2018 dhe nr. 8/2018.

188. Kolegji i Posaçëm i Apelit, referuar nenit Ç, pika 4 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka shprehur se KPK-ja ka kompetencë të përdorë si prova të gjitha deklaratimet e mëparshme të pasurisë të depozituara nga ankuesi pranë ILDKPKI-së me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit (deklarata e rivlerësimit). Ky konstatim u përsërit edhe në vendimin nr. 8/2008. Çdo hetim i mëparshëm gjithëpërfshirës i kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2011, i cili nuk mund të përbëjë gjë të gjykuar në kuadër të ligjit nr. 84/2016, nuk e pengonte KPK-në të kryente një hetim të thelluar në të tria kriteret e parashikuara në ligjin nr. 84/2016. (shih, gjithashtu, edhe paragrafin 191 më poshtë).

189. Sa i takon pretendimit se nuk është përcaktuar metodologji për përcaktimin e të ardhurave, Kolegji i Posaçëm i Apelit u shpreh se nuk ishte e nevojshme të përcaktohet zbatimi i metodologjisë, meqë, sipas nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, ankuesit i duhej të jepte shpjegime bindëse në lidhje me burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të ardhurave, të cilat ai duhej t'i kishte deklaruar dhe, në lidhje me të cilat, ai duhet të kishte paguar taksat. Meqë ankuesi nuk arriti të demonstronte ekzistencën e këtyre të ardhurave të ligjshme për periudhën nga viti 1994 deri në vitin 2003, nuk u zbatua asnjë metodologji e parashikuar.

ii. Vendimi nr. 4 datë 26 korrik 2018 (nr. 4/2018)

190. Në vendimin nr. 4/2018, Kolegji i Posaçëm i Apelit, në përputhje me nenin 49 të ligjit për gjykatat administrative, vendosi të mos zhvillojë seancë publike për çështjen e ankuesit, duke deklaruar se: i. faktet janë vërtetuar plotësisht dhe me saktësi; ii. se nuk kishte shkelje serioze procedurale; dhe iii. nuk ishte e nevojshme rihapja e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimi i provave të reja. I njëjti konstatim u bë edhe në vendimin nr. 7/2018.

191. Kolegji i Posaçëm i Apelit hodhi poshtë argumentin e ankuesit se moskonstatimi i shkeljeve në deklarimin e pasurisë në kontrollin e kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2013 përbënte gjë të gjykuar, duke deklaruar se vlerësimi i pasurisë mundësohej *lex specialis*, pikërisht nga ligji nr. 84/2016, i cili ka përcaktuar një metodologji dhe procedurë të ndryshme nga kontrollet e mëparshme. Ky vlerësim do të administrohet vetëm një herë nga një organ tjetër, siç është KPK-ja, e cila ka kompetencën për marrjen e vendimit në çdo çështje individuale.

C. Kodi i Procedurës Administrative (ligji nr. 44/2015)

192. Nenet 35–40 kanë të bëjnë me përfaqësimin e palëve përpara një organi publik. Neni 45 garanton të drejtën e palëve për njohjen me dosjen. Neni 46 parashikon që të drejtat e palëve mund të kufizohen sipas nenit 45, dhe neni 47 garanton të drejtën e palëve për të paraqitur mendime, shpjegime, prova apo të bëjnë propozime rreth fakteve, rrethanave, çështjeve ligjore dhe zgjidhjen e çështjes.

D. Ligji për gjykatat administrative (ligji nr. 49/2012 mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, i ndryshuar)

193. Ligji për gjykatat administrative përcakton rregullat në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative, si dhe parimet dhe procedurën për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

194. Neni 47 parashikon se në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i

kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.

195. Neni 49, pika 1 parashikon që shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Sipas nenit 49, pika 2, kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri pesë ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.

196. Sipas nenit 51, pika 1, gjykata e apelit, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: i. për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; ii. vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; iii. me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsëritë marrjen e disa ose të gjitha provave.

E. Kodi i Procedurës Civile (“KPC”) (ligji nr. 8116 datë 29 mars 1996, i ndryshuar)

197. Sipas nenit 72, pika 6 e KPC-së, gjyqtari mund të heqë dorë nga proceset civile duke i drejtuar një kërkesë kryetarit të gjykatës, në rastet kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetres pale; 5. është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim; 6. “në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

198. Përveç kësaj, neni 74 parashikon se palët në proces mund të kërkojnë përjashtimin e një gjyqtari nga shqyrtimi i çështjes së tyre.

F. Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577 i datës 10 shkurt të vitit 2000 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016)

199. Neni 36, pika 1 e ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ashtu siç ishte në fuqi deri më 22 nëntor 2016, parashikonte që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese është i detyruar të heqë dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur: a) ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi; b) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim vihet në dyshim objektiviteti i tij; ose c) në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie. Sipas nenit 37, pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit kur ekziston një nga rastet e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji dhe gjyqtari nuk heq dorë nga shqyrtimi i çështjes.

200. Deri më datë 22 nëntor të vitit 2016, ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk përmbante parashikime lidhur me përgjegjësinë disiplinore. Neni 10, pas ndryshimeve të 23 nëntorit të vitit 2016, detajon rastet që mund të çojnë në përgjegjësi disiplinore për një gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 10/b, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mund të vendosen këto masa disiplinore: vërejtje me shkrim, vërejtje publike, ulje e përkohshme e pagës deri në 50 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit, pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 muaj deri në 6 muaj dhe, shkarkim nga detyra.

G. Ligji për deklarimin e pasurisë (ligji nr. 9049 i datës 10 prill 2003 mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, i ndryshuar nga viti 2006 deri 2018)

201. Pas hyrjes në fuqi të ligjit për deklarimin e pasurive në vitin 2003, sipas nenit 6, gjyqtarëve dhe prokurorëve iu kërkuar të kryejnë deklarimin fillestar të pasurisë. Neni 9 parashikon që kjo kërkesë të zbatohet edhe për gjyqtarët dhe prokurorët që sapo nisnin të ushtrorjnë funksionet. Sipas

ligjit “Për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i cili ka hyrë në fuqi më 26 maj të vitit 2005 (“ligji për parandalimin e konflikteve të interesit” – ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar), gjyqtarëve dhe prokurorëve u kërkohet të deklarojnë të gjitha rastet e konflikteve të interesit, siç përcaktohet në ligj. Pas ndryshimeve në ligjin për deklarimin e pasurive në vitin 2012, deklaratimet vijuese të pasurive dhe konflikteve të interesit duhej vetëm të tregonin ndryshimet me deklaratën fillestare apo deklaratat e mëparshme, sipas rastit. Neni 9/1, i miratuar në vitin 2012 (me ligjin nr. 85/2012), parashikon që çdo deklaram të shoqërohet me një autorizim të veçantë, ku deklaruesi autorizon organet e përcaktuara të verifikojnë brenda dhe jashtë vendit dhe të kontaktojnë çdo person të cilin ata e konsiderojnë të nevojshëm.

202. Deklarata vjetore e pasurisë paraqitet pranë ILDKPKI-së deri më datë 31 mars të çdo viti kalendarik, sa u takon pasurive dhe detyrimeve për periudhën nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit pararendës. Neni 4 liston pasuritë të cilat duhen deklaruar, siç janë pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, sendet me vlerë të veçantë të cilat tejkalojnë një prag të caktuar, vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim, kursimet *cash*, llogaritë bankare, bonot e thesarit dhe huat, të ardhurat personale për vitin, licencat dhe patentat që sjellin të ardhura, dhuratat dhe trajtimet preferenciale që tejkalojnë një vlerë të caktuar, angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura dhe, interesat privatë që bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës. Përveç kësaj, duhen deklaruar edhe burimet e përdorura për krijimin e tyre, çdo shpenzim që tejkalon një prag të caktuar, detyrimet financiare, përfshirë ato në lidhje me anëtarët e familjes dhe personat e lidhur. Neni 4/1 i ligjit nr. 45/2014, i cili hyri në fuqi më 11 qershor të vitit 2014, u kërkoi të gjithë zyrtarëve dhe nëpunësve publikë të cilët mbajnë në shtëpi gjendje *cash* mbi shumën 1.5 milionë lekë (11,990 euro), ta depozitojnë atë në një llogari bankare përpara dorëzimit të deklaratës së interesave privatë.

203. Neni 22 parashikon që deklaratat e pasurisë i nënshtrohen kontrollit paraprak nga ILDKPKI-ja, e cila verifikon nëse deklaratat (dhe anekset e saj) janë plotësuar siç duhet dhe në mënyrë të saktë. Ato mund t'i nënshtrohen një kontrolli të plotë, i cili përfshin kontrolle aritmetike dhe logjike. Sipas ndryshimeve të vitit 2012, kontrolli i plotë kryhet çdo dy vjet për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese dhe, çdo tri vjet për gjyqtarët e gjykatave të apelit. Pas ndryshimeve të vitit 2014 (të miratuara nga ligji nr. 45/2014), gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë i nënshtrohen kontrollit të plotë çdo katër vite (më parë, ata i nënshtroheshin kontrolleve rastësore, të cilat mbulonin të paktën 4% të numrit total të deklaratave të dorëzuara pranë ILDKPKI-së).

204. Sipas nenit 5, refuzimi për deklarim të pasurive dhe konflikteve të interesit çon në shkarkim nga detyra dhe përgjegjësi penale të zbatueshme, pas njoftimit që ILDKPKI-ja i jep organit përgjegjës punëdhënës. Sipas nenit 38, deklarim i rremë i pasurisë përbën vepër penale sipas legjisllacionit të zbatueshëm penal (neni 257/a i Kodit Penal). Fillimisht, ligji parashikonte se mosdeklarimi i pasurisë brenda afatit dhe pa shkaqe të arsyeshme dënohej me gjobë prej 25,000 lekësh (199 euro), e cila dyfishohej në rast shkelje të përsëritur. Në vitin 2012, masa e gjobës u rrit, duke variuar nga 50,000 lekë (399 euro) në 100,000 lekë (798 euro).

205. Sa u takon gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit, neni 32 (2) (ç) i ligjit të vitit 2008 për gjyqësorin (ligji nr. 9877/2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar), i cili hyri në fuqi më 15 mars 2008, ndër të tjera, parashikonte se “refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive” përbën shkelje “shumë të rënda” disiplinore, të cilat pasjellin shkarkim nga detyra, në përputhje me nenin 33, pika 3 të tij. Ligji për gjyqësorin i vitit 2008 u shfuqizua si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit për gjyqësorin i vitit 2016 (ligji nr. 98/2016) më datë 22 nëntor 2016.

H. Ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” (ligji nr. 96/2016, i ndryshuar)

206. Ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i cili hyri në fuqi më 22 nëntor 2016, përcakton rregullat për emërimin si gjyqtar. Sipas nenit 28, pika dh, çdo person ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në formimin fillestar si magjistrat nëse nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Ish-gjyqtarët, gjithashtu, mund të rriemërohen, me kusht që të përmbushin, ndër të tjera, kërkesën e përcaktuar në nenin 28, pika dh.

Neni 150, pika 3, parashikon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri i masave disiplinore i autoriteteve përgjegjëse.

207. Neni 166, pika 6 parashikon se “anëtari i Kolegjit të Apelit emërohet si gjyqtar në nivel apeli në përfundim të mandatit, përveç rasteve kur ndaj tij është dhënë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës”.

I. LIGJI PËR PROFESIONIN E AVOKATIT (LIGJI NR. 55/2018 “PËR PROFESIONIN E AVOKATIT”)

208. Sipas nenit 13, pika 1, e drejta për ushtrimin e profesionit të avokatit fillon nga momenti i fitimit të titullit profesional “Avokat” dhe, në çastin e fitimit të titullit profesional, avokati pajiset nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë me “Certifikatën e avokatit”. Neni 13, pika 2, përmban një listë të kërkesave të përgjithshme që duhen përmbushur për të fituar titullin “avokat”, ndër të cilat, më me rëndësi për këtë çështje është që “nuk është shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm”.

209. Neni 51 i ligjit “Për profesionin e avokatit” parashikon që gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative të lindura ndaj vendimeve të Komitetit Disiplinor, të parashikuara nga ky ligj, është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë.

II. MATERIALE NDËRKOMBËTARE ME RËNDËSI

A. Materiale në lidhje me gjyqësorin

210. Dokumente të rëndësishme të Këshillit të Evropës, si ekstraktet nga Rekomandimi (2010) 12 i Komitetit të Ministrave, Magna Carta e Gjyqtarëve (Parimet Themelore) dhe Karta Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët, mund të gjenden në *Baka k. Hungarisë* ([GC], nr. 20261/12, paragrafi 77, 78 dhe 81, 23 qershor 2016).

211. Dokumente ndërkombëtare me rëndësi, si ekstraktet nga Parimet e Banglores të Sjelljes Gjyqësore mund të gjenden në *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të Tjerë k. Gjeorgjisë* (nr. 16812/17, paragrafi 224, 18 korrik 2019), dhe *Harabin k. Sllovakisë* (nr. 58688/11, paragrafi 107, 20 nëntor 2012).

B. Materiale në lidhje me luftën ndaj korrupsionit

1. Materiale të Kombeve të Bashkuara

212. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit hyri në fuqi për Shqipërinë më 25 maj 2006, pas nënshkrimit më 18 dhjetor 2003. Qëllimi kryesor i saj është përkrahja dhe fuqizimi i masave për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në mënyrë më të efektshme. Në këtë drejtim, neni 8, i cili i bën thirrje shteteve palë të zbatojnë kode të sjelljes për nëpunësit publikë, ndër të tjera, parashikon se shteti palë duhet “të caktojë masa dhe sisteme që u kërkojnë nëpunësve publikë të bëjnë deklaratë tek autoritetet e duhura, ndër të tjerash, në lidhje me aktivitetet e jashtme, punësimin, investimet, pasuritë dhe dhuratat ose privilegjet e mëdha nga të cilat mund të lindë një konflikt interesash për shkak të funksioneve të tyre si nëpunës publikë” dhe “të marra masa disiplinore apo të tjera ndaj nëpunësve publikë të cilët shkelin kodet apo standardet”.

2. Materiale të Këshillit të Evropës

a) Instrumente ligjore

213. Konventa Penale për Korrupsionin (ETS nr. 173) hyri në fuqi për Shqipërinë më 1 korrik 2002. Ajo synon kriminalizimin e koordinuar të një sërë praktikash korrupsioni, siç përcaktohet në nenet 2 deri 14 të saj. Zbatimi i saj monitorohet nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (“GRECO”), i themeluar në vitin 1999.

214. Konventa Civile për Korrupsionin (ETS nr. 174) hyri në fuqi për Shqipërinë më 1 nëntor 2002. Ajo u kërkon palëve nënshkruese të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm “rregullime efektive për personat që dëmtohen si rezultat i veprimeve korruptive, t’u japë atyre mundësi të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, duke përfshirë dhe mundësinë për t’u kompensuar për dëmin”. Zbatimi i saj monitorohet nga GRECO-ja.

215. Rekomandimi nr. R (2000)10 i Komitetit të Ministrave mbi kodet e sjelljes për nëpunësit publikë u miratua më datë 11 maj të vitit 2000, duke rekomanduar miratimin e kodeve kombëtare të sjelljes për nëpunësit publikë, bazuar në kodin model të sjelljes në shtojcën e rekomandimit. Sipas

nenit 14 të kodit model, nëpunësi publik “në pozicionin e të cilit, interesat e tij/saj personalë apo privatë ka të ngjarë të ndikohen nga detyrat e tij zyrtare, siç kërkohet nga ligji, duhet të deklarojë pas emërimit, dhe, më pas, në intervale të rregullta kohore dhe kurdo që ndodhin ndryshime, natyrën dhe shkallën e këtyre interesave”. Sipas nenit 28, shkelja e parashikimeve të kodit model të sjelljes mund të rezultojë në masa disiplinore.

b) Raporte vlerësimi të GRECO-s

216. Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) monitoron pajtueshmërinë e Shteteve me standardet kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës. Ky organ funksionon me cikle/intervale, të njohura ndryshe si periudha vlerësimi, ku çdo periudhë mbulon tematika specifike. Pas vizitës në një shtet të caktuar, ekipi i vlerësimit të GRECO-s (“GET”) harton një raport vlerësimi, i cili mund të përfshijë rekomandime që kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve nga shteti në fjalë për të siguruar përputhshmërinë me to.

217. Në raundin e parë të vlerësimit lidhur me pavarësinë, specializimin dhe mjetet e organeve vendëse të angazhuara në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili u zhvillua në Shqipëri nga data 8 deri më 12 prill 2002, në seksionin e raportit të tij të vlerësimit “Fenomeni i korrupsionit dhe perceptimi i tij në Shqipëri”, për sa i përket gjyqësorit, GET është shprehur si më poshtë:

“13. Sondazhet (referuar statistikave sipas Qeverisë) e kryera me mbështetjen e komuniteteve ndërkombëtare, tregojnë se sistemi gjyqësor, rrjeti i Doganave, Agjencia e Privatizimit dhe shërbimi shëndetësor janë ndër më të korruptuarit në vend... Autoritetet shprehen se forma më e zakonshme e korrupsionit në Shqipëri është ryshfeti. Nëpunësit civilë ose zyrtarë të tjerë janë të prirur të pranojnë ryshfet për të përshpejtuar ofrimin e shërbimeve, mosdhënien e dënimeve të parashikuara në ligj/rregullore ose gjyqtarë që mund të jenë të gatshëm të ndryshojnë vendimet e gjykatave etj. Sondazhet, gjithashtu, tregojnë se është më se e zakonshme që ndërmarrjet private t’u ofrojnë ryshfet zyrtarëve publikë për të shmangur taksat dhe rregulloret, apo që vendimet e gjykatës dhe të arbitrazhit po blihen”.

218. Seksioni i analizës së raportit të vlerësimit, në lidhje me gjykatat, lexonte si më poshtë:

“156. ... Pavarësia e sistemit gjyqësor ka një rëndësi të madhe për sa i përket sundimin e ligjit, megjithatë, një pavarësi e tillë nuk është pa kufij dhe duhet të jetë e lidhur me një sistem përgjegjësish. Pavarësia e sistemit gjyqësor është e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe autoritetet po ndërmarrin hapa për të vendosin një mekanizëm llogaridhënie ndaj gjyqtarëve. GET e pranon që ekzistojnë disa vështirësi të lidhura me këtë, duke marrë parasysh që sistemi gjyqësor në Shqipëri duket se vuan nga një mungesë e përgjithshme e besimit të publikut në të. Për më tepër, kjo është një fushë ku autoritetet shqiptare i konsiderojnë masat kundër korrupsionit si shumë të rëndësishme. Sidoqoftë, vlen të theksohet se sistemi gjyqësor përbëhet nga zyrtarë të përkushtuar që punojnë në kushte të vështira.”

219. Në raundin e dytë të vlerësimit në lidhje me, ndër të tjera, administratën publike dhe korrupsionin, i cili u krye në Shqipëri nga datat 11 deri më 15 tetor 2004, GET në raportin e tij në lidhje me këtë, u shpreh si më poshtë:

“34. Në Shqipëri ka nisur punën një organ i ri auditimi, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe [Kontrollin] e Pasurive. Ky organ është një institucion i pavarur që ka për detyrë të verifikojë deklarin e detyrueshëm të pasurive që u kërkohet individëve, veçanërisht atyre të ekspozuar ndaj korrupsionit. Zyrtarët publikë të nivelit të mesëm, të lartë të zgjedhur, duke përfshirë nivelin lokal, si dhe gjyqtarët, prokurorët etj., kanë detyrimin ligjor të deklarojnë të gjitha llojet e pasurive, detyrimet financiare, të ardhurat etj., të ky organ. Anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë, gjithashtu, i nënshtrohen këtij detyrimi. Mosrespektimi i këtij parashikimi mund të çojë në sanksione disiplinore, administrative dhe/ose penale. Kontrolli i gjendjes së tyre financiare kryhet duke kërkuar informacion nga bankat, regjistrat etj. të cilat përmbajnë informacione përkatëse. Këto lloj institucioneesh janë të detyruar të ofrojnë përgjigje dhe informacione të sakta ndaj kërkesave të tilla. Rastet e dyshimta i janë nënshtruar shqyrtimit përkatës tashmë. Në një rast, një person është pushuar nga puna; ky rast u raportua edhe në institucionin e prokurorisë.”

220. Raundi i katërt i vlerësimit të GRECO-s, i cili u krye në Shqipëri nga datat 28 tetor deri më 1 nëntor 2013, u përqendrua në parandalimin e korrupsionit tek anëtarët e parlamentit, deputetët,

gjyqtarët dhe prokurorët. Në lidhje me gjyqtarët, GRECO-ja në këtë raport vlerësimi ka parashtruar si më poshtë:

“13. Sipas Barometrit Global të Korrupsionit 2013, perceptimi i korrupsionit brenda sistemit gjyqësor është më i larti (81% e të anketuarve). Sipas mendimit të Fondacionit Heritage, një kulturë e mosndëshkimit dhe ndërhyrjes politike e ka bërë të vështirë për sistemin gjyqësor që të merret me korrupsionin në nivele të larta dhe të rrënjësor thellë, dhe zbatimi i reformave më të thella institucionale për të rritur pavarësinë e gjyqësorit dhe çrrënjësjet e korrupsionit të vazhdueshëm mbetet kritik. Shkalla tejet e lartë e korrupsionit në sistemin gjyqësor është vënë në dukje edhe në raportet e Komisionit Evropian dhe të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës

...

53. Diskutimet me përfaqësues të vendit theksuan rëndësinë që i është dhënë deklaramit të pasurisë nga zyrtarët dhe monitorimin e rregullt dhe të hollësishëm të kryer nga ILDKPI-ja. Pjesë e procedurës së deklaramit të pasurive janë një numër i konsiderueshëm zyrtarësh (aktualisht rreth 4,670 persona), si dhe pjesëtarët e familjes së tyre, “personat e besuar” dhe “bashkëjetues/bashkëjetuesit”. GET u informua se, për shkak të aftësisë së kufizuar të ILDKPI-së për të përpunuar të gjitha deklaratat dhe për të kontrolluar në kohën e duhur deklaramit e tyre, [Deklarata e Pasurive] iu nënshtruar ndryshime më 2012, duke prezantuar një trajtim të veçantë për kategori të ndryshme të zyrtarëve.

...

75. ... sistemi i prezantuar së fundmi për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve nuk mund të konsiderohet efektiv dhe efikas për shkak të kohës së konsiderueshme që ka kaluar ndërmjet vlerësimit dhe periudhës së referimit. GRECO-ja nuk është dakord me mendimin e autoriteteve që pohojnë se një vlerësim i tillë nuk mund të menaxhohet në kohë reale pasi kohëzgjatja mesatare e gjykimit përpara tri instancave është deri në tre vjet. Një sistem i mirë-konceptuar i vlerësimeve periodike lejon jo vetëm për monitorimin e performancës së gjyqtarit dhe avancimin e tij me kalimin e kohës, por edhe për konstatimin e hershëm të problematikave, siç është ngarkesa e lartë e çështjeve dhe numri i prapambetur i tyre me të cilin përballen shumë gjyqtarë dhe që mund dhe duhet të adresohet në një fazë të hershme. Në dritën e perceptimit të lartë publik të korrupsionit në sistemin gjyqësor, një tjetër burim shqetësimi që duhet të merret në konsideratë, është mungesa e dukshme e kriterëve të mire-formuluara për vlerësimin periodik të cilësive etike të gjyqtarit (si vazhdim i vlerësimit të integritetit që kryhen përpara emërimit).

Deklarimi i pasurisë, të ardhurave, detyrimeve dhe interesave

95. Siç edhe është shprehur më sipër, procedura e deklaramit të pasurive konsiderohet gjerësisht si një mjet i rëndësishëm në luftën ndaj korrupsionit dhe arritjen e transparencës më të madhe të interesave private të zyrtarëve, përfshirë anëtarët e sistemit gjyqësor. Megjithatë, problematikat që vijnë nga mungesa e publikimit në kohë të deklaratave të pasurisë së deputetëve, kanë të njëjtin efekt për të gjitha kategoritë e gjyqtarëve dhe çojnë në zvogëlimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Thënë kjo, rreziqet e krijuara nga ky publikim me vonesë i këtyre deklaratave, zbuten në njëfarë mase nga kohëzgjatja e shërbimit të gjyqtarit, e cila nuk është e parashkruar. Për këtë arsye, GRECO nuk mund të japë një rekomandim specifik për këtë çështje; prapëseprapë i inkurajon autoritetet të sigurojnë botimin në kohë të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve në një faqe zyrtare në internet, duke pasur në mendje privatësinë dhe sigurinë e gjyqtarëve dhe anëtarëve të familjes së tyre që i nënshtrohen këtij detyrimi deklarues.

...

Mbikëqyrja e deklaramit të pasurive, të të ardhurave, detyrimeve dhe interesave

97. Mbikëqyrja e deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve është, gjithashtu, detyrë e ILDKPI-së. Kjo mbikëqyrje kryhet njësoj si ajo që zbatohet për anëtarët e parlamentit, me përjashtim të faktit se deklaratat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve anëtarë të KLD-së [Këshillit të Lartë të Drejtësisë] i nënshtrohen kontrollit çdo dy vjet, gjyqtarët e gjykatave të apelit – çdo tre vjet dhe, së fundmi, deklaratat e gjyqtarëve të gjykatave të rrethit i nënshtrohen kontrolleve vjetore sipas rastit. Në rast refuzimi ose mosdeklarimi, fshehje ose deklarimi të rremë të pasurisë, ILDKPI-ja ia referon

çështjen Prokurorisë për procedim penal, KLD-së dhe ministrin të Drejtësisë – për [masën] disiplinore të shkarkimit nga detyra.

...

99. Siç u përmend më lart, gjyqtarët mbajnë përgjegjësi disiplinore për shkelje të ligjit dhe kryerje të veprimeve dhe sjellje që diskreditojnë reputacionin dhe integritetin e tyre. Shkeljet “shumë të rënda” (p.sh. mosrespektimi i rregullave të papajtuëshmërisë; refuzimi për të deklaruar, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë; marrja, drejtpërdrejt ose indirekt, e dhuratave, favoreve, premtiveve ose trajtimit preferencial, gjatë ushtrimit të detyrave; mosheqja dorë nga gjykimi; mungesa absolute e arsytimit në një vendim gjyqësor) sanksionohen me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Shkeljet “e rënda” (p.sh. vonesat e përsëritura dhe të pajustificuara procedurale; ndërhyrjet ose çfarëdo lloj ndikimi tjetër të ushtruar mbi një gjyqtar tjetër; shkelja e normave etike në marrëdhëniet me palët, kolegët, kryetarin e gjykatës dhe stafin, ekspertët, prokurorët dhe avokatët) dënohen me transferim nga një deri në dy vjet në një gjykatë të shkallës më të ulët ose të nivelit të njëjtë jashtë rrethit gjyqësor të emërimit të gjyqtarit. Së fundmi, shkeljet “e vogla” çojnë në vërejtje ose vërejtje me paralajmërim.

100. Procedimet disiplinore kryhen nga KLD-ja. Periudha e parashkrimit është një vit nga data e konstatimit të shkeljes nga ministri i Drejtësisë dhe pesë vjet nga data e kryerjes së saj.

c) Raporti i Komisionit të Venecias

221. Më datë 9 dhjetor 2020, Komisioni i Venecias publikoi një mendim urgjent mbi situatën kushtetuese të shkaktuar nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës, e cila kishte deklaruar si antikushtetuese disa parashikime ligjore në sferën e antikorrupsionit, përfshirë një dispozitë të ligjit penal që parashikonte përgjegjësinë penale për dorëzimin e deklaratave të rreme të pasurisë ose mosdorëzimin e deklaratës. Disa nga paragrafët të mendimit të Komisionit të Venecias që lidhen me këtë çështje, janë si më poshtë:

“34. Duke qenë se argumenti kryesor i [Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës] është pretendimi për “mungesë proporcionaliteti” të [dispozitës së ‘ligjit penal’], sanksione të vendosura sipas situatës, mund të parashikohen në dispozitën e rishikuar: për shembull, sanksioni i dënimit me burg mund të ruhet vetëm për rastet mbi një prag të caktuar dhe për autorët e krimit që veprojnë me dashje të qëllimshme. Thënë kjo, në këndvështrimin e Komisionit [të Venecias], niveli i gjobave monetare dhe sanksioneve të tjera duhet të jenë mjaft të larta për të vepruar si [një] parandalues dhe për të siguruar një dënim që është proporcional me rëndësinë që ka lufta kundër korrupsionit në Ukrainë. Sanksioni i dënimit me burg duhet të ruhet për shkeljet më të rënda.

C. Praktikrat gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE)

1. *Vendimet në çështjet “Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës së Lartë, C-619/18) dhe Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm)”*

222. Në përgjigje të një padie në lidhje me pretendimet për shkelje të ligjit të Bashkimit Evropian që vijnë nga miratimi i një ligji të ri të brendshëm në Gjykatën e Lartë të Polonisë, të paraqitur nga Komisioni Evropian kundër Polonisë (çështja e Komisionit kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës së Lartë), C 619/18), më 24 qershor 2019, Kolegji i Lartë i GJDBE-së u shpreh se Polonia nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas ligjit të Bashkimit Evropian, së pari, duke thënë se masa që konsistonte në uljen e moshës së pensionit në 65 vjeç të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë aplikohet për gjyqtarët në detyrë të cilët ishin emëruar në atë gjykatë përpara datës në të cilën ligji përkatës kishte hyrë në fuqi dhe, së dyti, duke i dhënë Presidentit të Republikës lirinë e veprimit për të zgjatur periudhën e veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve të asaj gjykate përtej moshës së pensionit të caktuar rishtas. GJDBE-ja u shpreh se zbatimi i masës që ulte moshën e pensionit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për gjyqtarët në detyrë brenda asaj gjykate nuk ishte i justifikuar nga një qëllim i arsyeshëm dhe minonte parimin e mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve, i cili ishte thelbësor për pavarësinë e tyre.

223. Në përgjigje të ndërmarrjes së ndonjë veprimi në lidhje me pretendimet për shkelje të ligjit të Bashkimit Evropian të shkaktuara nga ndryshimet në ligjin polak për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, të sjella nga Komisioni Evropian kundër Polonisë (çështja e Komisionit kundër Polonisë (Pavarësia e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm C 192/18), më datë 5 nëntor 2019, Kolegji i

Lartë i GJDBE-së u shpreh se Polonia nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas ligjit të Bashkimit Evropian, së pari, duke caktuar një moshë tjetër pensioni për meshkujt dhe femrat që ishin gjyqtarë ose prokurorë publik në Poloni dhe, së dyti, duke ulur moshën e pensionit të gjyqtarëve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm duke i dhënë ministrit të Drejtësisë kompetencën për të zgatur periudhën e shërbimit aktiv të atyre gjyqtarëve. Sa i përket pushtetit të dhënë ministrit të Drejtësisë, GJDBE-ja konstatoi se dispozitat ligjore kombëtare që përcaktonte kushtet themelore dhe rregullat e hollësishme procedurale që rregullojnë miratimin e vendimeve nga ministri i Drejtësisë krijuan “dyshime të arsyeshme, ndër të tjera, në mendjet e individëve, për sa i përket mosndikimit të gjyqtarëve nga faktorët e jashtëm dhe për asnjësinë e tyre në lidhje me çdo interes që mund të jetë subjekt i argumenteve para tyre”. GJDBE-ja vlerësoi më tej se pushteti i mbajtur nga ministri i Drejtësisë nuk arriti të përputhet me parimin e mosheqjes nga detyra, e cila ishte e natyrshme në pavarësinë e gjyqësorit.

224. Për aq sa aplikohet për qëllimet e çështjes në fjalë, GJDBE-ja iu referua në të dyja vendimet, ndër të tjera, parimeve të përgjithshme si më poshtë:

“Parimi i mosheqjes nga detyra kërkon, në veçanti, që gjyqtarët të mund të qëndrojnë në detyrë me kusht që ata të mos kenë arritur moshën e pensionit të detyrueshëm ose deri në përfundimin e mandatit të tyre, nëse ky mandat ka një afat të përcaktuar. Meqenëse kjo nuk është plotësisht absolute, nuk mund të ketë përjashtime nga ky parim vetëm nëse këto përjashtime bazohen në shkaqe të arsyeshme dhe imponuese, në varësi të parimit të proporcionalitetit. Kështu që është pranuar gjerësisht që gjyqtarët mund të shkarkohen nga detyra nëse ata vlerësohen të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të tyre për shkak të paaftësisë ose shkeljes serioze të detyrimeve të tyre, me kusht që të ndiqen procedurat e duhura (mungon referenca).

Bazuar në sa më sipër, është më e qartë, më së shumti nga praktika gjyqësore e [GJDBE-së] se me ‘pavarësi’ nënkuptohet rregullat që rregullojnë regjimin disiplinor dhe, sipas rastit, çdo shkarkim i atyre që kanë për detyrë të gjykojnë një mosmarrëveshje duhet të sigurojë garancitë e nevojshme në mënyrë që të parandalojnë çdo rrezik që ai regjim disiplinor të përdoret si një sistem i kontrollit politik të përmbajtjes së vendimeve gjyqësore. Kështu, rregullat që përcaktojnë, në veçanti, si sjelljen që përbën shkelje disiplinore ashtu edhe dënimet e zbatueshme, të cilat parashikojnë përfshirjen e një organi të pavarur në përputhje me një procedurë e cila mbron plotësisht të drejtat e parashikuara në ... Kartën [e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian], në veçanti të drejtat e mbrojtjes, dhe të cilat përcaktojnë mundësinë e inicimit të procedurave gjyqësore që kundërshtojnë vendimet e organeve disiplinore përbëjnë një sërë garancish që janë thelbësore për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit.

2. *Vendimi në çështjen e A.K. kundër të Tjerëve (Pavarësia e Kolegjit për çështjet Disiplinore të Gjykatës së Lartë, C-585/18 dhe C-625/18).*

225. Në përgjigje të tri kërkesave për një vendim paraprak në lidhje me pavarësinë e Kolegjit për çështjet Disiplinore të Gjykatës Lartë të Polonisë të sapo themeluar, të bëra nga Dhoma e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore të Gjykatës së Lartë të Polonisë (çështja *AK dhe të tjerët (Pavarësia e Kolegjit për çështjet Disiplinore të Gjykatës së Lartë)*, C 585/18, C-624/18 dhe C-625/18), më 19 nëntor 2019, Kolegji i Lartë i GJDBE-së u shpreh se gjykata referuese duhej të konstatonte nëse Kolegji i ri Disiplinor i Gjykatës së Lartë ishte i pavarur për të përcaktuar nëse ky kolegji kishte juridiksion për të vendosur mbi çështjet ku gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ishin në pension, ose për të përcaktuar nëse çështje të tilla duhej të shqyrtoheshin nga një gjykatë tjetër e cila do të plotësonte kushtin që gjykatat duhet të jenë të pavarura.

226. Duke vepruar kështu, gjykata referuese duhej të vlerësonte rrethanat në të cilat u emëruan gjyqtarët e rinj të Kolegjit për çështjet Disiplinore dhe rolin e Këshillit Kombëtar Polak të Gjyqësorit (“KKPGJ”) në bërjen e propozimeve për emërimin e Presidentit të Republikës të Polonisë. Në mënyrë specifike, gjykata referuese duhej të shqyronte faktorët specifik të mëposhtëm, të cilët GJDBE i kishte identifikuar, në mënyrë që të konstatonte nëse Kolegji për Çështjet Disiplinore të Gjykatës Lartë ofronte garanci të mjaftueshme pavarësie: rregullat që rregullojnë emërimin e gjyqtarëve të Kolegjit të ri për çështjet Disiplinore; ii. shkallën e pavarësisë që gëzon KKGJ-ja polak nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv në ushtrimin e përgjegjësisë që

gëzon sipas ligjit të brendshëm; iii. mënyra në të cilën KKGJ polak ushtroi përgjegjësitë e tij kushtetuese për të siguruar pavarësinë e gjykatave dhe gjyqësorit dhe kompetencat e tij të ndryshme, veçanërisht nëse e bëri atë në një mënyrë që arriti të vinte në dyshim pavarësinë e tij nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv; iv. efektiviteti i rishikimit gjyqësor të një rezolute të KKGJ polak, duke përfshirë vendimet e tij në lidhje me propozimet për emërim në postin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, i cili, së paku, do të ishte në gjendje të shqyrtonte nëse nuk kishte tejkalim kompetencash apo ushtrim gabuar i pushtetit, zbatim i gabuar i ligjit ose gabim i dukshëm në vlerësim.

227. Përveç kësaj, gjykata referuese duhej të shqyrtonte karakteristika të tjera që karakterizuan direkt Kolegjin e Ri Disiplinor, të tilla si: i. juridiksioni i tij ekskluziv për të vendosur mbi një numër specifik çështjesh që më parë binin në juridiksionin e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, përbërja e vetëm gjyqtarëve të emëruar rishtas, duke përjashtuar gjyqtarët që tashmë shërbenin në Gjykatën e Lartë; dhe iii. shkallën veçanërisht të lartë të autonomisë krahasuar me kolegjet e tjera të Gjykatës së Lartë.

228. Në mënyrë të përgjithshme, GJDBE theksoi disa herë se, edhe pse secili prej faktorëve të shqyrtuar, më vete, nuk arritën të vinin në dyshim pavarësinë e Kolegjit Disiplinor, kjo mund të ndodhte nëse ato do të ishin shqyrtuar së bashku.

229. Pas vendimit të GJDBE, Kolegji i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore të Gjykatës së Lartë të Polonisë shpalli tri vendime mbi çështjet që ishin referuar për një vendim paraprak në GJDBE (një më 5 dhjetor 2019 dhe dy më 15 janar 2020). Vendimi i datës 5 dhjetor 2019 përmbante shkaqe gjithëpërfshirëse dhe vuri në zbatim treguesit në lidhje me standardet e zbatueshme të dhëna nga GJDBE-ja. Kolegji i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore të Gjykatës së Lartë arriti në përfundimin se KKGJ-ja e Polonisë nuk ishte një organ i paanshëm dhe i pavarur nga pushtetit legjislativ dhe ai ekzekutiv. Për më tepër, ajo arriti në përfundimin se Kolegji Disiplinor i Gjykatës së Lartë i sapo krijuar, nuk ishte një gjykatë sipas kuptimit të ligjit të brendshëm dhe Konventës.

E DREJTA

1. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6/1 TË KONVENTËS

230. Kërkesja pretendon se organeve të rivlerësimit u mungonte pavarësia dhe paanësia, siç kërkohet nga neni 6/1 i Konventës, për shkaqet e mëposhtme: i. organet e rivlerësimit përbëhen nga anëtarë jogjyqtarë të cilët nuk kishin profesionalizmin dhe përvojën e duhur; ii. anëtarët e organeve të rivlerësimit u emëruan nga parlamenti pa përfshirë përfaqësues nga gjyqësori; iii. organet e rivlerësimit kryen hetimin paraprak administrativ, përgatitën “akuzën” dhe vendosën mbi themelin e “akuzës”.

231. Po ashtu, bazuar në nenin 6/1 të Konventës, ajo pretendoi se pati parregullsi në procesin gjyqësor në çështjen e saj, për arsye se: i. asaj i ishte refuzuar e drejta për të kundërshtuar arsyen kryesore të shkarkimit të saj dhe për të mbrojtur veten; ii. KPK-ja i kishte kaluar një barrë të paarsyeshme prove në lidhje me rrethanat që kishin lindur dekada më parë; iii. ligji nr. 84/2016 nuk kishte parashikuar ndonjë periudhë kufizimi; iv. vendimet në çështjen e saj nuk kishin arsyetim në lidhje me argumentet e saj; v. organet e rivlerësimit kishin zbatuar standarde të dyfishta krahasuar me çështjet e tjera; vi. Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk e kishte pranuar kërkesën e saj për të paraqitur prova të tjera shfajësuese; vii. ajo nuk kishte pasur kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e saj; viii. Kolegji nuk zhvilloi një seancë publike; dhe ix. organet e rivlerësimit kishin shkëlur parimin e sigurisë ligjore dhe pritshmërisë së ligjshme duke qenë se kishin shpërfillur vlerësimin e pasurive të saj të kryera nga ILDKPI që kishte rezultuar pozitiv.

232. Në lidhje me këtë, neni 6/1 i Konventës, parashtron si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile ... çdokush ka të drejtën për një seancë të drejtë dhe publike ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj”.

A. Pranueshmëria

233. Gjikata, duke pasur parasysh parashtrimet e palëve, do të përcaktojë çështjet për sa i përket zbatimit të nenit 6/1, shterimin e mjeteve juridike të brendshme dhe respektimin e afatit gjashtëmujor.

1. Zbatimi i nenit 6§1

a) Parashtrimet e palëve

234. Qeveria pranoi që neni 6/1 i Konventës aplikohet në aspektin e tij civil. Për shkak të natyrës administrative të procedurave të rivlerësimit, qeveria nuk pranoi aplikimin e nenit 6/1 të Konventës në aspektin e tij penal.

235. Edhe kërkuesja u shpreh, gjithashtu, që neni 6 aplikohet në aspektin civil të tijin. Ajo më tej argumentoi, duke iu referuar çështjes *Matyjek kundër Polonisë* (dec.), nr. 38184/03, GJEDNJ 2006 VII, se neni 6 aplikohet në aspektin penal për arsyt e mëposhtme: i. KPK-ja, i cili kishte kryer hetimin paraprak dhe kishte dhënë një vendim në shkallë të parë, i ishin dhënë kompetenca të ngjashme me ato të një prokurori publik; ii. pozicioni i tij në procesin e rivlerësimit kishte qenë i njëjtë me atë të një të akuzuari në një proces penal; iii. natyra e shkeljes, përkatësisht dhënia e deklaratave të pavërteta në deklarimin e pasurisë, ishte e njëjtë me atë të dëshmisë së rreme, me pasojë ndjekjen penale; dhe iv. natyra dhe shkalla e së dënimit në fjalë, përkatësisht shkarkimi nga detyra, pretendohet se ka sjellë një ndalim të pacaktuar për të aplikuar për një numër të madh postesh publike.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Aplikimi i nenit 6/1 nën aspektin civil të tij

236. Gjykata vëren se palët nuk kundërshtuan aplikimin e nenit 6/1 të Konventës nën aspektin civil. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se mosmarrëveshjet në lidhje me punësimin midis nëpunësve civilë dhe Shtetit nuk bien nën aspektin civil të nenit 6, nëse plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative. Në radhë të parë, shteti në legjislacionin e tij të brendshëm duhet të ndalojë shprehimisht aksesin në gjykatë për pozicionet ose kategorinë e personelit në fjalë. Së dyti, ky ndalim duhet të justifikohet për arsye objektive në interes të Shtetit (shih, për shembull, çështjen *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* [GC], nr. 63235/00, paragrafi 62, GJEDNJ 2007 II, në vijim “*testi Vilho Eskelinen*”).

237. Edhe pse sistemi gjyqësor nuk është pjesë e shërbimit të përgjithshëm civil, ai konsiderohet pjesë e shërbimit të zakonshëm publik. Prandaj, neni 6/1 ka gjetur zbatim në proceset për shkarkimin e gjyqtarëve, kryesisht për faktin se gjyqtarët kishin të drejtë aksesin në gjykatat kombëtare për të kundërshtuar shkarkimin e tyre (shih, për shembull, *Olujić kundër Kroacisë*, nr. 22330/05, paragrafët 42–43, 5 shkurt 2009; *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, nr. 21722/11, paragrafët 90–91, GJEDNJ 2013; *Poposki dhe Duma kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 69916/10 dhe 36531/11, paragrafi 37, 7 janar 2016; dhe *Sturua k. Gjeorgjisë*, nr. 45729/05, paragrafi 27, 28 mars 2017).

238. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, dhe për sa i përket kushtit të parë të përcaktuar në testin *Vilho Eskelinen*, Gjykata vëren se, institucionet e procesit të rivlerësimit, KPK-ja në shkallën e parë dhe KPA-ja në shkallën e apelit, e shkarkuan kërkuesen nga pozicioni i saj si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese. Dhe në fakt, ligji i brendshëm nuk ia mohoi të drejtën kërkueses për të kundërshtuar shkarkimin e saj.

239. Megjithatë, duke qenë se Gjykata si fillim duhet të përcaktojë nëse KPK-ja dhe KPA-ja konsiderohen si “gjykatë e themeluar me ligj”, ajo çmon se aplikimi i nenit 6/1 të Konventës nën aspektin civil të tij, duhet t’i bashkëngjitet themelit të këtij ankimi.

ii. Aplikimi i nenit 6/1 nën aspektin e tij penal

240. Gjykata vëren se palët nuk ishin dakord nëse aspekti penal i nenit 6/1 mund të gjente zbatim në këtë rast.

241. Gjykata thekson se të dyja aspektet, civile dhe penale, të nenit 6/1 nuk janë domosdoshmërisht përjashtuese në mënyrë reciprokë (shih *Albert and Le Compte k. Belgjikës*, 10 shkurt 1983, paragrafi 30, seria A nr. 58). Koncepti i një “kallëzimi penal” sipas nenit 6/1 është një koncept autonom. Praktika gjyqësore e vendosur e Gjykatës përcakton tri kritere, të njohura në përgjithësi si “kriteret e Engel-it”, për t’u marrë në konsideratë e për të përcaktuar nëse pati apo jo një “akuzë penale” (shih *Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, 8 qershor 1976, paragrafi 82, seria A nr. 22). Kriteri i parë është klasifikimi ligjor i veprës penale sipas ligjit të brendshëm, i dyti është vetë natyra e veprës penale, dhe i treti është shkalla e ashpërsisë së dënimit që personi në fjalë rrezikon të marrë. Kriteri i dytë dhe i tretë janë alternative, dhe jo domosdoshmërisht kumulative. Megjithatë, kjo nuk përjashton një qasje kumulative kur analiza e veçantë e secilit kriter nuk bën të

mundur arrijten e një konkluzioni të qartë për ekzistencën e një akuze penale (shih, ndër autoritetet e tjera, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë* [GC], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, paragrafi 122, 6 nëntor 2018, dhe referencat e cituara në të).

242. Në çështjen *Matyjek* (cituat më lart, paragrafët 49-58), duke vlerësuar që neni 6 aplikohet nën aspektin penal të tij për proceset gjyqësore të lustracionit sipas ligjit polak, Gjykata kishte parasysh faktin që Kodi Polak i Procedurës Penale ishte i zbatueshëm për proceset gjyqësore, se natyra e veprës për të cilën kërkuesi kishte qenë subjekt i lustracionit, përkatësisht dhënia e një deklarate të rremë, ishte e ngjashme me veprën penale të dëshmisë së rreme dhe se sanksioni i vendosur ndaj tij, ndalimi i emërimit në një sërë pozicionesh publike për dhjetë vjet, ishte i rëndë.

243. Duke iu kthyer çështjes fjalë, në lidhje me kriteret e para të Engel, përkatësisht klasifikimin e brendshëm të veprës, Gjykata vëren se procesi i rivlerësimit ndaj kërkueses, që ishte i një natyre disiplinore, drejtohej nga ligji nr. 84/2016 bashkë me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, ligjin për gjykatat administrative ose Kodin e Procedurës Civile, sipas rastit. Asnjëherë nuk u referua apo u përmend zbatimi apo interpretimi i Kodit Penal ose Kodit të Procedurës Penale. Procedurat e rivlerësimit u zhvilluan nga një organ i krijuar posaçërisht për këtë qëllim, KPK-ja, që i nënshtrohehin më vonë ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe në përcaktimin e rezultatit të tyre nuk ishin të përfshirë as autoritetet e ndjekjes penale dhe as gjykatat penale. Për më tepër, neni Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës parashikon vetëm kalimin e barrës së provës në procesin e rivlerësimit, duke u përjashtuar shprehimisht gjatë çdo procesi penal më vete, dhe neni DH, pika 2 e aneksit të Kushtetutës ndalon në mënyrë të qartë përdorimin e deklaratave të pastërtisë së figurës në çdo proces penal (shih paragrafët 107 dhe 109 më lart). Për këto arsye, Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e kërkueses se pozicioni i saj kishte qenë si ai i një të akuzuari në një proces penal ose se kompetencat e KPK-së ishin të ngjashme me ato të një prokurori publik.

244. Sa i përket kriterit të dytë – natyra e veprës – Gjykata vëren se dispozitat ligjore në fuqi u hartuan vetëm për një kategori të veçantë zyrtarësh, veçanërisht, gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë, dhe jo për publikun e gjerë. Dispozitat u krijuan për të mbrojtur sjelljen, nderin dhe reputacionin e profesioneve dhe për të ruajtur besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Ato ishin thjesht të një natyre disiplinore dhe nuk ishin të veshura me elemente të natyrës kriminale. Që kërkuesja t'i nënshtrohet procedimit penal në të ardhmen për shkak të deklaramit të rremë të pasurive, nuk mjafton për ta shtrirë procesin e rivlerësimit edhe në aspektin penal. Në lidhje me këtë, fakti që një veprim i cili mund të çojë në një sanksion disiplinor, gjithashtu, përbën një veprë penale nuk është i mjaftueshëm për ta bërë një person përgjegjës sipas ligjit disiplinor si “të akuzuar” për një krim (shih *Müller-Hartburg kundër Austrisë*, nr. 47195/06, paragrafi 44, 19 shkurt 2013, dhe *Biagoli k. San Marino* (dek.), nr. 64735/14, paragrafi 56, 13 shtator 2016). Që neni 6/1 të mund të gjente aplikim nën aspektin penal të tij do të ishte vetëm në kontekstin e ndonjë procedimi penal më vete në të ardhmen, i cili mund të ngrihet kundër kërkueses.

245. Në lidhje me kriterin e tretë, që është, shkalla e ashpërsisë së dënimit, Gjykata vëren se shkarkimi i kërkueses është një sanksion karakteristik i një veprë disiplinore dhe nuk mund të ngatërrohet me një dënim penal. Ndaj saj nuk u vendos asnjë gjobë pas shkarkimit të saj. Gjykata më tej vëren se ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar ndalim të përhershëm të aplikimit për pozicionet në sistemin e drejtësisë. Sidoqoftë, ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka ndaluar që gjyqtarët dhe prokurorët të cilët janë shkarkuar nga detyra të bëhen sërish pjesë e sistemit të drejtësisë (shih paragrafin 206 më lart). Sido që të jetë, ky ndalim, në çdo rast, nuk do të ishte në vetvete vendimtar për ta konsideruar procesin e rivlerësimit si penal për arsyet e mëposhtme. Ky ndalim nuk është parashikuar në Kodin penal dhe nuk mund të konsiderohet si një sanksion me natyrë kriminale. Qëllimi i ndalimit për t'u ribërë pjesë e sistemit të drejtësisë nuk duket të jetë vendosja e një ndëshkimi për shkarkimin nga detyra, por më tepër ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Edhe pse, në vetvete, ky ndalim duket sikur është një pasojë mjaft e rëndë, shumë masa jopenale të një natyre parandaluese mund të kenë një ndikim thelbësor mbi personin në fjalë. Fakti i thjeshtë që ndalimi është i një natyre të përhershme nuk mjafton ta konsiderojmë atë si një ndëshkim (shih, *mutatis mutandis*, *Rola kundër*

Slovenisë, nr. 12096/14 dhe 39335/16, paragrafi 66, 4 qershor 2019). I njëjti konstatim do të zbatohet edhe për pretendimin që kërkuesja nuk ka të drejtë të jetë pjesë e shërbimit civil, një pretendim spekulativ të cilin ajo nuk e ka kundërshtuar përpara gjykatave vendëse.

246. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se elementet e mësipërme, të marra në mënyrë alternative ose kumulative, janë të pamjaftueshme për të arritur në një përfundim se neni 6 është i zbatueshëm nën aspektin e tij penal (shih, ndër autoritetet e tjera, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, cituar më lart, paragrafët 124-27; *Kamenos k. Qipros*, nr. 147/07, paragrafi 51, 31 tetor 2017; *Ivanovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 29908/11, paragrafi 121, 21 janar 2016; dhe *Oleksandr Volkov*, cituar më lart, paragrafët 93–95).

2. Shterimi i mjeteve juridike

247. Qeveria parashtroi që kërkuesja nuk kishte paraqitur ankim përpara KPK-së apo ankim përpara KPA-së që KPK-ja kishte hartuar “akuzën” dhe kishte vendosur mbi themelin e “akuzës”.

248. Kërkuesja pohoi se ajo i kishte përdorur të gjitha mjetet juridike të brendshme dhe kishte paraqitur ankimin e saj pranë Kolegjit të Apelimit.

249. Gjykata vë në dukje se qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është t’i japë një Shteti kontraktues mundësinë e adresimit, dhe në këtë mënyrë, të parandalimit ose rregullimit të shkeljes në fjalë të Konventës që pretendohet kundër tij. Është e vërtetë që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës nuk është gjithmonë e nevojshme që Konventa të përmendë qartazi në proceset e brendshme me kusht që pretendimi të shqyrtohet “të paktën në përmbajtje”. Kjo do të thotë që kërkuesi duhet të ngrejë argumente ligjore me të njëjtin efekt ose të ngjashëm në bazë të ligjit të brendshëm, në mënyrë që t’u japë gjykatave vendëse mundësinë për të ndrequr shkeljen e pretenduar. Sidoqoftë, siç shpjegohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës, për t’i dhënë vërtet një Shteti nënshkrues të Konventës mundësinë e parandalimit ose korrigjimit të shkeljes së pretenduar, kërkohet që të merren parasysh jo vetëm faktet, por edhe argumentet ligjore të kërkuesit për të përcaktuar nëse ankimi i paraqitur në Gjykatë me të vërtetë ishte ngritur paraprakisht, në thelb, përpara organeve vendëse (shih *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [GC], nr. 37685/10 dhe 22768/12, paragrafi 117, 20 mars 2018 dhe referencat e cituara në të).

250. Duke iu kthyer rrethanave të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se më datë 9 qershor 2018, kërkuesja paraqiti një ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit kundër vendimit të KPK-së, duke paraqitur pretendime të shumta me natyrë procedurale dhe materiale. Në të vërtetë, ankimi vuri në dukje dështimin e pretenduar nga ana e KPK-së për të ofruar garancitë procedurale dhe problematikat me rolet e tij paralele, atë të mbledhjes së provave dhe informacionit dhe vendimmarjes mbi themelin e çështjes. Gjykata vlerëson se pretendimet e paraqitura në ankimin e kërkueses janë të ngjashme me argumentet me të njëjtin efekt ose të ngjashëm me ato që ajo ka ngritur para kësaj Gjykate për mungesë paanshmërisë nga ana e KPK-së me arsyetimin se Komisioni edhe kishte ngritur “akuzën” edhe kishte vendosur mbi themelin e çështjes së saj. Sipas mendimit të Gjykatës, ajo ngriti këtë shkak ankimi “të paktën në thelb” përpara Kolegjit të Apelimit, i cili, duke iu referuar nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63 të ligjit nr. 84/2016 (shih paragrafët 112 dhe 152 më lart), është një mjet/zgjidhje për t’u shtuar për qëllimet e nenit 35/1 të Konventës.

251. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se kundërshtimi i qeverisë në këtë drejtim nuk duhet të pranohet.

3. Pajtueshmëria me afatin gjashtëmujor

252. Nga shqyrtimi i saj mbi pranueshmërinë dhe themelin e çështjes, të paraqitura më datë 10 janar 2020, kërkuesja u shpreh se: i. tre anëtarë të trupit gjykues të KPA-së nuk përmbushnin kriteret ligjore të pranueshmërisë për t’u përzgjedhur dhe, më pas, për t’u emëruar si anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; dhe ii. njëri prej anëtarëve të KPA-së nuk kishte deklaruar konfliktin e interesit në lidhje me dënimin e vëllait të atij anëtari në vitin 1997 nga një gjykatë apeli, në të cilën babai i kërkueses kishte qenë pjesë e trupit gjykues. Kërkuesja pretendoi se ajo kishte mësuar për konfliktin e interesit më datë 25 nëntor 2019, pasi i ishte sjellë në mendje nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës Kushtetuese i cili ishte shkarkuar nga detyra si rezultat i procesit të rivlerësimit.

253. Gjykata vëren se edhe pse nga ana e qeverisë nuk pati ndonjë kundërshtim në lidhje me mosrespektimin e afatit gjashtëmuor nga ana e kërkuesses, nuk është në dorën e Gjykatës të shpërfillë zbatimin e rregullit gjashtëmuor mbi këtë bazë (shih *Blečić kundër Kroacisë* [GC], nr. 59532/00, paragrafi 68, GJEDNJ 2006 III, dhe, më pas, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, cituar më lart, paragrafi 98). Prandaj, Gjykata duhet të konstatojë nëse ato pretendime ishin pjesë e ankimit fillestar, parashtrimi i të cilave ndërpreu afatin e periudhës gjashtëmuore.

254. Në ankimin fillestar, kërkuësja pretendonte se organet e vetingut nuk kishin qenë të pavarura dhe të paanshme, për arsytet e paraqitura në paragrafin 230 më lart. Ajo nuk e ngriti në thelb apo edhe në mënyrë të nënkuptuar pretendimin se tre anëtarë të Kolegjit të Apelimit nuk përmbushnin kriteret ligjore të pranueshmërisë. Ajo nuk pretendoi se kishte hasur ndonjë vështirësi në marrjen e informacionit të besueshëm – dhe zyrtar – mbi përzgjedhjen e këtyre anëtarëve sipas kriterëve ligjore, përpara se akuza të tilla të dilnin në dritë, dhe në çdo rast, pas publikimit të çështjes *Sevdari kundër Shqipërisë* (nr. 40662/19) më datë 22 nëntor 2019, në të cilën palët u pyetën në mënyrë specifike në lidhje me rezultatit e proceseve të brendshme kundër anëtarëve të caktuar të Kolegjit mbi pretendimin për mospërmbushje të kriterëve ligjore të pranueshmërisë. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk është e bindur që kërkuësja kish pasur pengesa për të gjetur një material të tillë gjatë proceseve të brendshme dhe të shprehte ndonjë dyshim ndaj KPA-së në lidhje me përputhshmërinë e anëtarëve të tij me kriteret ligjore të pranueshmërisë. Për më tepër, ajo nuk ndërmoi asnjë hap për të kundërshtuar mospërputhjen e pretenduar të anëtarëve të caktuar të KPA-së me kriteret ligjore për pranueshmërinë para autoriteteve përkatëse kombëtare pas paraqitjes së kërkesës së saj në Gjykatë dhe përpara se Gjykata të merrte një vendim mbi pranueshmërinë. Për më tepër, procedurat e brendshme të verifikimit për sa i përket përmbushjes së kriterëve ligjore të përzgjedhjes për këta anëtarë, janë aktualisht në proces e sipër nga organet vendëse.

255. Kërkuësja, gjithashtu, në kërkesën fillestare nuk pretendoi se anëtari i katërt i trupës gjyquese të Kolegjit nuk kishte deklaruar konfliktin e interesit dhe të hiqte dorë nga procesi. Pretendimi se ajo u vu në dijeni të këtij fakti më datë 25 nëntor 2019, pa vërtetuar faktin se ajo nuk mund të kishte dijeni për vendimin e gjykatës së apelit të vitit 1997 para asaj date, nuk mund të justifikojë shmangien e saj nga detyrimi për të vepruar me kujdesin e duhur gjatë procedurave të brendshme, të merrte informacion zyrtar dhe të kundërshtonte pjesëmarrjen e këtij anëtari në trupën gjyquese të KPA-së. Bazuar në këtë situatë, Gjykata nuk është e bindur se ishte e pamundur që kërkuësja të mësonte për këtë gjë gjatë mbajtjes së proceseve të brendshme.

256. Fakti që kërkuësja i është referuar nenit 6 të Konventës në kërkesën e saj dhe se Qeveria e paditur u njoftua për këtë kërkesë po sipas këtij neni, nuk mjafton për të justifikuar paraqitjen e pretendimeve që pasuan bazuar në këtë dispozitë, kur nuk kishte asnjë tregues faktik në shkaqet e ankimit të paraqitura fillimisht në formularin e aplikimit. Duke qenë se fushëveprimi i nenit 6 të Konventës është shumë i gjerë, shqyrtimi i Gjykatës do të kufizohet detyrimisht në shkaqet specifike të ankimit që kërkuësi ka paraqitur fillimisht (shih *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, cituar më lart, paragrafët 103–04).

257. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuësja i ka ngritur për herë të parë këto shkaqe më 10 janar 2020, më shumë se gjashtë muaj pas shpalljes së vendimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit më datë 23 nëntor 2018 (shih paragrafin 59 më lart). Gjykata ka konstatuar edhe më parë një pretendim të ri në parashtrimet e kërkuesses mbi pranueshmërinë dhe themelin e çështjes që ishte paraqitur jashtë afatit gjashtëmuor, në kundërshtim me nenin 35/1 të Konventës (shih, ndër autoritetet e tjera, *Fábián k. Hungarisë* [GC], nr. 78117/13, paragrafi 98, 5 shtator 2017 dhe *Majski k. Kroacisë*, nr. 33593/03, paragrafi 34, 1 qershor 2006). Si pasojë, ky pretendim është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe nuk duhet të pranohet në përputhje me nenin 35/1 dhe 4 të Konventës

4. Përfundime në lidhje me pranueshmërinë

258. Gjykata vëren se, me përjashtim të shkakut të ankimit të kërkuesses sipas nenit 6/1 të deklaruar i papranueshëm në paragrafin 257 më lart, shkaqet e tjera në ankim nuk janë qartësisht të pabazuara apo të papranueshme për ndonjë arsye tjetër të renditur në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Themeli i çështjes

259. Në funksion të pretendimeve të shumta të kërkuases, Gjykata së pari do të shqyrtojë shkakun e ankimit sipas të cilit ajo pretendon se organeve të rivlerësimit u mungonte pavarësia dhe paanësia. Më pas, gjykata do të shqyrtojë ankimin që lidhet me parregullsitë gjatë procesit dhe ankimin në lidhje me mosmbajtjen e seancës publike nga Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe do të përfundojë duke shqyrtuar shkakun e ankimit me anë të cilit ajo pretendon se ka pasur shkelje të parimit të sigurisë ligjore.

1. *Pajtueshmëria me parimin e “një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj”.*

a) Parashtrimet e palëve

i. Sipas kërkuases

260. Kërkuësja parashtroi që, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në një sërë dokumentesh ndërkombëtare, të tilla si Karta Evropiane për Statutet e Gjyqtarëve dhe Magna Carta e Gjyqtarëve, organet e rivlerësimit përbëheshin nga (pothuajse tërësisht) anëtarë jogjyqtarë. Askush nga anëtarët nuk ka përvetësuar përvojën dhe aftësitë e nevojshme ligjore dhe/ose gjyqësore për shqyrtimin e çështjeve komplekse të fakteve dhe të ligjit.

261. Anëtarët e organeve të rivlerësimit u zgjodhën tërësisht nga Parlamenti, pas një procesi parazgjedhor të kryer nga një komision parlamentar *ad hoc*, pa përfshirje të sistemit gjyqësor. Sipas këndvështrimit të kërkuases, roli i ONM-së në mbikëqyrjen e procesit të aplikimit, në dhënien e rekomandimeve për kandidatët dhe duke paraqitur listën e kandidatëve për miratim nga Parlamenti, ishte i kufizuar. Kishte mungesë transparence në procesin e përzgjedhjes pasi kandidatët nuk kishin bërë publike kualifikimet dhe kompetencat e tyre profesionale. Për më tepër, disa kandidatë ishin punësuar në institucionet shtetërore ose të përfshirë në politikë.

262. Për më tepër, mandati i anëtarëve të organeve të rivlerësimit ishte i kufizuar në pesë vjet për anëtarët e KPK-së dhe nëntë vjet për anëtarët e KPA-së. Sipas kërkuases, ky mandat i kufizuar i bëri ata të cenueshëm nga ndikimet e jashtme, gjë që vë në dyshim pavarësinë e tyre. Ajo deklaroi më tej se puna e organeve të rivlerësimit ishte nën vëzhgimin e vazhdueshëm të Qeverisë, e cila, në vitin 2018, u kishte dhënë atyre një “shpërblim për performancën”. Ligji nuk parashikon formalisht mosheqjen e tyre nga detyra.

263. Kërkuësja argumentoi se rezultati përfundimtar i hetimit paraprak që KPK-ja kishte kryer, kishte qenë paragjykes për çështjen e saj. Kjo u theksua edhe nga fakti se barra e provës i kishte kaluar automatikisht dhe ekskluzivisht asaj.

264. Më tej, ajo pretendoi se, që nga marrja e detyrës në vitin 2013, Qeveria nisi të sulmonte drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të ashpër sistemin gjyqësor, duke akuzuar shpesh dhe publikisht gjyqtarët për korrupsion dhe paaftësi profesionale, si dhe duke i quajtur ata “kriminelë”. Madje Kryeministri ishte përfshirë edhe në çështjen e përbërjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ajo paraqiti një lajm nga një faqe interneti e një televizioni të datës 2 maj 2018 duke cituar Kryeministrin duke thënë si më poshtë:

“Procesi i rivlerësimit ka filluar tashmë. Çdo ditë [...] ju keni qenë dëshmitarë të rezultateve të cilat do të vazhdojnë të intensifikohen. Gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar do të hiqen nga sistemi. Kushdo që nuk është në gjendje të justifikojë ligjshmërinë e pasurisë së tij ose të saj, që nuk është në gjendje të demonstrojë integritetin e vendimmarrjes së mëparshme, që nuk është në gjendje të provojë aftësinë për të qëndruar në sistemin e ri të drejtësisë, nuk do të jetë më pjesë e tij. Kjo është një arsye e mirë për të qenë optimist për të ardhmen.”

265. Kërkuësja pretendoi se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk kishte ndonjë kompetencë shqyrtimi kushtetues, këto kompetenca i përkisnin ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese.

ii. Sipas qeverisë

266. Qeveria u shpreh se procesi i rivlerësimit bazohej në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016. Fakti që krijimi i organeve të rivlerësimit parashikohej në Kushtetutë ishte një garanci e pavarësisë së tyre nga ndërhyrjet e padrejta të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ.

267. Anëtarët e organeve të rivlerësimit u zgjodhën me konkurs sipas një procedure transparente, në përputhje me kriteret e parashikuara nga ligji. Kufizimet e vendosura nga kriteret e përzgjedhjes ishin një garanci tjetër për të përjashtuar gjyqtarët aktualë, prokurorët dhe këshilltarët

ligjorë të cilët kishin një konflikt të qartë interesi, ose individë të tjerë që kishin mbajtur funksione publike në administratë ose kishin qenë në poste drejtuese në parti politike në dhjetë vitet e fundit, për t'u bërë pjesë e organeve të rivlerësimit.

268. Anëtarët e këtyre organeve u zgjedhën sipas procedurës së përcaktuar me ligj duke garantuar një proces emërimi të paanshëm dhe konsensual. Procesi u monitorua nga Avokati i Popullit dhe ONM-ja, ndërsa komisioni *ad hoc* parlamentar ishte i përbërë nga deputetë si nga partia në pushtet ashtu edhe nga opozita. Përfshirja e organeve kushtetuese në përzgjedhjen e kandidatëve kishte për qëllim shmangien e politizimit të procesit dhe sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë së tyre. Përfshirja e Parlamentit në përzgjedhjen e tyre ishte në përputhje me rolin e tij sipas Kushtetutës në zgjedhjen e anëtarëve të organeve kushtetuese, siç kishte qenë rasti edhe më parë. Kryerja e detyrave nga ana e tyre nuk përputhej me asnjë funksion tjetër. Ligji nr. 84/2016 kishte futur detyrimin që anëtarët e organeve të vetingut duhet të deklaronin dhe shmangin çdo konflikt interesi gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar. Kërkuesja nuk kish parashtruar apo përmendur ndonjë konflikt të tillë interesi dhe ajo nuk kishte paraqitur asnjë ankim apo të kish bërë kërkesë për përjashtimin e ndonjë anëtari të trupit gjykues. Përbërja e trupave gjyquese në të dy instancat caktohej me short, po ashtu edhe kryesuesit dhe relatorët e çështjeve.

269. Qeveria argumentoi se KPK-ja nuk kishte paragjykuar rezultatin e çështjes së kërkueses. Komisioni nuk e kishte informuar kërkuesen për caktimin paraprak ose të parakohshëm të sanksionit disiplinor. Gjetjet paraprake të Komisionit ishin shqyrtuar së bashku me provat që kërkuesja kishte paraqitur, duke siguruar kështu kontradiktorialitetin. Anëtarët e tij nuk kishin ndërmarrë ndonjë veprim që do të ngrinte dyshime për paanësinë e tyre. Për më tepër, KPK-ja, në funksion të natyrës specifike të procesit të rivlerësimit, nuk ishte një organ i zakonshëm disiplinor që heton shkeljet e pretenduara disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët. Në vend të kësaj, ai kreu një vlerësim të pavarur të tri kriterëve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligjin nr. 84/2016. Komisioni nuk ndërmori hapa për të ngritur ndonjë akuzë. Përfshirja e KPK-së dhe fusha e tij e hetimit është e përcaktuar me ligj, duke përfshirë mënyrën e marrjes së informacionit. Aktiviteti i tij është i njëjtë me atë të një organi pothuajse gjyqësor. Fakti që KPK-ja kishte kompetenca vendimmarrëse, pasi shqyrtoi të gjitha provat në dosjen e çështjes, ishte një tipar i qenësishëm i këtij lloji të procedurës së veçantë disiplinore administrative. Në asnjë rrethanë, KPK-ja nuk kishte paracaktuar rezultatin e çështjes së kërkueses. Kërkuesja paraqiti një ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, i cili nga ana tjetër, kishte juridiksion të plotë mbi çështjet e faktit dhe ligjit.

b) Palë të treta

270. Më poshtë do të gjeni parashtrimet e marra nga palët e treta të cilat u lejuan të ndërhyjnë në çështje, pa qenë nevoja për t'i ndarë ato sipas shkaqeve të ankimit të kërkueses.

i. Komisioni Evropian

271. Komisioni Evropian, që përfaqëson Bashkimin Evropian, u shpreh se reforma gjithëpërfshirëse e drejtësisë e miratuar nga Shqipëria në vitin 2016, e cila synonte rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, përbëhej nga dy shtylla: së pari, ristrukturimi institucional i të gjithë shërbimeve të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë dhe, së dyti, nisjen e procesit të rivlerësimit me anë të ndryshimeve në Kushtetutë dhe duke miratuar ligjin nr. 84/2016.

272. Qëllimi i procesit të rivlerësimit ishte lufta kundër korrupsionit të përhapur, mungesa e profesionalizmit dhe lidhjet me krimin e organizuar në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, rivendosjen e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm dhe rikthimin e besimit të publikut në të. Përfshirja e komunitetit ndërkombëtar u konsiderua thelbësore për besueshmërinë e procesit, i cili ishte përcaktuar në Kushtetutë. Ndërsa vuri në dukje se procesi i rivlerësimit mund të krijonte një tension të konsiderueshëm brenda sistemit gjyqësor të një vendi, Komisioni Evropian konsideroi se natyra e tij e përkohshme ishte e justifikuar duke pasur parasysh përmbushjen kumulative të rrethanave të mëposhtme: niveli i korrupsionit dhe ndikimi politik në gjyqësor ishte jashtëzakonisht i lartë, masa e propozuar gëzonte mbështetje të gjerë politike dhe publike dhe mjetet dhe mekanizmat ekzistues për të siguruar integritetin dhe luftën ndaj korrupsionit të mbartësit e funksioneve gjyqësore ishin shteruar. Për ato arsye, Komisioni Evropian u shpreh se

procesi i rivlerësimit ishte i domosdoshëm për procesin e reformës dhe duhej të ndiqej plotësisht deri në përfundimin e tij, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme, të ngushtë dhe të pavarur të ONM-së.

273. Sipas Komisionit Evropian, procesi i rivlerësimit ishte i ndërtuar nga tri elemente bazë: i. KPK-ja përbëhej nga një personel i pavarur dhe i kualifikuar dhe kishte kompetencat e nevojshme hetimore dhe vendimmarrëse për të kryer funksionet e tij; ii. Kolegji i Posaçëm i Apelimit u krijua si një gjykatë e ligjit dhe veprroi si një gjykatë e pavarur, përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të KPK-së për çështje faktesh dhe ligji; dhe iii. ONM-ja dhe vëzhguesit ndërkombëtarë ishin në gjendje në pavarësi të plotë të vëzhgonin dhe raportonin mbi procesin e rivlerësimit.

274. Komisioni Evropian u shpreh se procesi i rivlerësimit ofronte garanci të mjaftueshme për kryerjen e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave themelore për katër arsytet e mëposhtme. Së pari, kuadri ligjor, përkatësisht neni 179/b i Kushtetutës dhe nenet 4, pika 5, 47 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016, përcaktonin parimet për të siguruar respektimin e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe për të drejtat themelore të personave që do të rivlerësohen. Së dyti, si Kushtetuta ashtu edhe ligji nr. 84/2016 u dhanë pavarësi të gjerë organeve të rivlerësimit. Kolegji i Posaçëm i Apelimit iu bashkëngjiti Gjykatës Kushtetuese dhe anëtarët e KPK-së gëzonin statusin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 u dha atyre një nivel të lartë mbrojtjeje personale ndaj kërcënimeve për jetën, shëndetin dhe pronën. Anëtarët e organeve të rivlerësimit ishin subjekt i procedimeve disiplinore, të cilat, për hir të shmangies së presionit të jashtëm të padrejtë, do të kryheshin nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Së treti, kuadri ligjor parashikonte të drejtën e ankimit në KPA kundër gjetjeve të KPK-së, i cili ishte i vetmi organ gjyqësor përgjegjës për shqyrtimin e ankimeve për çështje fakti dhe ligji. Proceset gjyqësore nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit mbahen sipas dispozitave të ligjit për gjykatat administrative. Së katërti, krijimi dhe roli i ONM-së, sekretariati i të cilit u financua nga Komisioni Evropian, siguroi masa mbrojtëse shtesë të rëndësishme për sigurimin e respektimit të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të të drejtave themelore.

275. Së fundmi, Komisioni Evropian u shpreh se, pavarësisht nga konformiteti i përgjithshëm me garancitë e një gjykimi të drejtë dhe respektimit të të drejtave themelore, çdo mangësi që mund të identifikohet gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore në çështje individuale nuk do të vinte në pikëpyetje elementet thelbësore të procesit të rivlerësimit.

ii. Respublica

276. Respublicas, një organizate joqeveritare që promovon mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, i është dhënë leja për të ndërhyrë në të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit, për të cilën Qeveria është vënë në dijeni. Vëzhgimet e paraqitura për kërkesën në fjalë, ishin një vazhdim i komenteve me shkrim që ata kishin dorëzuar edhe për dy çështje të tjera të ngjashme, të pashqyrtuara ende: *Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë* (nr. 29943/18, bërë njoftimi më 7 shtator 2018) dhe *Nikebasani kundër Shqipërisë* (nr. 58997/18, bërë njoftimi më 25 janar 2019). Për këtë arsye, të gjitha komentet me shkrim që ata paraqitën në lidhje me këto kërkesa janë përmbledhur më poshtë.

277. Respublica pretendoi se Qeveria, përveç mbështetjes në një sërë sondazhesh nga perceptimi publik, ku shumica e të anketuarve ishin përgjigjur se ata e konsideronin korrupsionin në radhët e sistemit gjyqësor si endemik, si dhe gjetjet e konstatimet nga institucionet ndërkombëtare, nuk kishte paraqitur argumente të qarta dhe bindëse duke dëshmuar nevojën për një rregullim kaq drastik të sistemit të drejtësisë. Modeli i rivlerësimit duket se ishte parashikuar në premisën e gabuar se një numër i madh zyrtarësh të sistemit të drejtësisë ishin të korruptuar, pa marrë parasysh nivelin e lartë të politizimit të gjyqësorit, i cili ishte shumë problematik dhe ishte bërë kërcënim i tij kryesor.

278. Respublica parashittoi se vetëm tre anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit kishin punuar si gjyqtarë në të kaluarën (e largët), anëtarët e tjerë kishin qenë ose avokatë, ose ndihmës ligjorë apo këshilltarë ligjorë. Do të kishte qenë e preferueshme që të paktën gjysma e anëtarëve të saj të kishin pasur një formim të fortë dhe të qëndrueshëm gjyqësor. Dukej se asnjëri prej anëtarëve të Kolegjit nuk kishte ekspertizë në fushën e ndërlëkuar dhe tejet teknike të proceseve disiplinore kundër gjyqtarëve. Sipas këndvështrimit të Respublicas, proceset disiplinore ndaj gjyqtarëve duhet të kryhen

nga organe gjyqësore, pasi kjo do të garantonte që anëtarët e organeve të vetingut të kishin përvojën e duhur profesionale. Për më tepër, Respublica shprehu shqetësime nëse mandati i kufizuar i anëtarëve do të ngrinte dyshime për cenueshmërinë e tyre nga ndikime të jashtme politike, veçanërisht nën dritën e natyrës shumë të politizuar të të gjithë procesit të rivlerësimit. Një vendim i qeverisë në vitin 2018 për dhënien e një shpërblimi në fund të vitit për anëtarët e organeve të vetingut ngriti dyshime të mëtejshme për paanshmërinë e tyre objektive.

279. Sipas këndvështrimit të Respublica, kishte një mungesë udhëzimesh të qarta nga organet e rivlerësimit se si të zbatohet koncepti i të ardhurave dhe pasurive të ligjshme. Ligji nr. 84/2016 nuk arrin të përcaktojë një standard kuptimplotë që do t'u mundësonte subjekteve të rivlerësimit të parashikonin kalimin e barrës së provës mbi ta. Si rezultat, organet e rivlerësimit vendosën një barrë të pamundur të provës te subjektet e rivlerësimit pa përcaktuar provat që kishin çuar në gjetjet e tyre. Ajo shprehet më tej se organet e rivlerësimit nuk kishin arritur të krijonin një linjë koherente të praktikës gjyqësore në lidhje me çështje të tjera, të tilla si mosjustifikimi i pasurive nga ana e personave të lidhur. Ajo argumentoi se për sa i përket kësaj çështjeje, duhet shtuar edhe dështimi i legjislativit për të siguruar një gamë sanksionesh në mënyrë të përshkallëzuar në vend të rezultatit me dy drejtime (konfirmim në detyrë përkundrejt shkarkimit nga detyra).

c) Vlerësimi i Gjykatës

280. Para se të përcaktojë nëse organet e rivlerësimit janë të pavarura dhe të paanshme, Gjykata do të duhet të përcaktojë nëse ato përbëjnë një “gjykatë të krijuar me ligj” në të cilën kërkuesi kishte qasje në bazë të testit të *Vilho Eskelinen* (shih paragrafin 239 më lart).

i. Nëse organet e vetingut përbëjnë një ‘gjykatë të krijuar me ligj’

α) Parime të përgjithshme

281. Gjykata përsërit parimet e përgjithshme mbi parimin e një “gjykatë të krijuar me ligj” siç përcaktohet në vendimin e fundit të Kolegjit të Lartë në çështjen “*Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës* ([GC], nr. 26374/18, paragrafët 124–27, 211–13, 219–21, 223 dhe 229, 1 dhjetor 2020).

282. Gjykata më tej përsërit se një organ i cili nuk është klasifikuar si një nga gjykatat e vendit, për qëllimet e nenit 6/1, mund të klasifikohet brenda konceptit të një “gjykatë” në kuptimin material të kësaj shprehjeje. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të Gjykatës, një “gjykatë” karakterizohet në atë kuptim thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë, të vendosë për çështjet brenda kompetencës së saj në bazë të rregullimeve ligjore dhe pas procedurave të zhvilluara në një mënyrë të përcaktuar. Ajo, gjithashtu, duhet të përmbushë një sërë kushtesh të mëtejshme, “të tilla si pavarësia, në veçanti nga pushteti ekzekutivi, paanësia, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj ...” (shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, cituar më lart, paragrafi 219, dhe referenca cituar aty). Fuqia e vendimit buron nga vetë nocioni i “gjykatës” (shih *Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës*, nr. 40575/10 dhe 67474/10, paragrafi 139, 2 tetor 2018, dhe referencat e cituara në të).

β) Zbatimi për çështjen në fjalë

283. Gjykata vëren se, në vijim të Raportit të Vlerësimit dhe Strategjisë së Reformës, autoritetet shqiptare prezantuan një numër ndryshimesh kushtetuese dhe miratuan një sërë aktesh ligjore të rëndësishme për të zbatuar reformën në drejtësi. Si pasojë, të gjithë gjyqtarët, prokurorët, këshilltarët ligjorë dhe ndihmësit në detyrë do t'i nënshtroheshin një procesi rivlerësimi kalimtar, i cili do të kryhej nga KPK-ja në shkallën e parë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në nivel apeli.

284. Krijimi dhe funksionimi i KPK-së dhe KPA-së janë parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, plotësuar më tej nga nenet C dhe F të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të miratuar nga Parlamenti. Sipas mendimit të Gjykatës, ato ofrojnë një bazë ligjore mjaft të qartë për krijimin e organeve të rivlerësimit, përgjegjëse për kryerjen e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë (shih paragrafët 103, 106, 112 dhe 122–128 më lart). Fakti se organet e rivlerësimit u krijuan vetëm me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, u parashtrua edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 169 më lart). Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se, për qëllimet e nenit 6/1, një gjykatë nuk ka nevojë të jetë një gjykatë e integruar brenda mekanizmit standard gjyqësor. Ajo mund të krijohet për të shqyrtuar një çështje specifike e cila mund të administrohet në mënyrë të përshtatshme jashtë sistemit të zakonshëm të gjykatës (shih *Mutu dhe Pechstein*, cituar më lart, paragrafi 139).

285. Gjykata vëren më tej se, në bazë të ligjit nr. 84/2016, KPK-ja ka autoritetin të trajtojë të gjitha çështjet e fakteve dhe ligjit. Ky Komision i zhvillon proceset në përputhje me ligjin nr. 84/2016, Kodin e Procedurës Administrative dhe ligjin për gjykatat administrative (shih paragrafët 145, 152, 153 dhe 178 më lart). Në përfundim të procesit, ai merr një vendim mbi themelin e çështjes. Vendimi bëhet përfundimtar dhe i detyrueshëm në rast mosapelimi. Nëse personi që i nënshtrohet rivlerësimit apo Komisioneri Publik ushtron ankim kundër vendimit të KPK-së, Kolegji i Posaçëm i Apelitit shqyrton ankimin dhe vendos për të, duke marrë parasysh të gjitha çështjet faktike dhe ligjore të ngritura në shkaqet e ankimit. Kjo gjë u ritheksua më tej nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2/2017 (shih paragrafin 176 më lart).

286. Në çështjen në fjalë, trupat gjykuese të KPK-së dhe KPA-së u krijuan në përputhje me ligjin, domethënë më anë shortimi. Kërkuesja nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me procedurën e formimit të trupave gjykuese. Pas shqyrtimit të të gjitha çështjeve të faktit dhe ligjit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi për çështjen e kërkujes. Në shkallën e dytë, atë të apelitit, KPA-ja shqyrtoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga kërkujesja dhe kishte juridiksion të plotë mbi çështjet e fakteve dhe ligjit.

287. Së fundmi, si neni 179/b i Kushtetutës ashtu edhe ligji nr. 84/2016, siç edhe evidentohet më tej në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, parashikon që KPK-ja dhe KPA-ja ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur (shih paragrafët 103, 125 dhe 169 më lart).

288. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si KPK-ja ashtu dhe KPA-ja ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbushur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkujesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit *Vilho Eskelinen*. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj.

ii. Për sa i përket “pavarësisë dhe paanshmërisë së organeve të rivlerësimit

α) Parime të përgjithshme

- Në lidhje me pavarësinë

289. Gjykata vëren se termi “i pavarur” i referohet pavarësisë ndaj pushteteve të tjera (pushtetit ekzekutiv dhe parlamentit), si dhe përkundrejt palëve. Në mënyrë që të përcaktohet nëse një gjykatë mund të konsiderohet “e pavarur” në kuptimin e nenit 6/1, duhet të merret parasysh, ndër të tjera, mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe kohëzgjatja e detyrës së tyre, ekzistenca e garancive kundër presionit të jashtëm dhe pyetjes nëse ky organ demonstroi shfaqje të pavarësisë (shih, midis autoriteteve të tjera, *Kleyn dhe të tjerët kundër Hollandës* [GC], nr. 39343/98 dhe 3 të tjerë, paragrafi 190, ECHR 2003 VI; *Oleksandr Volkov*, cituar më lart, paragrafi 103; dhe *Denisov k. Ukrainës* [GC], nr. 76639/11, paragrafi 60, 25 shtator 2018).

290. Gjykata thekson se ekziston një marrëdhënie shumë e ngushtë midis garancive të një gjykate “të pavarur dhe të paanshme” dhe së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Ndërkohë që ato shërbejnë për qëllime specifike si garanci të veçanta të procesit të rregullt ligjor, Gjykata vëren një ndërlidhje të përbashkët që përshkon kërkesat institucionale të nenit 6/1, në atë që ato drejtohen nga qëllimi i mbështetjes së parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve. Gjykata vëren se nevoja për të ruajtur besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe për të mbrojtur pavarësinë e saj përkundrejt pushteteve të tjera qëndron në themel të secilës prej këtyre kërkesave (shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, cituar më lart, paragrafët 231 dhe 233).

291. Në këtë drejtim, “pavarësia” i referohet pavarësisë së domosdoshme personale dhe institucionale që kërkohet për vendimmarrje të paanshme, dhe është kështu parakusht për paanshmëri. Ajo karakterizohet nga: i. një gjendje të brendshme, e cila tregon mosndikimin e një gjyqtari ndaj presionit të jashtëm si çështje integriteti moral; dhe ii. një sërë rregullimesh institucionale dhe procedurale – që përfshijnë si procedurat me të cilat gjyqtarët mund të emërohen në një mënyrë që të sigurojnë pavarësinë e tyre ashtu dhe kriteret e përzgjedhjes bazuar në merita – të cilat duhet të sigurojnë masa mbrojtëse kundër ndikimit të panevojshëm dhe/ose gjykimit të pakufizuar të kompetencave të tjera shtetërore, si në fazën fillestare të emërimit të një gjyqtari ashtu edhe gjatë ushtrimit të detyrave (po aty, paragrafi 234).

- Në lidhje me paanshmërinë

292. Gjykata vë në dukje se paanshmëria normalisht tregon mungesën e paragjykimeve ose gjykimit të njëanshëm dhe se ekzistenca apo mosekzistenca e tyre mund të testohet në mënyra të ndryshme. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6/1 duhet të përcaktohet sipas: i. një testi subjektiv, ku duhet të merret parasysh bindja personale dhe sjellja e një gjyqtari të caktuar, që është, nëse gjykatësi ka pasur ndonjë paragjykim personal ose anshmëri në një çështje të caktuar; dhe ii. një testi objektiv, që do të thotë të konstatohet nëse vetë gjykata dhe, sidomos përbërja e saj, ofrojnë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me paanshmërinë e saj (shih, për shembull, *Kyprianou kundër Qipros* [GC], nr. 73797/01, paragrafi 118, GJEDN] 2005-XIII dhe *Micallef k. Maltës* [GC], nr. 17056/06, paragrafi 93, ECHR 2009).

293. Megjithatë, nuk ekziston një ndarje absolute midis paanshmërisë subjektive dhe asaj objektive, pasi sjellja e një gjyqtari jo vetëm që mund të shkaktojë qëndrime të dyshimta dhe objektive për sa i përket paanshmërisë së gjykatës nga këndvështrimi i vëzhguesit të jashtëm (testi objektiv), por mund të shkojë deri te bindja personale e gjyqtarit (testi subjektiv) (shih *Kyprianou*, cituar më lart, paragrafi 119). Në disa raste kur mund të jetë e vështirë për të marrë prova me të cilat mund të kundërshtohet paanshmëria e pretenduar subjektive e gjyqtarit, kushti i paanshmërisë objektive ofron një garanci të mëtejshme të rëndësishme (shih *Pullar kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 10 qershor 1996, paragrafi 32, raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1996 III dhe *Otegi Mondragon k. Spanjës*, nr. 4184/15 dhe 4 të tjerë, paragrafi 54, 6 nëntor 2018). Në lidhje me këtë, edhe dukja mund të jetë e një rëndësie të caktuar, ose me fjalë të tjera, “drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por gjithashtu duhet të duket”. Ajo që vihet në rrezik është besimi që duhet të frymëzojnë në publik gjykatat në një shoqëri demokratike (shih *Morice kundër Francës* [GC], nr. 29369/10, paragrafi 78, GJEDN] 2015).

β) Zbatimi për çështjen në fjalë

294. Lidhur me çështjen në fjalë, duke marrë parasysh ankimin e kërkuases për mungesë pavarësie dhe paanshmërie nga ana e organeve të rivlerësimit (shih paragrafin 230 më lart), Gjykata do të analizojë nëse dy organet e sipërpërmendura të rivlerësimit përmbushin kërkesat e një gjykate “të pavarur dhe të paanshme” (shih, për shembull, *Clarke kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec), nr. 23695/02, 25 gusht 2005, dhe *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafët 329–64). Për më tepër, Gjykata do të përcaktojë nëse Kolegji i Posaçëm i Apelit ishte një organ gjyqësor që kishte juridiksion të plotë.

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

295. Duke filluar me pavarësinë e KPK-së, kërkuësja pati parasysh mënyrën e emërimit të anëtarëve të këtij Komisioni, përkatësisht zgjedhjen e tyre në bllok nga parlamenti. Gjykata konsideron se ka një larmi sistemesh të ndryshme në Evropë për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve, në vend të një modeli të vetëm që do të aplikohet nga të gjitha vendet. Në lidhje me këtë, gjykata thekson se megjithëse parimi i ndarjes së pushteteve midis organeve politike të qeverisë dhe gjyqësorit ka pësuar rritje në praktikën e saj gjyqësore, përzgjedhja ose emërimi i gjyqtarëve nga pushteti ekzekutiv ose legjislativ është i lejueshëm sipas Konventës, me kusht që, pasi të përzgjidhen ose emërohen, ata të jenë të lirë nga ndikimi ose presioni dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre gjyqësore me pavarësi të plotë (shih *Sacilor-Lormines k. Francës*, nr. 65411/01, paragrafi 67, GJEDN] 2006 XIII; *Flux k. Moldavisë* (nr. 2), nr. 31001/03, paragrafi 27, 3 korrik 2007; *Thiam kundër Francës*, nr. 80018/12, paragrafi 80, 18 tetor 2018; dhe *Guðmundur Andri Ástráðsson*, cituar më lart, paragrafi 207).

296. Edhe pse në përgjithësi, Gjykata nuk ka asnjë arsye të vërë në pikëpyetje mënyrën në të cilën u emëruan anëtarët e KPK-së, përsëri i mbetet asaj të vlerësojë nëse, në çështjen në fjalë, KPK-ja kishte “shfaqjen/dukjen e pavarësisë” që kërkohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me masat mbrojtëse kundër presionit të jashtëm. Kërkuësja nuk arriti të provojë se anëtarët e KPK-së që shqyrtuan çështjen e saj kishin marrë ndonjë udhëzim ose kishin qenë nën presion nga pushteti ekzekutiv. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e çështjes, nuk rezulton të ketë ndonjë provë të një udhëzimi të tillë ose presioni që i është ushtruar trupit gjykues nga pushteti ekzekutiv. Për shkak se përpara se KPK-ja të jepte njoftimin mbi dispozitat përkatëse për çështjen e

saj, Kryeministri i vendit dha një deklaratë të përgjithshme në lidhje me ecurinë e procesit të rivlerësimit në përgjithësi, pa ndonjë lidhje specifike apo të përmendte çështjen e saj, nuk mund të merret si udhëzim ose presion i ushtruar nga ekzekutivi mbi organet e rivlerësimit (shih paragrafët 22 dhe 264 më lart). Deklarata e Kryeministrit përmbante vërejtje të përgjithshme në lidhje me zhvillimet në vazhdim të procesit të rivlerësimit dhe nuk i adresojë ndonjë çështjeje apo individë në mënyrë specifike.

297. Në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të këtyre organeve, Gjykata vëren se, në përputhje me ligjin e brendshëm, anëtarët e KPK-së kanë një mandat pesëvjeçar pa të drejtë riemërimi. Sipas Gjykatës, kohëzgjatja e caktuar e mandatit të anëtarëve të organeve të rivlerësimit nuk përbën asnjë problem. Duke supozuar që periudha kohore e përcaktuar ishte relativisht e shkurtër, kjo është e kuptueshme, duke pasur parasysh natyrën specifike të procesit të rivlerësimit, siç vihet në dukje edhe më tej nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 164 më lart).

298. Gjykata thekson më tej se ajo që ka rëndësi, është mosheqja nga detyra e anëtarëve gjatë mandatit të tyre, e cila konsiderohet të jetë rezultat i pavarësisë së tyre (shih *Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 qershor 1984, paragrafi 80, Seria A nr. 80, dhe *Maktouf dhe Damjanović k. Bosnjës dhe Hercegovinës* [GC], nr. 2312/08 dhe 34179/08, paragrafi 49, GJEDNJ 2013 (ekstrakte), edhe pse në kontekstin e një çështjeje penale; shih, gjithashtu, parimet e përgjithshme që burojnë nga vendimet e GJDBE-së në paragrafin 224 më lart). Mungesa e parashikimit zyrtar të mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve në ligjin nr. 84/2016 nuk nënkupton në vetvete mungesën e pavarësisë, përderisa ajo të njihet në gjendje faktike dhe të ekzistojnë garancitë e tjera të nevojshme (shih *Sacilor-Lormines*, cituar më lart, 67). Mund të shihet nga vetë dispozitat e ligjit nr. 84/2016 se me të vërtetë ky është rasti. As pushteti legjislativ dhe as ai ekzekutiv nuk mund të kërkojnë dorëheqjen ose largimin nga detyra të anëtarëve të organeve të vetingut. Neni 17 i ligjit nr. 84/2016 përcakton rastet specifike kur ata mund të hiqen nga detyra (shih paragrafin 127 më lart). Fakti që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit mund të hiqen nga detyra vetëm në rast të kryerjes së një shkeljeje disiplinore, në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji, nuk vë në dyshim garancitë e nevojshme për mosheqjen e tyre nga detyra, të cilat janë të pranishme në çështjen në fjalë.

299. Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih *Oleksandr Volkov*, cituar më lart, paragrafi 109). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendëse, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kish pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kritereve dhe ka për qëllim rivlerësimin të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është *sui generis* dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve.

300. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (shih paragrafin 123 më lart). Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj (shih paragrafin 124 më lart). Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 106 më lart).

301. Fakti që Qeveria i akordoi Komisionit një shpërblim në fund të vitit 2018 si mirënjohje për punën e tij nuk është në vetvete i mjaftueshëm, sipas opinionit të Gjykatës, për të vënë në dyshim pavarësinë e anëtarëve të tij. Gjykata vëren se KPK-ja ka detyrimin me ligj për të vendosur në mënyrë të pavarur për themelin e secilës çështje (shih paragrafët 103 dhe 125 më lart), dhe se, siç u

tha më lart, kërkuesja nuk demonstroi që anëtarët e saj nuk kishin vepruar në mënyrë të pavarur në çështjen e saj.

302. Gjykata thekson më tej rëndësinë e garancive të parashikuara në legjislacionin e brendshëm, konkretisht, që KPK-ja ka diskrecion të plotë në marrjen e vendimeve për strukturën e saj organizative dhe personelin; nuk merr udhëzime ose orientime nga ekzekutivi. Për më shumë, është vetë KPK-ja që i propozon Parlamentit buxhetin e saj vjetor, pa asnjë ndërhyrje nga ekzekutivi (shih paragrafin 128 më lart).

303. Së fundmi, Komisioni i Venecias dhe Gjykata Kushtetuese arritën në përfundimin se KPK-ja mishëron karakteristikat e një organi të pavarur gjyqësor (shih paragrafët 158 dhe 169 më lart).

304. Duke pasur parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes së kërkuesit, Gjykata nuk sheh prova të mungesës së pavarësisë nga ana e KPK-së.

305. Në lidhje me paanësinë e saj, GJENDJ-ja vëren se kërkuesja nuk e kontestoi paanësinë subjektive të anëtarëve të KPK-së. Gjykata nuk gjen asnjë arsye për të vendosur ndryshe. Sipas kërkueses, frika për mungesën e paanësisë ishte bazuar në faktin se KPK-ja kreu hetimin paraprak dhe më pas vendosi për themelin e çështjes. Gjykata vlerëson që kjo situatë mund të ketë ngritur dyshime të caktuara nga ana e kërkueses në lidhje me paanshmërinë e KPK-së, dhe vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet nga këndvështrimi i testit të paanësisë objektive. Më konkretisht, ajo duhet t'i përgjigjet pyetjes nëse pretendimi i kërkueses për mungesë paanshmërie nga ana e KPK-së mund të konsiderohet objektivisht i justifikuar në rrethanat e çështjes së saj.

306. Gjykata vëren se, ndryshe nga procedurat e zakonshme disiplinore, procesi i rivlerësimit nuk fillon me paraqitjen e një ankimi ose akuze për shkelje [disiplinore]. Si rezultat i funksionimit automatik të ligjit nr. 84/2016 (shih paragrafin 144 më lart), KPK-ja inicion hetimin për të tria deklaratat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit (shih paragrafin 12 më lart), sesa në bazë të gjetjeve të tij që duhej të fillohej procedura disiplinore. Në fakt, Komisioni nuk mori rolin e prokurorit duke ngritur akuza ose padi ndaj kërkueses (në krahasim me *Kamenos*, cituar më lart, paragrafi 105). Detyrat e tij ishin të kufizuara në mënyrë ekskluzive në rivlerësimin e tri kritereve të përcaktuara në aneksin kushtetues dhe ligjin nr. 84/2016. Në përfundim të hetimeve, KPK-ja bëri gjetjet paraprake, pa dalë në ndonjë konkluzion, dhe u ballafaqua me kërkuesen për ato gjetje, në përgjigje të së cilave ajo u ftua të paraqesë mbrojtjen e saj.

307. Në momentin që KPK-ja mori vendimin, në përfundim të procesit, ai vlerësoi nëse provat e marra, përfshirë argumentet dhe dokumentet e parashtruara nga kërkuesja si përgjigje, mjaftonin për ta konfirmuar atë në postin e saj ose për të vendosur një sanksion disiplinor në përputhje me ligjin nr. 84/2016 (shih paragrafin 150 më lart, dhe krahaso me *Kamenos*, cituar më lart, paragrafi 107). Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkueses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkueses në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjitha elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë (shih, për shembull, *Hauschildt kundër Danimarkës*, 24 maj 1989, paragrafi 50, seria nr. 154, dhe *Morel kundër Francës*, nr. 34130/96, paragrafi 45, Gjykata 2000-VI).

308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërrese mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.

- Kolegji i Posaçëm i Apelimit

309. Në lidhje me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, Gjykata vëren se kërkuesja paraqiti pranë KPA-së një ankim kundër vendimit të KPK-së. Në vijim, ajo bëri parashtrime shitesë të hollësishme duke kundërshtuar çdo gjetje të KPK-së. Në vendimin e tij, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, duke pasur parasysh parashtrimet e kërkueses, trajtoi secilin nga shkaqet e ankimit së saj. Ai madje rrëzoi

disa nga gjetjet e KPK-së, pas vlerësimit të ri të provave të dosjes së çështjes dhe shqyrtimit të parashtrimeve të kërkueses, duke zëvendësuar kështu gjetjet e veta të fakteve me ato të KPK-së. Ligji nr. 84/2016 dhe aneksi kushtetues i kanë dhënë kompetenca KPA-së për të prishur një vendim të KPK-së në tërësinë e tij (shih paragrafët 112 dhe 154 më lart). Në këto rrethana, Gjykata krijon bindjen që KPA-ja, pas shqyrtimit të ankimit me shkrim dhe parashtrimeve të kërkueses, kishte juridiksion të plotë për shqyrtimin e çështjes dhe mori një vendim të hollësishëm që adresonte secilin nga shkaqet e ankimit të saj.

310. Së fundmi, Gjykata do të shqyrtojë nëse KPA-ja përmbush kërkesat e pavarësisë dhe paanësisë.

311. Për sa i përket “paraqitjes së pavarësisë” së KPA-së, kërkuësja nuk paraqiti ndonjë fakt në gjendje të vinte në pikëpyetje pavarësinë e tij nga ekzekutivi dhe legjislativi.

312. Gjykata vëren se, në përputhje me procedurën e përshkruar nga ligji nr. 84/2016, anëtarët e KPA-së emërohen për një mandat të parinovueshëm prej nëntë vjetësh, i cili është më i gjatë se mandati i anëtarëve të KPK-së. Anëtarët e KPA-së gëzojnë të njëjtin status si gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 106 më lart). Ligji i brendshëm garanton më tej që në fund të mandatit të tyre anëtarët e KPA-së të emërohen gjyqtarë të gjykatave të apelit (shih paragrafin 207 më lart).

313. Moshejja nga detyra e anëtarëve të KPA-së, pavarësisht nga mungesa e ndonjë pranimi zyrtar të kësaj të fundit, garantohej, gjithashtu, nga ligji nr. 84/2016 në të njëjtën mënyrë si për anëtarët e KPK-së. Ata mund të shkarkohen nga detyra, në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj, në rast të shkeljeve disiplinore. Fakti që anëtarët e KPA-së i nënshtrohen procedimeve disiplinore dhe i nënshtrohen rregullave të disiplinës gjyqësore dhe etikës nuk është në vetvete një shkak për të dyshuar në pavarësinë e tyre (shih, gjithashtu, parimet e përgjithshme që burojnë nga vendimet e Gjykatës në paragrafin 224 më lart).

314. Sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në Kolegi, Gjykata u referohet gjetjeve të saj në paragrafët 299–300 më lart. Ajo u referohet, gjithashtu, gjetjeve të saj në paragrafin 301 më lart në lidhje me shpërblimin e fund-vitit të dhënë në vitin 2018. Për më shumë, ajo merr parasysh masat mbrojtëse ligjore të cilat vlejné gjithashtu edhe për KPA-në, përkatësisht, që: i. vendos në mënyrë të pavarur për themelin e çdo çështje, ii. ka diskrecion të plotë për të vendosur për strukturën organizative dhe personelin e tij; iii. nuk merr udhëzime ose instruksione nga ekzekutivi; dhe iv. propozon buxhetin vjetor të alokuar nga Parlamenti, pa asnjë ndërhyrje nga ekzekutivi (shih paragrafin 128 më lart). Zhvillimi i proceseve gjyqësore monitorohet më tej nga vëzhguesit ndërkombëtarë, të cilët duket se përbëjnë një mbrojtje shtesë (shih paragrafët 105, 129 dhe 130 më lart). Është e vetëkuptueshme që anëtarët e organeve të rivlerësimit i nënshtrohen ligjit në përgjithësi dhe në veçanti rregullave të etikës profesionale (shih paragrafin 125 më lart).

315. Në lidhje me një mungesën e pretenduar të paanësisë, kërkuësja dështoi të paraqesë ndonjë argument në gjendje për t’u shqyrtuar në themel.

316. Duke marrë parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes së kërkueses, Gjykata nuk sheh prova të mungesës së pavarësisë dhe paanësisë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Përfundim

317. Nga kjo rrjedh se si KPK-ja ashtu edhe KPA-ja ishin të pavarura dhe të paanshme. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në këtë drejtim.

2. Përputhshmëria me kërkesën e rregullsisë [së procesit]

a) Parashtrimet e palëve

318. Kërkuësja pretendoi që nga ana e KPK-së procesit i mungonin masat minimale mbrojtëse procedurale: ajo nuk ishte informuar si duhet për “akuzën” e bërë nga KPK-ja dhe nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e përshtatshme. KPK-ja nuk kishte përmendur ndonjë çështje në lidhje me pasaktësinë e deklarimeve vjetore të pasurive ose fshehjen e mundshme të pasurive si pjesë e gjetjeve të hetimit administrativ.

319. Si pikë kryesore e parashtrimeve të ankimit të saj në lidhje me të ardhurat e ligjshme të bashkëjetuesit të saj për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 101 m², kërkuësja i kishte bashkëlidhur ankimit të saj pranë KPA-së dy prova, përkatësisht, një vërtetim të lëshuar nga kompania shqiptare

me të cilën bashkëjetuesi i saj kishte lidhur një kontratë shitje me kusht në vitin 2003 dhe një vërtetim të lëshuar nga ish-punëdhënësi italian i bashkëjetuesit të saj ku vërtetohet se ai kishte punuar për të nga viti 1995 deri në vitin 2001 (shih paragrafin 52 më lart). Edhe pse të dyja provat ishin domethënëse për zgjidhjen e çështjes, Kolegji kishte refuzuar të pranonte provat në dosje, duke dhënë shkaqe të paqarta dhe të pamjaftueshme në vendimin e tij.

320. Së fundmi, kërkuësja pretendoi se duket që KPK-ja se kishte pyetur përfaqësuesit e kompanisë me të cilën bashkëjetuesi i saj kishte lidhur kontratën e shitjes me kusht të vitit 2003, por nuk e kishte treguar këtë gjatë procesit, duke shkaktuar kështu shkelje të parimit të barazisë të armëve.

321. Qeveria parashtroi që provat e reja të kërkuësës nuk ishin pranuar për t'u përfshirë në dosje pasi ato nuk ishin në përputhje me dispozitat e nenit 49 pika 2 të ligjit për gjykatat administrative. Ajo, gjithashtu, kishte dështuar të argumentonte sipas nenit 47 të ligjit për gjykatat administrative përse ajo nuk kishte qenë në gjendje të paraqiste provat para KPK-së. Për më shumë, KPA-ja kishte refuzuar marrjen e provave, në përputhje me nenin 49, pika 6 të ligjit për gjykatat administrative.

322. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, KPA-ja kishte juridiksion të plotë si për faktet ashtu dhe për ligjin. KPA-ja kishte juridiksion jo vetëm për të shqyrtuar çështjen e vendosur nga KPK-ja, ajo gjithashtu, kishte ushtruar kompetenca të shqyrtimit kushtetues në mënyrë që të garantonte të drejtën e kërkuësës për një ankim efektiv përpara një gjykate. Duke pasur parasysh kompetencat e saj, KPA-ja mund të lërë në fuqi ose të prishë vendimin e KPK-së, duke dhënë një vendim të arsyetuar me shkrim. Si Komisioni i Venecias ashtu edhe Gjykata Kushtetuese e kishin theksuar këtë rol të saj.

323. Qeveria u shpreh se kërkuësja ishte përfaqësuar para KPA-së nga një avokat i zgjedhur prej saj. Ajo nuk kishte paraqitur asnjë argument para KPA-së se i kishte munguar koha e duhur ose mjetet e mjaftueshme për të paraqitur mbrojtjen e saj. Ajo nuk kishte bërë ndonjë kërkesë për t'i dhënë kohë shtesë për t'u njohur me provat ose për të paraqitur prova të reja.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Parimet e përgjithshme

324. Gjykata përsërit se nuk është detyra e saj të zërë vendin e gjykatave vendëse. U takon kryesisht autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm (shih, midis autoriteteve të tjera, *Nejdet Şabin dhe Perihan Şabin kundër Turqisë* [GC], nr. 13279/05, paragrafi 49, 20 tetor 2011).

325. Neni 6 i Konventës nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave ose mënyrën e vlerësimit të tyre, që për këtë arsye janë kryesisht çështje për rregullim nga legjislacioni i brendshëm dhe gjykatat vendëse (shih, mes shumë autoriteteve të tjera, *García Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata 1999 I). U takon gjykatave vendëse të vlerësojnë rëndësinë e provave të parashtruara, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës (shih *Centro Europa 7 Srl dhe Di Stefano kundër Italisë* [GC], nr. 38433/09, paragrafi 198, Gjykata 2012, dhe *Lady SRL kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 39804/06, paragrafi 27, 23 tetor 2018).

326. Gjykata vëren se e drejta për një proces të drejtë ligjor siç garantohet nga neni 6/1 i Konventës përfshin të drejtën e palëve në proceset gjyqësore për të paraqitur çdo parashtrim që ata e konsiderojnë të rëndësishëm për çështjen e tyre. Qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta teorike ose imagjinare, por të drejta praktike dhe efektive, e drejtë kjo që mund të shihet të jetë efektive vetëm nëse parashtrimet “dëgjohen” me të vërtetë, domethënë, konsiderohen siç duhet nga gjykatat vendëse. Me fjalë të tjera, efekti i nenit 6 është, ndër të tjera, për ta detyruar “gjykatën” për të kryer shqyrtimin e duhur të parashtrimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin e saj nëse ato janë apo jo të rëndësishme (shih, midis autoriteteve të tjera, *Perez kundër Francës* [GC], nr. 47287/99, paragrafi 80, GJEDNJ 2004-I).

327. Ndërkohë që neni 6 kërkon që gjykatat vendëse të shprehin në mënyrën e duhur arsyet në të cilat bazohen vendimet e tyre, ai nuk kërkon një përgjigje të hollësishme për çdo argument të paraqitur nga një kërkuës. Ky detyrim presupozon gjithsesi që një palë në një proces mund të presë një përgjigje specifike dhe të shprehur për ato parashtrime që janë përcaktuese për përfundimin e

procesit në fjalë (shih, mes shumë autoriteteve të tjera, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, paragrafët 29–30, seria A, nr. 303-A).

328. Në funksion të këtyre parimeve të përgjithshme, Gjykata do të përcaktojë nëse procesi, i marrë si një i tërë, ishte i rregullt.

ii. Zbatimi në çështjen në fjalë

329. Gjykata vëren se për shkak të përfshirjes së kërkuases në një listë prioritare të individëve që do t'i nënshtrohen rivlerësimit kalimtar, KPK-ja inicioi hetimin administrativ për tri deklaratat që kërkuësja kishte paraqitur në përputhje me ligjin nr. 84/2016 (shih paragrafin 12 më lart.) Fillimi i hetimit ishte në përputhje me ligjin nr. 84/2016 (shih paragrafin 144 më lart). Në përfundim të këtij hetimi, KPK-ja informoi kërkuësen për gjetjet e tij paraprake. Raporti përmban shprehimisht se gjetjet paraprake ishin bërë për faktin se mes të tjerash ajo kishte pasur: i. mospërputhje në lidhje me burimin e të ardhurave të pasurive, ii. mungesë të dokumenteve mbështetëse në lidhje me burimet e fondeve të përdorura për blerjen e pasurive, iii. të ardhura të pamjaftueshme të ligjshme për të justifikuar sasinë e madhe të likuiditeteve në vite të caktuara; dhe iv. mospërputhje në lidhje me pjesën takuese të kërkuases në pasuri të caktuara (shih paragrafin 15 më lart).

330. KPK-ja konstatoi gjetjet paraprake pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të marrë nga institucione të ndryshme si dhe nga shpjegimet dhe informacionet e dhëna nga kërkuësja në përgjigje të pyetjeve të tij. Për më shumë, raporti iu referua dokumenteve që kishin shërbyer si bazë për ato gjetje. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, informacioni që kërkuësja mori pas përfundimit të hetimit administrativ duhet t'i kishte mundur asaj që të kuptonte seriozitetin e gjetjeve paraprake me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së përshtatshme.

331. Pretendimi nga ana e kërkuëse se KPK-ja kishte fshehur prova të caktuara është thjesht hamendje e cila është paraqitur me vonesë dhe nuk është mbështetur nga ndonjë provë.

332. Gjatë gjithë procesit pranë KPK-së, në veçanti pas kalimit së barrës së provës kërkuëse për të rrëzuar gjetjet paraprake, ajo parashtrroi argumente të gjera për mbrojtjen e saj dhe paraqiti parashtrime të shumta me shkrim. Asaj iu dha akses në dokumentacionin e çështjes dhe në metodologjinë e përdorur për të përlllogaritur shpenzimet në mënyrë që të përgatiste mbrojtjen. Asaj iu dha kohë të paraqesë kërkesat e saj (shih paragrafin 16 më lart). Nuk ka asnjë indikacion që asaj i mungonte koha dhe mundësitë për të përgatitur një mbrojtje të përshtatshme, sepse duket se ajo nuk bëri asnjë kërkesë ose ngriti këto çështje për këtë qëllim para KPK-së ose KPA-së.

333. Së fundmi, Gjykata vëren se KPK-ja kishte juridiksion të plotë për të gjitha çështjet faktike dhe ligjore. Ajo u krijua posaçërisht për të interpretuar dhe zbatuar ligjin nr. 84/2016. Vlerësimi i fakteve kërkonte vërtet njohuri të specializuara ose përvojë specifike profesionale, prandaj ligji nr. 84/2016 tregon institucionet ndihmëse që do të ndihmonin KPK-në në kryerjen e detyrave të tij (shih paragrafët 135–142 më lart). Kjo theksohet, gjithashtu, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila shtoi më tej se vendimmarrja përfundimtare do t'i takonte KPK-së (shih paragrafët 169–70 më lart). Në çështjen e kërkuëse, KPK-ja mori vendimin duke parashtruar shkaqet për shkarkimin e saj nga detyra.

334. Pas njoftimit të vendimit të KPK-së, kërkuësja, e cila vazhdoi të përfaqësohej nga një avokat të zgjedhur prej saj, paraqiti një ankim të gjerë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke kundërshtuar, ndër të tjera, provat faktike që kishin shërbyer si bazë për shkarkimin e saj. Ajo paraqiti, gjithashtu, parashtrime të mëtejshme me shkrim. Është e qartë nga vendimi i Kolegjit që ai shqyrtoi një më një shkaqet e ankimit dhe shqyrtoi me hollësi gjetjet faktike dhe ligjore të bëra nga KPK-ja, duke respektuar kështu kërkesën e “juridiksionit të plotë” të procesit nga ana e tij, siç parashikohet në mënyrë autonome sipas objektit dhe qëllimit të Konventës (shih *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, cituar më lart, paragrafi 177). Pasi rishqyrtoi faktet dhe materialet në dosjen e çështjes, KPA-ja mbështeti disa nga gjetjet e KPK-së, zëvendësoi vlerësimin e bërë nga KPK-ja me të sajën dhe rrëzoi disa nga gjetjet e tjera të KPK-së. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, Kolegji veprroi në përputhje me nenin F të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, i cili parashikon që ai të lehtësojë, ndryshon ose prish një vendim të KPK-së (shih paragrafët 112 dhe 154 më lart).

335. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Kolegji dha shkaqe të mjaftueshme për vendimin e tij, duke iu përgjigjur secilit nga shkaqet e ankimit të kërkuëse. Gjykata është, gjithashtu, e bindur

që KPA-ja dha arsyet e duhura për të mos pranuar provat e reja të paraqitura pranë saj nga ana e kërkueses (shih paragrafin 60 më lart). Neni 6 kërkon që gjykatat vendëse të paraqesin në mënyrën e duhur arsyet në të cilat bazohen vendimet e tyre. Ky detyrim presupozon që një palë e procesit mund të presë një përgjigje specifike dhe të shprehur për ato parashtime që janë përcaktuese për rezultatin e procesit në fjalë (shih paragrafin 327 më lart).

336. Nën dritën e të gjitha rrethanave të lartpërmendura, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me rregullsinë e procesit.

3. *Përputhshmëria me kërkesën për mbajtjen e seancës publike nga ana e KPA-së*

a) Parashtrimet e palëve

337. Kërkuësja parashtroi që Kolegji duhej të kishte mbajtur një seancë publike për çështjen e saj në funksion të shkaqeve të ankimit të ngritura nga ana e saj, të cilat kishin kundërshtuar çështje faktike dhe juridike. Ligji nr. 84/2016 nuk parashikonte mundësinë e një seance publike para KPA-së, dhe ajo as nuk mund të paraqiste një kërkesë për këtë qëllim. Nuk kishte pasur rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar mosmbajtjen e një seance publike nga ana e KPA-së.

338. Qeveria argumentoi që kërkuësja nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seancë publike para KPA-së, e cila, nga ana tjetër, ishte shprehur se duke marrë parasysh rrethanat e çështjes në fjalë mbajtja e seancës publike ishte e panevojshme. Vendimi i KPA-së ishte marrë në përputhje me nenin 51 të ligjit për gjykatat administrative.

b) Vlerësimi i Gjykatës

339. Gjykata ka përcaktuar që e drejta për një seancë publike sipas nenit 6/1 nënkupton të drejtën për një seancë dëgjimore para të paktën një shkalle gjykimi (shih, mes autoriteteve të tjera, *Fischer kundër Austrisë*, 26 prill 1995, paragrafi 44, seria A, nr. 312). Mosmbajtja e një seance publike në shkallën e dytë ose të tretë mund të justifikohet nga aspekte të veçanta të proceseve në fjalë, me kusht që në shkallë të parë të jetë mbajtur më përpara një seancë publike (shih *Salomonsson kundër Suedisë*, nr. 38978/97, paragrafi 36, 12 nëntor 2002). Edhe pse nuk është e rëndësishme për çështjen në fjalë, Gjykata vëren, në mënyrë të anasjelltë, mungesa e një seance publike në shkallën e parë mund të rregullohet nëse seanca publike mbahet në fazën e ankimit, me kusht që fusha e procesit të apelit të shtrihet në çështje ligjore dhe faktike (shih, për shembull, në një kontekst disiplinor, *Buterlevičiūtė kundër Lituanisë*, nr. 42139/08, paragrafët 52–54, 12 janar 2016).

340. Ndërkohë që detyrimi për të mbajtur një seancë publike nuk është absolut, Gjykata ka përcaktuar që, në kontekstin e proceseve disiplinore ndaj gjyqtarëve, në funksion të asaj që është në rrezik, d.m.th., ndikimit të dënimeve të mundshme në jetën dhe karrierën e personave në fjalë dhe implikimeve të tyre financiare, mosmbajtja e asnjë seance dëgjimore duhet të jetë një masë e jashtëzakonshme dhe duhet të justifikohet siç duhet nën dritën e praktikës gjyqësore (shih *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, cituar më lart, paragrafi 210).

341. Në lidhje me çështjen aktuale, Gjykata vëren në radhë të parë se KPK-ja, e cila ishte e pavarur dhe e paanshme, mbajti një seancë publike në të cilën kërkuësja u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur prej saj, bëri parashtime verbale dhe paraqiti prova të tjera me shkrim (për kontrast, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, cituar më lart, paragrafi 209). Për të shqyrtuar këto prova shtesë, KPK-së i është dashur të shtyjë seancën pa marrë vendimin për çështjen e kërkueses.

342. Së dyti, nuk ka asnjë indicie nga ankimi i saj dhe parashtresat shtesë me shkrim që kërkuësja kërkoi në apel një seancë publike (për kontrast *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, cituar më lart, paragrafi 209). Ndërkohë që ligji nr. 84/2016 nuk parashikon ose ndalon shprehimisht mundësinë e një seance publike para KPA-së, Gjykata vëren se institucionet e rivlerësimit zbatojnë, ndër të tjera, procedurat e përcaktuara në ligjin për gjykatat administrative sa herë që procedura të tilla nuk janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016 (shih paragrafin 125 më lart). Në lidhje me këtë, neni 51 i ligjit për gjykatat administrative rendit kushtet për mbajtjen e një seance publike në apel (shih paragrafin 196 më lart). Kolegji i Posaçëm i Apelit, pavarësisht mungesës së një kërkesë nga kërkuësja për këtë qëllim, dha arsyet e duhura në vendimin e tij për të mos mbajtur një seancë publike për çështjen e kërkueses (shih paragrafin 61 më lart).

343. Së fundmi, Gjykata do të përcaktojë nëse, pavarësisht mbajtjes së një seance publike para KPK-së dhe pavarësisht mungesës së një kërkesë për këtë qëllim nga kërkuësja para KPA-së, natyra

e procesit kërkonte që të mbahej një seancë publike në apel. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkuesja kishte mundësi të mjaftueshme për të parashtruar me shkrim çështjen e saj para KPA-së (për krahasim *Vilho Eskelinen*, cituar më lart, paragrafi 74). Pjesa më e madhe e shkaqeve të ankimit kishin të bënin me problematika ligjore ose pyetje teknike në lidhje me vlerësimin e pasurive që mund të trajtoheshin në mënyrë të kënaqshme në bazë të dokumentacionit të çështjes (shih, *mutatis mutandis*, përkatësisht, *Varela Assalino kundër Portugalisë* (dek.), nr. 64336/01, 25 prill 2002 dhe *Schuler-Zraggen kundër Zvicrës*, 24 qershor 1993, paragrafi 58, seria A, nr. 263). Procesi nuk kërkon dëgjimin e dëshmitarëve ose marrjen e provave të tjera verbale. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata nuk konstaton se natyra e procesit kërkonte mbajtjen e një seancë publike në apel përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

344. Prandaj nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mungesën e një seance publike para përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

4. Përputhshmëria me parimin e sigurisë juridike

a) Parashtrimet e palëve

345. Kërkuesja parashtrroi që ligji nr. 84/2016 nuk parashikonte ndonjë kufizim të veçantë ligjor në lidhje me vlerësimin e pasurive. Kjo i ka lejuar institucionet e rivlerësimit të shqyrtojnë transaksione të kryera në një të kaluar shumë të largët, duke çuar në një transferim të paarsyeshëm të barrës së provës. Në fund të fundit kërkuesja ishte shkarkuar nga detyra për shkak të rrethanave dhe fakteve që datonin në vitet '90, për të justifikuar blerjen e një apartamenti me të ardhurat e bashkëjetuesit të saj. Shtrirja e gjatë kohore e procesit të rivlerësimit e kishte vendosur kërkuesen në një pozitë të pamundur për arsye objektive.

346. Qeveria parashtrroi që KPK-ja kishte filluar një hetim të plotë për deklarimin e pasurisë që kërkuesja kishte depozituar në përputhje me ligjin nr. 84/2016. KPK-ja kishte përdorur si provë deklaratat periodike të pasurive të cilat kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj kishin paraqitur pranë ILDKPKI-së. Verifikimi dhe krahasimi i të gjitha deklaratave të pasurive i kishin mundësuar KPK-së të gjurmonte progresin dhe vërtetësinë e deklaramit të pasurive dhe të nxirrte konkluzione mbi mjaftueshmërinë e deklaramit ose ligjshmërinë e të ardhurave përgjatë viteve, si dhe mbi burimet e përdorura për krijimin e pasurive. Pas mbylljes së hetimit administrativ, KPK-ja konsideroi se provat që kishte marrë kishin vlerë provuese drejt vërtetimit të fakteve dhe rrethanave që lidhen me çështjen e kërkueses.

347. Në këto rrethana, ai e kishte informuar kërkuesen për gjetjet e tij paraprake dhe ia kishte kaluar asaj barrën e provës për të provuar të kundërtën. Çdo gjetje ishte mbështetur në provat në të cilat ajo bazohej. I takonte plotësisht kërkueses të përcaktonte se si ajo të përgatiste më mirë mbrojtjen e saj dhe të siguronte çdo dokument në mbështetje të mbrojtjes së saj. Ajo duhej të tregonte se kishte ndërmarrë të gjitha hapat për të marrë ose siguruar prova në mbështetje të pretendimeve të saj, në përfundim të të cilave institucionet e rivlerësimit do të përcaktinin nëse mosmarrja e ndonjë dokumenti mbështetës ishte justifikuar për shkaqe të arsyeshme. Një garanci e tillë procedurale ishte futur për të trajtuar situatën e pas viteve '90 në Shqipëri dhe kishte garantuar, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, një vlerësim diskret të secilës problematikë nga institucionet e rivlerësimit, pa penguar ose prishur përfundimin me sukses të procesit të rivlerësimit.

b) Vlerësimi i Gjykatës

348. Gjykata ka përcaktuar që afatet e parashkrimit shërbejnë për disa qëllime të rëndësishme, domethënë për të siguruar sigurinë ligjore dhe përfundimtare, për të mbrojtur të pandehurit e mundshëm nga pretendime të vjetruara të cilat mund të jetë e vështirë për t'u kundërshtuar, dhe për të parandaluar çdo padrejtësi që mund të lindë nëse gjykatave u kërkohej të vendosnin për ngjarje të ndodhura në të kaluarën e largët në bazë të provave të cilat mund të jenë ose jo të besueshme dhe jo të plota për shkak të kalimit të kohës. Afatet e parashkrimit janë një tipar i përbashkët i sistemeve të brendshme ligjore të Shteteve nënshkruese të Konventës në lidhje me veprat penale, disiplinore dhe veprat e tjera (shih *Oleksandr Volkov*, cituar më lart, paragrafi 137).

349. Sidoqoftë, Gjykata konsideron që duhet të merren parasysh, gjithashtu, tiparet e veçanta të proceseve të kontrollit të pasurive të përdorura gjerësisht. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, duke pasur parasysh që pasuritë personale ose familjare janë akumuluar normalisht gjatë punësimit,

vendosja e kufijve të rreptë kohorë për vlerësimin e pasurive do të kufizonte shumë dhe do të cenonte kapacitetet e autoriteteve për të vlerësuar ligjshmërinë e totalit të pasurive të përfituara nga një subjekt gjatë karrierës së tij profesionale. Në lidhje me këtë, vlerësimi i pasurisë manifeston specifika të caktuara, ndryshe nga hetimet e zakonshme disiplinore, të cilat do të kërkonin një shkallë më të lartë fleksibiliteti për shtetin e paditur për zbatimin e kufizimeve ligjore, në përputhje me objektivin e rikthimit dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin e një niveli të lartë integriteti që pritet nga anëtarët e gjyqësorit. Kjo është edhe më e vërtetë në kontekstin shqiptar ku verifikimi paraprak i deklaratave të pasurisë nuk kishte qenë veçanërisht efektiv (shih paragrafët 220 dhe 272 më lart). Së fundmi, mund të jetë, gjithashtu, një çështje interpretimi se kur saktësisht një shkelje e veçantë disiplinore mund të ketë ndodhur në këtë kontekst, domethënë, nëse në kohën kur është blerë fillimisht pasuria ose në një pikë të mëvonshme, në kohën kur pasuria është deklaruar në një deklaratë periodike. Në të njëjtën kohë, një fleksibilitet i tillë nuk mund të jetë i pakufizuar dhe implikimet për sigurinë juridike dhe të drejtat e një kërkuesi sipas nenit 6/1 të Konventës duhet të konsiderohen rast pas rasti.

350. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se karriera gjyqësore e kërkueses filloi në vitin 1995 dhe vazhdoi pa ndërprerje deri në shkarkimin e saj nga detyra në vitin 2018. Gjetjet kundër saj u bazuan si në deklarimin e bërë në deklaratën e saj për rivlerësim ashtu edhe në deklaratat e mëparshme periodike të pasurisë së paraqitura nga ajo dhe bashkëjetuesi i saj. Objektivi i vlerësimit të pasurive ishte kontrolli i ligjshmërisë së burimit të përfitimit të pasurive dhe verifikimi i vërtetësisë së deklaratës për rivlerësim kundrejt deklaratave të mëparshme periodike të pasurive. Kjo ishte arsyeja që institucionet e rivlerësimit do të përdornin si prova deklaratat periodike vjetore të pasurive që ajo kishte depozituar pranë ILDKPKI-së për të siguruar që të gjitha pasuritë, përfshirë burimet e ligjshme financiare të cilat kishin shërbyer si bazë për përfitimin e tyre, që ato të ishin deklaruar dhe justifikuar më mënyrë të saktë.

351. Institucionet e rivlerësimit shqyrtuan pasuritë, burimet fillestare financiare të cilave ishin siguruar në vitet 1990 ose 2000. Është e kuptueshme që kërkuesja u vendos në një pozicion disi të vështirë për të justifikuar natyrën e ligjshme të burimeve financiare për shkak të kalimit të kohës dhe mungesës së mundshme të dokumenteve mbështetëse. Sidoqoftë, kjo situatë ishte pjesërisht për shkak të dështimit të vetë kërkueses për të deklaruar pasurinë përkatëse në kohën e përfitimit të saj, e cila ishte shumë më afër periudhës gjatë së cilës burimet fillestare financiare ishin siguruar nga ajo dhe bashkëjetuesi i saj. Për më tepër, Gjykata vëren se neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon rrethana lehtësuese nëse subjekti i rivlerësimit përballet me pamundësi objektive për të paraqitur dokumente mbështetëse (shih paragrafin 136 më lart). Në rastin e kërkueses, institucionet e rivlerësimit konstatuan se kërkuesja nuk kishte siguruar ndonjë dokument mbështetës që justifikonte ekzistencën e një pamundësie objektive për të demonstruar natyrën e ligjshme të të ardhurave të bashkëjetuesit të saj nga viti 1992 deri në vitin 2000 (shih paragrafët 28 dhe 69 më lart). Për më shumë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të mbahet parasysh konstatimi i KPA-së se kursimet e bashkëjetuesit të kërkueses, edhe nëse pranohen ashtu siç pretendohen, nuk do të kishin mjaftuar për të blerë pasurinë në fjalë (shih paragrafin 70 më lart).

352. Gjykata përsërit më tej se nuk është *në vetvete* arbitrare, për qëllimet e aspektit “civil” të nenit 6/1 të Konventës, që t’i kalohej barra e provës kërkueses në procesin e rivlerësimit pasi KPK-ja i kishte vënë asaj në dispozicion gjetjet paraprake në përfundim të hetimit dhe i kishte dhënë asaj mundësi për t’u njohur me provat e çështjes (shih *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, nr. 36862/05, paragrafi 122, 12 maj 2015, në kontekstin e procedurave të konfiskimit *in rem*, dhe, *mutatis mutandis*, *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 19955/05 dhe 15085/06, paragrafët 37–49, 23 shtator 2008, në kontekstin e një urdhri konfiskimi në çështje trafikimi droge).

353. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se, duke pasur parasysh procesin e vlerësimit të pasurive personale ose familjare të grumbulluara gjatë jetës profesionale të gjyqtarës, rrethanat lehtësuese të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, dështimin e kërkueses për të paraqitur dokumente mbështetëse që vërtetojnë pamundësinë objektive për të treguar natyrën e ligjshme të të ardhurave të bashkëjetuesit të saj dhe mosveprimin e saj për të deklaruar pasuritë në periudhën përkatëse kur ajo

i ka përfituar ato, nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me pretendimin e shkeljes së parimit të sigurisë juridike.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

354. Kërkuësja pretendoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të shkarkimit të saj të paligjshëm dhe arbitrar nga detyra dhe ndalimit të përjetshëm të vendosur për ushtrimin e profesionit të saj.

355. Neni 8 i Konventës parashikon si vijon:

“1. Çdokush ka të drejtë të respektojë jetën e tij... private

2. Nuk do të ketë ndërhyrje nga një autoritet publik në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç se kur ajo është në përputhje me ligjin dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e prishjes së rendit ose krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

A. Pranueshmëria

a) Për sa i përket pretendimit në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkuëses

a) Parashtrimet e palëve

356. Duke iu referuar vendimit të GJENDJ në çështjen *Denisov* (cituar më lart), Qeveria pretendoi që neni 8 nuk ishte i zbatueshëm pasi kërkuësi nuk kishte arritur të demonstronte që ishte arritur pragu i rëndësisë në lidhje me tri kriteret e trajtuara aty. Për më shumë, vendosja e një sanksioni disiplinor nuk mund të shkaktojë në vetvete prishjen e reputacionit nëse prej tij nuk do të rezultonin pasoja serioze. Qeveria u shpreh më tej që kërkuësja nuk kishte parashtruar përpara KPA-së asnjë shkelje të nenit 8 të Konventës.

357. Kërkuësja u shpreh se shkarkimi i saj nga detyra kishte përmbushur prapun e kriterëve të përcaktuara në çështjen *Denisov* (cituar më lart), si rezultat i të cilave neni 8 ishte i zbatueshëm. Ajo ishte paraqitur ankimin përpara KPA kundër shkarkimit të saj, pasojat e së cilës ishin të dukshme në jetën e saj private. Në këto rrethana, ajo kishte shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike.

b) Vlerësimi i GJENDJ-së

i. Zbatimi i nenit 8

358. Ndërkohë që Qeveria ka kundërshtuar zbatimin e nenit 8 të Konventës për çështjen e kërkuëses, Gjykata do të shqyrtojë së pari këtë kërkesë për mospranim.

α) Parimet e përgjithshme

359. Në çështjen *Denisov* (të cituar më lart), Kolegji i Lartë konfirmoi se mosmarrëveshjet në lidhje me punësimin nuk ishin të përjashtuara në vetvete nga fusha e “jetës private” brenda kuptimit të nenit 8 të Konventës. Ekzistojnë disa aspekte tipike të jetës private të cilat mund të ndikohen nga mosmarrëveshje të tilla si shkarkimi nga detyra, ulja në detyrë, mospranimi në një profesion ose masa të tjera të ngjashme të pafavorshme. Këto aspekte përfshijnë: i. “rrethin e ngushtë” të kërkuësit; ii. mundësinë e kërkuësit për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët; dhe iii. reputacionin social dhe profesional të kërkuësit. Ekzistojnë dy mënyra në të cilat një problematikë e jetës private zakonisht ngrihet në një nivel të tillë mosmarrëveshjeje: ose për shkak të shkaqeve fillestare të masave të kundërshtuara (në atë rast Gjykata përdor qasjen e bazuar në arsye) ose – në raste të caktuara – për shkak të pasojave për jetën private (në atë rast Gjykata përdor qasjen e bazuar në pasoja – po aty, paragrafi 115).

360. Nëse zbatohet qasja e bazuar në pasoja, pragu i rëndësisë në lidhje me të gjitha aspektet e lartpërmendura merr një rëndësi thelbësore. Duhet që kërkuësi të tregojë bindshëm se ishte arritur pragu në çështjen e tij ose të saj. Kërkuësi duhet të paraqesë prova që vërtetojnë pasojat e masës së kundërshtuar. Gjykata do të pranojë që neni 8 të jetë i zbatueshëm vetëm kur këto pasoja janë shumë serioze dhe ndikojnë në jetën e tij/saj private në një shkallë shumë domethënëse (shih *Denisov*, cituar më lart, paragrafi 116).

361. Gjykata ka vendosur kriteret për vlerësimin e rëndësisë ose seriozitetit të shkeljeve të pretenduara në kontekste të ndryshme rregullatore. Vuajtjet e një kërkuësi duhet të vlerësohen duke krahasuar jetën e tij ose të saj para dhe pas dhënies së masës në fjalë. Gjykata konsideron më tej se gjatë përcaktimit të rëndësisë së pasojave në çështjet e lidhura me punësimin është e përshtatshme

të vlerësohen perceptimet subjektive të pretenduara nga kërkuesi përkundrejt kontekstit të rrethanave objektive që ekzistojnë në një çështje të veçantë. Kjo analizë do të duhet të mbulonte ndikimin material dhe jomaterial të masës së pretenduar. Sidoqoftë, i mbetet kërkuesit që të përcaktojë dhe vërtetojë natyrën dhe shkallën e vuajtjes së tij ose të saj, e cila duhet të ketë një lidhje shkakësore me masën e kundërshtuar. Duke pasur parasysh rregullin e shterimit të mjeteve të brendshme juridike, elementet thelbësore të pretendimeve të tilla duhet të jenë paraqitur në mënyrë të mjaftueshme përpara autoriteteve të brendshme që trajtojnë çështjen (shih *Denisov*, cituar më lart, paragrafi 117).

β) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në çështjen aktuale

362. GJENDJ-ja vëren se, gjatë vlerësimit të zbatimit të nenit 8 në çështjen në fjalë, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet sipas qasjes së bazuar në arsye: shkarkimi i kërkueses nga detyra gjyqësore në lidhje me detyrën e saj si gjyqtare nuk kishte asnjë lidhje me jetën e saj private. Ndërkohë që përfitimi ose krijimi i pasurive mund të konsiderohet të jetë një aspekt i jetës private, nuk është numri ose madhësia e aseteve ose stili i jetës së një individi ai që mund të shkaktojë përgjegjësi disiplinore, por paaftësia e individit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të përdorur për përfitimin ose krijimin e tyre dhe për të siguruar besimin e publikut në integritetin e tij ose të saj. Në çdo rast, GJENDJ-ja konsideron se kontrolli i pasurive nuk përfshin një aspekt intim të sjelljes private që trajtohet në vetvete si një shkelje etike (për kontrast, *Özpinar kundër Turqisë*, nr. 20999/04, 19 tetor 2010).

363. Sa i përket qasjes së bazuar në pasoja, GJENDJ vëren si vijon. Kërkuesja u shkarkua nga pozicionin i saj gjyqësor në përputhje me ligjin nr. 84/2016, duke humbur të gjithë pagën e saj me efekt të menjëhershëm (shih *Polyakh dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafët 208–09; për kontrast *JB dhe të tjerët kundër Hungarisë* (dec.), nr. 45434/12 dhe 2 të tjerë, paragrafët 132–33, 27 nëntor 2018 dhe *Camelia Bogdan kundër Rumanisë*, nr. 36889/18, paragrafët 85–86, 20 tetor 2020). Kjo pa dyshim që pati pasoja serioze për “rrethin e saj të ngushtë”, domethënë mirëqenien e saj dhe anëtarëve të familjes së saj. Për më tepër, institucionet e rivlerësimit shqyrtuan edhe aftësitë e saj profesionale dhe konstatuan se ajo kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (për kontrast *J.B. dhe të tjerët* (dec.), cituar më lart, paragrafi 136). Një pasojë e mëtejshme e këtij konstatimi është se në sytë e shoqërisë, kërkuesja ishte dhe vazhdon të stigmatizohet si e padenjë për të kryer një funksion gjyqësor.

364. Në funksion të këtyre observacioneve, Gjykata konsideron se neni 8 i Konventës zbatohet në çështjen aktuale dhe për këtë arsye ajo rrëzon kundërshtimin e qeverisë.

ii. Shterimi i mjeteve të brendshme

365. Pasi konstatoi që neni 8 është i zbatueshëm për çështjen në fjalë, GJENDJ-ja përsërit se kërkuesja kundërshtoi vendimin e KPK-së duke e ankimuar atë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Shkaqet në detaje të ankimit kundërshtuan çdo konstatim të bërë nga KPK-ja që kishte çuar në shkarkimin e saj, duke ndikuar në të drejtën e saj për të respektuar jetën e saj private. KPA-ja nuk e refuzoi juridiksionin në këtë çështje, por shqyrtoi çështjen në themel në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

366. Duke pasur parasysh sa më sipër, duke ndjekur rrugën e korrigjimit të parashikuar në ligjin nr. 84/2016, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesja ngriti në themel ankimin e saj sipas nenit 8 dhe kështu ishte në përputhje me kërkesat e nenit 35/1 të Konventës. Prandaj kundërshtimi i qeverisë për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme duhet të rrëzohet.

iii. Përfundim

367. Gjykata, duke theksuar se ky shkak ankimi nuk është qartësisht i pabazuar dhe i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër sipas nenit 35 të Konventës, e deklaroi atë të pranueshëm.

b) Për sa i përket pretendimit në lidhje me ndalimin e përbërshëm për të praktikuar profesionin [e avokatit]

a) Parashtrimet e palëve

368. Qeveria parashitroi që kërkuesja nuk kishte ngritur këtë ankim sipas nenit 8 para autoriteteve të brendshme. Ajo nuk kishte iniciuar asnjë proces gjyqësor, një e drejtë kjo e veçantë dhe e pavarur nga rezultati i procesit të rivlerësimit. Qeveria u shpreh më tej se ky pretendim është qartësisht i pabazuar pasi kushtet e parashikuara në ligjin për avokatinë nuk kishin për qëllim të

përrjashtonin nga ushtrimi i profesionit të avokatit individët e larguar nga drejtësia si rezultat i procesit të rivlerësimit.

369. Kërkuesja parashtroi se ajo kishte një licencë për të ushtruar profesionin e avokatit. Thelbi i pretendimit të saj ishte megjithatë se në përputhje me ligjin për avokatinë, rrezikon që asaj t'i hiqet e drejta e avokatisë, pa iu dhënë mundësia për t'u bërë anëtare e Dhomës së Avokatëve.

b) Vlerësimi i Gjykatës

370. Gjykata përsërit se në mënyrë një person të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë sipas nenit 34, ai/ajo duhet të jetë në gjendje të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të përcaktuara në Konventë. Në mënyrë që të pretendojë që të jetë viktimë e një shkelje, një person duhet të preket drejtpërdrejt nga masa e kundërshtuar: Konventa nuk parashikon sjelljen e një *actio popularis* për interpretimin e të drejtave që përmban ose lejon individët të ankohen për një dispozitë të legjislationit të brendshëm thjesht, sepse ata konsiderojnë, pa qenë të prekur drejtpërsëdrejti nga ajo, që ajo mund të jetë në kundërshtim me Konventën. Sidoqoftë, çdo person është i hapur të pretendojë se një ligj shkel të drejtat e tij, në mungesë të një mase individuale zbatimi, nëse atij i kërkohet të modifikojë sjelljen e tij ose rrezikon të ndiqet penalisht ose nëse ai është anëtar i një klase njerëzish që rrezikojnë të preken drejtpërdrejt nga ky legjislation (shih, për shembull, *Tãmase kundër Moldovisë* [GC], nr. 7/08, paragrafi 104, Gjykata 2010, dhe referencat e cituara në të, dhe *Michaud kundër Francës*, nr. 12323/11, paragrafi 51, Gjykata 2012)

371. Në lidhje me çështjen në fjalë, Gjykata vëren se proceset ishin të udhëhequra dhe përfunduan në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Institucionet e rivlerësimit nuk morën asnjë vendim në lidhje me të drejtën e kërkueses për të ushtruar profesionin e avokatit; ata nuk bënë as ndonjë referencë, qoftë edhe në mënyrë të nënkuptuar, në dispozitat e ligjit për avokatinë. Për më shumë, kërkuesja pohoi se ajo kishte një licencë për të ushtruar profesionin e avokatit. Në këto rrethana, Gjykata vëren se ajo nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të saj sipas nenit 8 të Konventës.

372. Fakti që kërkuesja pretendon se mund të bëhet viktimë e mundshme në të ardhmen për shkak të rrezikut të heqjes të së drejtës së avokatisë, në përputhje me ligjin për avokatinë (shih paragrafin 208 më lart), është thjesht një dyshim ose hamendësim nga ana e saj. Deri më sot ajo nuk është prekur nga një vendim i pafavorshëm individual i marrë kundër saj. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ajo është e lirë që të kundërshtojë përpara një gjykate çdo vendim të pafavorshëm që Dhoma e Avokatisë mund të marrë kundër saj në të ardhmen, dhe kështu t'i sigurojë Shtetit të paditur mundësinë për të korrigjuar çdo shkelje të pretenduar të të drejtave të saj sipas Konventës, siç kërkohet nga neni 35/1 i Konventës. Për më shumë, kërkuesja nuk tregoi që fusha e zbatimit e ligjit për avokatinë ishte drejtuar posaçërisht kundër gjyqtarëve ose prokurorëve ndaj të cilëve ishte dhënë një vendim gjatë procesit të rivlerësimit (për krahasim dhe në kontrast *Tãmase*, cituar më lart, dhe *Sejdić dhe Finčić kundër Bosnjës dhe Hercegovinës* [GC], nr. 27996/06 dhe 34836/06, GJEDNJ 2009). Për ta përmbledhur, kërkueses nuk do t'i kërkohet që të modifikojë ndonjë sjellje sipas ligjit për avokatinë; ajo do t'u nënshtrohet kërkesave ligjore të këtij ligji.

373. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se, për rrethanat e çështjes në fjalë, ky pretendim është i papajtuësëm *ratione personae* dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Themeli

374. Gjykata do të shqyrtojë tani nëse për shkak të shkarkimit nga detyra të kërkueses ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private, dhe nëse po, nëse ndërhyrja ishte e justifikuar.

1. Nëse ka pasur ndërhyrje

a) Parashtrimet e palëve

375. Kërkuesja pretendoi që vendimi për ta shkarkuar atë nga detyra kishte përbërë ndërhyrje sipas nenit 8 të Konventës.

376. Në funksion të parashtrimeve të saj në lidhje me moszbatimin e nenit 8 të Konventës, Qeveria u shpreh se nuk kishte pasur asnjë ndërhyrje në çështjen në fjalë.

b) Vlerësimi i Gjykatës

377. Në funksion të sa parashtruar në paragrafët 363 dhe 364 më lart në lidhje me zbatimin e nenit 8 të Konventës, Gjykata vlerëson se, si rezultat i shkarkimit të saj nga detyra, ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private (shih, për shembull, *Özpinar*, cituar më lart, paragrafët 47-48 dhe *Kulykov dhe të tjerët kundër Ukrainës*, nr. 5114/09 dhe 17 të tjerë, paragrafi 138, 19 janar 2017).

378. Ndërhyrja e sipërpërmendur është në shkelje të nenit 8 të Konventës nëse nuk mund të justifikohet sipas paragrafit 2 të nenit 8 si “në përputhje me ligjin”, duke ndjekur një ose më shumë nga qëllimet legjitime të renditura në të dhe duke qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për të arritur qëllimin ose qëllimet e synuara (shih *Jankauskas kundër Lituanisë* (nr. 2), nr. 50446/09, paragrafi 71, 27 qershor 2017).

2. Nëse ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin”

a) Parashtrimet e palëve

379. Kërkuesja parashtrroi që dispozitat ligjore të ligjit nr. 84/2016 nuk kishin qartësi dhe mundësi qasje në to. Në veçanti, kishte një mungesë qartësie në lidhje me metodën e përdorur nga institucionet e rivlerësimit për të përlllogaritur shpenzimet e jetesës dhe udhëtimit. Gjithashtu, ligji nr. 84/2016 nuk përmbante një përkufizim të frazës “ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë”. Interpretimi dhe zbatimi i tij i jep një hapësirë të gjerë diskrecioni institucioneve të rivlerësimit. Në lidhje me marrjen pjesë të saj në trupën e Gjykatës Kushtetuese e cila kishte shqyrtuar ankimin e paraqitur nga një individ, nuk kishte asnjë rrethanë që të shkaktonte konflikt interesi sipas legjislationit të brendshëm. Në rastin e saj, institucionet e rivlerësimit kishin pasur diskrecion të pakufizuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit nr. 84/2016.

380. Qeveria parashtrroi që dispozitat e ligjit nr. 84/2016 ishin të qarta, të mirë përcaktuara dhe të kuptueshme. Ligji nuk përmbante asnjë kontradiktë dhe dispozitat e tij parashikonin siguri, qartësi dhe vazhdimësi. Koncepti i ligjshmërisë së pasurive ishte i mirënjohur në legjislationin e brendshëm, qoftë në ligjet që lidhen me deklarin e pasurive apo në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave. Që një pasuri të konsiderohet e ligjshme, duhet të përmbushen dy kushte: të ardhurat e përdorura për krijimin ose përfitimin e tyre duhej të buronin nga një veprimtari e ligjshme, dhe të ardhurat duhet t'i ishin nënshtruar pagimit të taksave ose detyrimeve përkatëse. Përmbushja kumulative e këtyre dy kushteve parashikohej qartë në nenin D të Kushtetutës dhe në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016.

381. Sipas qeverisë, baza për gjetjen e një deklariimi të pamjaftueshëm të pasurive ishte deklarata e rivlerësimit kalimtar. Sipas nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33, një deklariim i pamjaftueshëm i pasurisë ndodh nëse konstatohet se ka pasur mungesë burimesh financiare, fshehje pasurie, deklariim i rremë i pasurisë ose konflikt interesi. Deklaratat e mëparshme të pasurisë mund të përdoren si prova nga KPK-ja dhe KPA-ja.

382. Qeveria parashtrroi që shpenzimet e jetesës llogariteshin duke iu referuar deklaratës së një individi, provave të marra nga institucionet e rivlerësimit nga institucionet kombëtare dhe të huaja, deklaratat e mëparshme të pasurive dhe provat e mbledhura nga institucionet bankare dhe jobankare. Provat e tilla do t'i nënshtrohen kontradiktoritetit, në përfundim të së cilës subjekti i rivlerësimit ftohet të paraqesë provat e tij ose të saj në mbështetje të pozicionit të tij ose të saj. Të gjitha provat u nënshtroheshin përlllogaritjeve matematikore dhe logjike dhe Komisioni merr një vendim të veçantë në lidhje me secilën çështje, duke pasur parasysh specifikat e saj faktike.

383. Qeveria parashtrroi që përcaktimi nëse një individ kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë rezulton nga shqyrtimi i provave nga institucionet e rivlerësimit.

b) Vlerësimi i Gjykatës

384. Shprehja “në përputhje me ligjin” kërkon, së pari, që masa e kundërshtuar të ketë një bazë në ligjin e brendshëm. Së dyti, ajo i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai të jetë i arritshëm për personin në fjalë dhe i parashikueshëm në pasojat e tij (shih, ndër autoritetet e tjera, *Fernández Martínez kundër Spanjës* [GC], nr. 56030/07, paragrafi 117, Gjykata 2014 (ekstrakte)). Në mënyrë që ligji të përmbushë kërkesën e parashikueshmërisë, ai duhet të përcaktojë me saktësi të mjaftueshme kushtet në të cilat mund të zbatohet një masë, për t'i dhënë mundësi personit në fjalë

– nëse është e nevojshme, me këshillim të përshtatshëm – të rregullojë sjelljen e tij ose të saj (shih, si një shembull së fundmi, *Altay kundër Turqisë* (nr. 2), nr. 11236/09, paragrafi 54, 9 prill 2019).

385. Gjykata vëren se, pas shqyrtimit të kriterëve të rivlerësimit, kërkesja u shkarkua nga detyra për dy shkaqe kryesore. Së pari, për sa i përket vlerësimit të pasurive, u konstatua se ajo kishte bërë deklarament të rremë dhe kishte fshehur apartamentin me sipërfaqe 101 m². Së dyti, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, kërkesja kishte cenuar besimin e publikut duke mos hequr dorë nga shqyrtimi i një ankimi kushtetues. Gjykata do të shqyrtojë më poshtë secilën nga shkaqet për të përcaktuar nëse ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin.

386. Në lidhje me deklaramentimin e rremë dhe fshehjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 101 m², Gjykata vëren se vendimet e institucioneve të rivlerësimit bazoheshin në ligjin nr. 84/2016 dhe legjislationin e mëparshëm për deklaramentimin e pasurive. Ligji nr. 84/2016 jo vetëm që ishte botuar, ai, gjithashtu, i ishte nënshtruar procesit të shqyrtimit kushtetues. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ndërhyrja përmbushte kërkesat cilësore të qasjes në të dhe parashikueshmërisë.

387. Në lidhje me konstatimin se kërkesja kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, Gjykata vëren se edhe pse kjo bazë për shkarkimin nga detyra është formuluar në terma mjaft të gjerë, pasja e një dispozitë të tillë në legjislationin disiplinor dhe rregulloret e disiplinës gjyqësore nuk është e pazakontë. Normalisht kjo dispozitë duhet të lexohet dhe të interpretohet së bashku me rregullat e tjera disiplinore më specifike, në fuqi në atë kohë, duke sanksionuar shkelje të një natyre etike ose profesionale. Në çështjen aktuale, shkaqet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016 u plotësuan me dispozitat ligjore në fuqi në kohën përkatëse që rregullojnë përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të tjerë, përkatësisht neni 36/1/c i ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe neni 72 i KPC-së, të cilit Komisioni dhe Kolegji iu referuan në vendimet e tyre. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se ndërhyrja ishte mjaftueshëm e parashikueshme.

388. Gjykata është e bindur që ndërhyrja në jetën private të kërkeses ishte në përputhje me ligjin, siç kërkohet nga neni 8, paragrafi 2 i Konventës. Prandaj, Gjykata do të shqyrtojë më poshtë nëse ndërhyrja e tillë ndiqte një ose më shumë nga qëllimet legjitime të renditura në nenin 8 paragrafi 2 i Konventës, dhe nëse ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për të arritur qëllimin ose qëllimet e synuara.

3. Nëse ndërhyrja ndiqte një qëllim legjitim

a) Parashtrimet e palëve

389. Kërkesja pretendoi që ndërhyrja nuk kishte ndjekur ndonjë qëllim të ligjshëm. Qëllimi legjitim i paraqitur në parashtrimet e qeverisë, përkatësisht, pastrimi i gjyqësorit nga korrupsioni, mund të ishte arritur me mjete më pak ndërhyrëse, të tilla si trajnimi i detyrueshëm për gjyqtarët. Komisioni Evropian nuk kishte bërë thirrje për të çrrënjësuar korrupsionin me anë të një rivlerësimi të gjerë të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

390. Qeveria, duke iu referuar Raportit të Vlerësimit, parashtroi se ishin identifikuar një sërë problematikash. Këto probleme kishin siguruar nevojën për të futur ndryshime strukturore, të cilat kishin arritur kulmin me ndryshimet kushtetuese dhe miratimin e një sërë ligjesh thelbësore. Qeveria iu referua qëllimeve legjitime që Gjykata Kushtetuese kishte identifikuar në shqyrtimin kushtetues në terma abstraktë të ligjit nr. 84/2016.

b) Vlerësimi i Gjykatës

391. Gjykata vëren se Raporti i Vlerësimit i referohet një numri sondazhesh të perceptimit të publikut dhe të raporteve të shumta, që tregojnë një nivel të lartë korrupsioni në sistemin e drejtësisë (shih paragrafin 4 më lart). Në lidhje me këtë, GRECO-ja kishte theksuar, gjithashtu, shkallën e përhapur të korrupsionit në gjyqësor në raportet e saj që nga viti 2002 (shih paragrafët 217–20 më lart).

392. Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i ligjit nr. 84/2016, siç parashikohet në nenin 1, është të “garantojë funksionimin e duhur të shtetit ligjor, pavarësinë e vërtetë të sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut në institucionet e [atij] sistemi” (shih paragrafët 102 dhe 120 më lart). Komisioni i Venecias u shpreh, gjithashtu, se rivlerësimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve “ishte jo vetëm i justifikuar, por i domosdoshëm për të mbrojtur [vendin] nga murtaja e korrupsionit, i cila, nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor” (shih

paragrafin 96 më lart). Gjykata Kushtetuese shtoi më tej se çdo kufizim i vendosur nga ligji nr. 84/2016 justifikohet nga interesi publik i uljes së nivelit të korrupsionit dhe i rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, i cili, nga ana tjetër ishte i lidhur me interesat e sigurisë kombëtare, rendit publik dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve (shih paragrafin 175 më lart).

393. Në këto rrethana, GJENDJ-ja nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimi i ndjekur nga ligji nr. 84/2016 në përgjithësi, dhe ndërhyrja në çështjen e kërkujes në veçanti, nuk ishte në përputhje me qëllimet e identifikuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, siç përcaktohet në nenin 8, paragrafi 2 (shih, gjithashtu, *Ivanovski*, cituar më lart, 179).

4. Nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”

a) Parashtrimet e palëve

i. Kërkuësja

394. Kërkuësja parashtroi që shkarkimi i saj nga detyra kishte qenë joproportional. Institucionet e rivlerësimit nuk kishin dhënë shkaqet e duhura për të justifikuar shkarkimin e saj nga detyra. Ata nuk kishin konsideruar që ajo ishte përballur me pamundësi objektive për të demonstruar burimet e ligjshme të të ardhurave që bashkëjetuesi i saj i kishte përfituar më shumë se njëzet vjet më parë. Për më shumë, institucionet e rivlerësimit kishin interpretuar gjerësisht ligjin e brendshëm dhe kishin konstatuar padrejtësisht se ajo kishte qenë palë në kontratat e sipërmarrjeve të viteve 2003 dhe 2005.

395. Sipas saj, shpenzimet e jetesës së bashkëjetuesit të saj në vitet ‘90 ishin përcaktuar gabimisht në bazë të të dhënave të Institutit Italian të Statistikave për vitet 2002 deri më 2004. Disa shpenzime udhëtimi i ishin atribuar asaj në mënyrë arbitrare, edhe pse ato ishin për qëllime pune dhe ishin mbuluar nga institucionet pritëse.

396. Institucionet e rivlerësimit kanë tejkuluar kufijtë e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016 dhe e shkarkuan atë, për shkak të deklaratave periodike të pasurive që ajo kishte depozituar pranë ILDKPKI-së, të cilat kishin rezultuar pozitive. Ligji nr. 84/2016 përmbante një përkufizim të frazës “cenimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë”. Interpretimi dhe zbatimi i tij i dha diskrecion të gjerë institucioneve të rivlerësimit. Nuk kishte pasur asnjë situatë që krijonte konflikt interesi sipas legjislacionit të brendshëm. Për më shumë, institucionet e rivlerësimit kishin veçuar vetëm një episod në karrierën e saj 20-vjeçare.

397. Sipas këndvështrimit të kërkujes, nuk kishte mbrojtje procedurale për të parandaluar një zbatim arbitrar të ligjit. Legjislacioni nuk përcaktonte një shkallë të përshtatshme sanksionesh për shkeljet disiplinore dhe nuk kishte rregulla të përcaktuara për të siguruar zbatimin e tyre në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

ii. Qeveria

398. Qeveria parashtroi që kërkuësja i ishte nënshtruar procesit të rivlerësimit, që ishte i ndryshëm nga proceset e zakonshme disiplinore. Detyrimet e saj ligjore për deklarimin e pasurive ishin përfshirë tashmë në ligj që nga viti 2003. Koncepti i ligjshmërisë së pasurive ishte i përcaktuar në legjislacionin e brendshëm, qoftë në ligjet që lidhen me deklarimin e pasurive ashtu dhe në ato që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave. Që një pasuri të konsiderohej e ligjshme, duheshin plotësuar dy kushte: të ardhurat e përdorura për krijimin ose përfitimin e saj duhej të buronin nga një aktivitet i ligjshëm dhe të ardhurat duhet t’i ishin nënshtruar tatimit ose detyrimeve përkatëse. Përmbushja kumulative e këtyre dy kushteve parashikohej qartë në nenin D të Kushtetutës dhe në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016.

399. Ligjvënësi ka parashikuar ekzistencën e pamundësive objektive në marrjen e provave me të cilën do të përballeshin subjektet e rivlerësimit. Kjo për shkak të: i. trashëgimisë së vendit që doli nga një regjim komunist ku nuk paguheshin taksa; ii. ekonomisë informale, e stimuluar nga situata e vështirë ekonomike dhe paaftësia e institucioneve publike; iii. kultura e dobët fiskale dhe ndërgjegjësimi në vend, i cili nuk kishte mekanizma efektivë të zbatimit të ligjit; dhe iv. mungesa e profesionalizmit nga ana e administratës në zbatimin e ligjit.

400. Sipas Qeverisë, baza për gjetjen e një deklarimi të pamjaftueshëm të pasurisë është deklarata për rivlerësim. Sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33, një deklarim i

pamjaftueshëm i pasurive do të bëhej nëse konstatohej se kishte mungesë të burimeve financiare, fshehje të pasurive, deklarim i rremë ose konflikt interesi. Deklaratat e mëparshme të pasurive mund të përdoren si prova nga KPK-ja dhe KPA-ja.

401. Së fundmi, sanksioni i vendosur ndaj kërkueses ishte proporcional me konstatimet e bëra nga institucionet e rivlerësimit, konkretisht, se ajo kishte bërë deklarim të rremë dhe kishte fshehur pasuri, kishte bërë deklarim të pasaktë të pasurive të tjera dhe ishte konstatuar se kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, Shteti kërkon që nëpunësit civilë të jenë besnikë ndaj parimeve kushtetuese mbi të cilat ai ngrihet.

b) Vlerësimi i Gjykatës

402. Gjykata përsërit se çdo ndërhyrje në të drejtën për respektimin e jetës private do të konsiderohet “e domosdoshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim legjitim nëse i përgjigjet një “nevoje të ngutshme shoqërore” dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë janë “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” (shih, për shembull, *Fernández Martínez*, cituar më lart, paragrafi 124, dhe *Dubská dhe Krejzová kundër Republikës Çeke* [GC], nr. 28859/11 dhe 28473/12, paragrafi 174, 15 nëntor 2016). Ndërkohë që u takon autoriteteve të brendshme të bëjnë vlerësimin fillestar të domosdoshmërisë, vlerësimi përfundimtar nëse arsyet e përmendura për ndërhyrjen janë të rëndësishme dhe të mjaftueshme mbetet subjekt i shqyrtimit nga Gjykata për përputhshmëri me kërkesat e Konventës (shih, për shembull, *Polyakh dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 283).

403. Gjykata vëren më tej se shkarkimi nga detyra është një sanksion i rëndë disiplinor – nëse jo më i rëndi – që mund të vendoset ndaj një individi. Marrja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon shqyrtimin e provave të qëndrueshme në lidhje me etikën, integritetin dhe aftësinë profesionale të individit në fjalë.

404. Në lidhje me çështjen në fjalë, siç përmendet në paragrafët 391 dhe 392 më lart, Gjykata vëren se ligji nr. 84/2016 është miratuar në kuadër të Raportit të Vlerësimit dhe Strategjisë së Reformës, si dhe me ndryshimet thelbësore kushtetuese. Ai iu përgjigj niveleve alarmante të korrupsionit në gjyqësor, siç vlerësohet nga legjislatura kombëtare dhe vëzhgues të tjerë të pavarur, dhe nevojës urgjente për të luftuar korrupsionin, i theksuar, gjithashtu, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Gjykata konsideron se, në rrethanat të tilla, një reformë në sistemin e drejtësisë që përfshin rivlerësimin e jashtëzakonshëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë i përgjigjet “nevojës së ngutshme shoqërore”.

405. Pyetja që mbetet për t’u përgjigjur është nëse, në rrethanat e çështjes së kërkuesit, autoritetet vendëse tejkaluan marzhin e vlerësimit të shtetit të paditur. Si pasojë, Gjykata do të shqyrtojë nëse institucionet e rivlerësimit kanë kryer një vlerësim të individualizuar të shkaqeve që çuan në vendosjen e sanksionit disiplinor të shkarkimit nga detyra, konkretisht, vlerësimin e pasurive dhe aftësitë profesionale.

406. Gjykata vëren se institucionet e rivlerësimit shqyrtuan deklaratën e pasurisë për rivlerësim të kërkueses. Në përputhje me ligjin nr. 84/2016, kërkueses iu kërkua të justifikonte burimet e ligjshme fillestare të cilat kishin shërbyer si bazë për përfitimin e pasurive të saj. Gjykata përsërit, se në përputhje me angazhimet në traktate të Shqipërisë, kërkesa për deklarimin e pasurive dhe justifikimin e origjinës së tyre të ligjshme është futur në legjislacionin e brendshëm që nga viti 2003, i cili përmban, gjithashtu, sanksione për mosdeklarimin e pasurive ose deklarimin e rremë të tyre (shih paragrafët 204 dhe 212 më lart). Kjo është arsyeja pse ligji nr. 84/2016, siç konfirmohet më tej nga KPA, ka parashikuar përdorimin e deklaratave të mëparshme të pasurive si prova për të verifikuar vërtetësinë e deklaratës së pasurisë për rivlerësim (shih paragrafët 136 dhe 188 më lart).

407. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m², Kolegji mbështeti konstatimin e Komisionit se kërkuesja kishte bërë deklarim të rremë dhe kishte fshehur pasurinë. Në lidhje me argumentet e saj se institucionet e rivlerësimit kishin keqinterpretuar ligjin, Gjykata vlerëson se u takon në radhë të parë autoriteteve kombëtare dhe, veçanërisht gjykatave, për të interpretuar legjislacionin e brendshëm. Në qoftë se interpretimi nuk është arbitrar ose qartësisht i paarsyeshëm, roli i Gjykatës është i kufizuar në verifikimin e përputhshmërisë me Konventën të efekteve të një interpretimi të tillë (shih, ndër autoritetet e tjera, *Radomilja dhe të tjerët* [GC], cituar më lart, paragrafi

149). Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se dy nga pasuritë e kërkuessit ishin përfituar në bazë të një kontrate sipërmarrjeje, e cila, siç interpretohet nga institucionet e rivlerësimit, ishte – dhe vazhdon të jetë – një nga mënyrat për të përfituar të drejta pronësie sipas legjislacionit në Shqipëri. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave në dokumentacionin e çështjes, institucionet e rivlerësimit arritën në përfundimin se kërkuessa kishte qenë, gjithashtu, palë në kontratat fillestare të cilat kishin shërbyer si bazë dhe kontribuuan në përfitimin e apartamentit me sipërfaqe 101 m² të cilën ajo kishte nuk e kishte deklaruar për vite me radhë, deri në vitin 2011 (shih paragrafët 25 dhe 67 më lart). Gjykata nuk gjen asgjë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme në vendimet e brendshme. Për më shumë, ajo vëren se, sipas Parimeve të Bangalores të Sjelljes Gjyqësore, gjyqtarëve, të cilët, për nga natyra e punës së tyre konsiderohen se janë garantues të sundimit të ligjit, duhet t'u kërkohej të përmbushin standarde veçanërisht të larta integriteti në çështjet e tyre private jashtë gjykatës – “përtej vërejtjeve nga këndvështrimi i një vëzhguesi të arsyeshëm” – në mënyrë që të ruajnë dhe forcojnë besimin e publikut dhe “të rikthejnë besimin e njerëzve në integritetin e pushtetit gjyqësor”.

408. Në lidhje me ekzistencën e të ardhurave të mjaftueshme dhe të ligjshme për blerjen e pasurive fillestare të cilat kishin kontribuar në përfitimin e apartamentit me sipërfaqe 101 m², Gjykata vëren më tej se Kolegji konstatoi që kërkuessa dhe bashkëjetuesi nuk kishin të ardhura të mjaftueshme (shih paragrafin 71 më lart).

409. Në lidhje me konkluzionet për situatën financiare të kërkuesses, Gjykata vëren se Kolegji kreu një rivlerësim të pasurive dhe detyrimeve të saj dhe të bashkëjetuesit të saj, duke konstatuar se atyre u mungonin të ardhurat e ligjshme për të justifikuar likuiditetet. Meqenëse vlerësimi u përqendrua në fakte specifike për shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet e udhëtimit dhe ai u mor në bazë të provave të shqyrtuara nga institucionet e rivlerësimit, detyra e Gjykatës, siç tregohet, gjithashtu, në paragrafin 402 më lart, nuk është të zëvendësojë gjetjet e saj me ato të autoriteteve të brendshme. Gjykata ka marrë parasysh, gjithashtu, konstatimet e Kolegjit për dështimin serioz nga ana e kërkuesses për të deklaruar origjinën e parave në llogaritë e saj bankare jashtë shtetit, pasi nuk kishte asnjë provë të ndonjë transferte bankare, si dhe mosdeklarimin në kohë nga ana e bashkëjetuesit të një shume të madhe parash, në kundërshtim me dispozitat ligjore (shih paragrafët 33, 75 dhe 77 më lart).

410. Për sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji mbështeti konstatimin e Komisionit se dështimi i kërkuesses për të hequr dorë nga një sërë procesesh kushtetuese kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Duke pasur parasysh vendimet e dhëna nga KPK-ja dhe KPA-ja, si dhe rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata vlerëson se, për shkaqet e dhëna më poshtë, institucionet e rivlerësimit nuk kanë dhënë arsye të përshtatshme për të justifikuar një gjetje të tillë. Në radhë të parë, babai i kërkuesses ishte anëtar i një gjykate apeli e cila kishte vendosur për ndjekjen penale të disa individëve të caktuar, të dënuar për falsifikim dokumentesh në shkallën e parë, e cila ishte parashkruar. Për këtë shkak, trupi gjyqësor i gjykatës së apelit nuk shqyrtoi themelin e çështjes dhe nuk vendosi për akuzën e falsifikimit të dokumenteve. Për sa i përket kërkuesses, ajo shqyrtoi një ankim kushtetues në lidhje me një grup të veçantë procesesh civile. Së dyti, meqenëse as ajo dhe as babai i saj nuk kishin ndonjë konflikt tjetër personal interesi në asnjërin prej procedurave, Gjykata nuk është e bindur që institucionet e rivlerësimit demonstrojnë mjaftueshëm ekzistencën e dyshimeve në lidhje me paanësinë e kërkuesses. Gjykata është e ndërgjegjshme që, ndërkohë që Shtetet palë janë të detyruara të organizojnë sistemin e tyre ligjor në mënyrë që të sigurojnë përputhshmëri me kërkesat e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke qenë padyshim paanshmëria një nga më kryesoret mes atyre kërkesave, përjashtimi automatik i një gjyqtari që ka lidhje gjaku me një gjyqtar tjetër i cili ka marrë pjesë në një seri tjetër procesesh në lidhje me një ose të gjithë palët në gjykim nuk kërkohej gjithmonë, veçanërisht për një vend me madhësinë e Shqipërisë (shih, për zbatimin e këtij parimi, *Dorozhko dhe Pozharskiy kundër Estonisë*, nr. 14659/04 dhe 16855/04, paragrafi 53, 24 prill 2008; *Ramljak kundër Kroacisë*, nr. 5856/13, paragrafët 29–42, 27 qershor 2017; *Nicholas kundër Qipros*, nr. 63246/10, paragrafët 62–65, 9 janar 2018; dhe *Koulias kundër Qipros*, nr. 48781/12, paragrafët 61–66, 26 maj 2020). Së treti, nuk

ka asnjë indikacion që palët në proceset kushtetuese kundërshtuan pjesëmarrjen e kërkueses në trupën gjyqësore, edhe pse ajo mbante të njëjtin mbiemër me atë të babait të saj.

411. Pavarësisht nga shkaqet e mësipërme, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të kërkueses, Gjykata konsideron se gjetjet e Kolegjit në lidhje me vlerësimin e pasurisë, siç përshkruhen në paragrafët 407–409 më lart dhe të marra në mënyrë kumulative, ishin mjaftueshëm të rënda sipas legjislacionit kombëtar dhe mund të justifikojnë edhe më vete shkarkimin e kërkueses nga detyra.

412. Gjykata konsideron më tej, se, duke pasur parasysh gjetjet e individualizuara të gjykatave kombëtare në paragrafët 407–409 më lart, shkarkimi i kërkueses nga detyra e saj si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese ishte proporcional. Në të vërtetë, ligji nr. 84/2016 parashikon dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullim me detyrimin për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm. Gjykata ka konsideruar, ndër të tjera, se mungesa e një shkalle të përshtatshme sanksionesh për shkelje disiplinore mund të jetë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit (shih *Oleksandr Volkov*, paragrafi 182). Në lidhje me këtë, Gjykata duhet të theksojë se ligji për Gjykatën Kushtetuese parashikon një hierarki më të hollësishme sanksionesh disiplinore, siç përshkruhet në paragrafin 200 më lart, i cili vendoset në përfundim të procesit të zakonshëm disiplinor. Sidoqoftë, procesi i rivlerësimit ka natyrë *sui generis*, me gjithë ngjashmëritë që duket se ka me proceset e zakonshme disiplinore. Ai është miratuar në përgjigje të pranisë së perceptuar të përhapur të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në mënyrë që ta largojë elementet e korruptuara dhe të ruajë pjesën e shëndetshme të sistemit. Në rrethanat e jashtëzakonshme që i paraprijnë miratimit të ligjit nr. 84/2016, siç theksohet, gjithashtu, në paragrafët 391, 392 dhe 404 më lart, Gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh, në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016.

413. Gjykata vëren më tej se, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, shkarkimi i kërkueses nga detyra passjell një ndalim të përjetshëm për t'u rifutur në sistemin e drejtësisë. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se gjyqtarët, dhe posaçërisht ata që zënë pozicione që sjellin një shkallë të lartë përgjegjësie, siç janë pozicionet në të cilat kërkuësja dëshiron të rifillojë punësimin, kanë një pjesë të pushtetit sovran të Shtetit. Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga Shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (shih, *mutatis mutandis*, *Naidin kundër Rumanisë*, nr. 38162/07, 21 tetor 2014, paragrafi 54–55, që kishte të bënte me natyrën absolute të ndalimit të një ish-bashkëpunëtori të policisë politike për t'u punësuar në shërbimin publik; për kontrast, *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, nr. 55480/00 dhe 59330/00, paragrafi 58, Gjykata 2004 VIII; *Rainys dhe Gasparavičius kundër Lituanisë*, nr. 70665/01 dhe 74345/01, paragrafi 36, 7 prill 2005; dhe *Žičkus kundër Lituanisë*, nr. 26652/02, paragrafi 31, 7 prill 2009, në lidhje me kufizimet e një personi për të gjetur punë në sektorin privat). Kjo është veçanërisht e tillë në kontekstin kombëtar të konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës.

414. Duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkueses.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

415. Së fundmi, kërkuësja pretendoi se nuk kishte pasur asnjë mjet efektiv juridik, siç kërkohet nga neni 13 i Konventës, në lidhje me pretendimin e saj sipas nenit 8.

Neni 13 i Konventës parashikon si vijon:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

416. Gjykata vëren se, në lidhje me çështjen në fjalë, kërkuësja ankimoi vendimin e KPK-së që urdhëronte shkarkimin e saj nga detyra. Kolegji i Posaçëm i Apelit, që kishte juridiksion të plotë mbi çështje faktike dhe ligjore, shqyrtoi themelin e ankimit të saj, duke përfshirë pretendimin për parregullsi në shkarkimin e saj nga detyra. Fakti që KPA-ja rrëzoi ankimin e saj nuk është e

mjaftueshme që Gjykata të vendosë se ky nuk ishte një mjet i efektshëm juridik (shih, ndër autoritetet e tjera, *Amann kundër Zvicrës* [GC], nr. 27798/95, paragrafi 89, 16 shkurt 2000).

417. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se ky pretendim duhet të rrëzohet si haptazi i pabazuar, në përputhje me paragrafët 3/a dhe 4 të nenit 35 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA:

1. *Vendosi*, në mënyrë unanime, si të papranueshëm ankimin sipas nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mungesën e paanshmërisë së anëtarëve të caktuar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe ankimin sipas nenit 13, në lidhje me mungesën e pretenduar të mjeteve juridike efektive përkundrejt shkarkimit nga detyra të kërkuases.

2. *Vendosi*, me shumicë votash, si të papranueshëm pretendimin, sipas nenit 8 të Konventës në lidhje me ndalimin e përjetshëm të ushtrimit të profesionit.

3. *Vendosi*, në mënyrë unanime, si të papranueshëm pjesën tjetër të aplikimit.

4. *Vendosi*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës, në lidhje me mungesën e pretenduar të pavarësisë dhe paanësisë së organeve të rivlerësimit.

5. *Vendosi*, me pesë vota pro dhe dy kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me parregullsinë e pretenduar të procesit.

6. *Vendosi*, me pesë vota pro dhe dy kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mungesën e pretenduar të seancës publike para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

7. *Vendosi*, me pesë vota pro dhe dy kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me shkeljen e pretenduar të parimit të sigurisë ligjore.

8. *Vendosi*, me pesë vota pro dhe dy kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 9 shkurt 2021, në zbatim të nenit 77, paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores së GJENDJ-së.

Milan Blaško Paul Lemmens
Sekretar Kryetar

Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 45 të Konventës dhe paragrafin 2 të nenit 74 të Rregullores së GJENDJ-së, këtij vendimi i bashkëlidhen mendimet e mëposhtme të veçanta:

- a) mendim pakice i Gjyqtar Serghides;
- b) mendim pakice i Gjyqtar Dedov.

MENDIM PAKICE I GJYQTAR SERGHIDES

1. Kjo çështje ka të bëjë me shkarkimin e kërkuases nga detyra si gjyqtare, pasi kish shërbyer në pozicione të ndryshme gjyqësore për më shumë se pesëmbëdhjetë vitesh – pozicioni i saj i fundit ishte në Gjykatën Kushtetuese – pas vendimit të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe, më pas, në apel, nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në bazë të ligjit të posaçëm për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (ligji nr. nr. 84/2016) – i njohur si “ligji i vetingut” – duke kundërshtuar aftësinë e saj financiare për të përfituar pasuri të caktuara.

Duket se pasuritë e përfituar nga kërkuësja së bashku me bashkëshortin e saj përbëheshin nga dy apartamente banimi me sipërfaqe rreth 101 m² dhe 59 m², dhe truall prej rreth 222 m², gjithashtu, u konstatua se ata zotëronin një shumë të caktuar pasurish në likuiditete. Megjithatë, duhet të theksohet se si kërkuësja, ashtu edhe bashkëshorti i saj kishin punuar për vite me radhë; kjo nuk do të thotë që kërkuësja, duke qenë gjyqtare, nuk do t'i nënshtrohej ndonjë procesi rivlerësimi.

Duhet të theksohet që në fillim se nuk kishte të dhëna për kërkuësen për sjellje të pahijshme, apo të kish qenë shkaktare e të ndonjë dhënie të gabuar apo mohimit të drejtësisë apo të ndonjë shkeljeje tjetër disiplinore.

2. Me gjithë respektin, por nuk mund të pajtohem me pikat 4–7 të dispozitivit të vendimit që nuk konstaton asnjë shkelje të nenit 6/1 të Konventës dhe deklaroj se ka pasur një shkelje të kësaj dispozite.

3. Ligji i vetingut e shpreh qartë, në veçanti nenet 5, 41 (1), 63 dhe 66, që të dy organet gjyqësore të rivlerësimit, konkretisht, KPK-ja dhe KPA-ja, janë përbërës apo elemente absolutisht të nevojshme dhe të domosdoshme të sistemit të rivlerësimit të krijuar sipas këtij ligji.

4. Me sa duket, hartuesit e ligjit të vetingut kishin për qëllim që si KPK-ja ashtu edhe Kolegji i Apelit të ishin “gjykata të krijuara me ligj”, sipas kuptimit të nenit 6/1, të pajisur me kompetencën për të shqyrtuar çështjet e besuara atyre, duke përfshirë shkarkimin e një gjyqtari nga detyra, siç bënë të dy organet gjyqësore të rivlerësimit në rastin e kërkueses.

5. Në ndryshim nga vendimi dhe gjykimi i bërë, ky mendim pakice do të argumentojë që KPK-ja nuk mund të konsiderohet një “gjkate e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 6/1 të Konventës.

6. Duke vepruar gjithmonë si i njëjti organ rivlerësimi, KPK-ja, përveç funksionit të saj për të shqyrtuar dhe vendosur mbi themelin e një “akuze”, e cila synon të shkarkojë një gjyqtar nga detyra, ka shumë funksione të tjera paralele sipas ligjit nr. 84/2016, të cilat përfshijnë kryerjen e një hetimi paraprak administrativ, inkuadrimit dhe nisjen e procedurave administrative (“akuza”), duke bërë gjetje paraprake dhe duke ftuar subjektin të vërtetojë të kundërtën e barrës së provës dhe të paraqesë prova për të kundërshtuar rezultatet. Me përlësi pohoj se këto lloj funksionesh, nga vetë natyra e tyre, veçanërisht çelja e procedurave administrative, nuk mund ta bëjnë një organ, i cili, gjithashtu, dëgjon dhe vendos mbi një çështje, me kompetenca të tilla drastike që mund të jenë shkatërruese për karrierën dhe jetën personale të një gjyqtari, një “gjkate të krijuar me ligj” të paanshme sipas kuptimit të nenit 6/1. Ekziston një parim i përgjithshëm i mirëvendosur ligjor: “*nemo potest esse simul aktor et iudex*” (13 Gjykata e Lartë 327, që do të thotë se askush nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe paditës edhe gjykatës). Me gjithë respektin e duhur, një organ i tillë, i nisur për të qenë një përbërës i domosdoshëm i procesit të vetingut, që nga krijimi i tij sipas ligjit të vetingut, pra, që nga gjeneza e tij, u “dënuar” me mungesë pavarësie dhe paansie institucionale dhe si rezultat edhe objektive dhe prandaj nuk mund të konsiderohet një “gjkate e krijuar me ligj” sipas nenit 6/1 të Konventës.

7. Një organ gjyqësor nuk mund të konsiderohet një “gjkate e krijuar me ligj” nëse krijimi apo funksionimi i tij është në kundërshtim me Konventën; dhe nëse një organi gjyqësor i mungon pavarësia dhe paansia institucionale, siç bëri KPK-ja në çështjen në fjalë, atëherë kjo bie ndesh me nenin 6/1 të Konventës. Kushtet e “pavarësisë” dhe “paansisë”, duke iu referuar një “gjkate të krijuar me ligj” në nenin 6/1, nuk janë vetëm kërkesa të veçanta dhe të domosdoshme të së drejtës për një proces të drejtë të parashikuar shprehimisht në atë dispozitë, por, gjithashtu, janë edhe përbërësit e nevojshëm të kushtit për një “gjkate të krijuar me ligj” në të njëjtën dispozitë. Për ta thënë ndryshe, kushtet e “pavarësisë” dhe “paansisë” janë cilësi të brendshme dhe të pandara të lidhura ngushtë me vetë ekzistencën e një “gjkate të krijuar me ligj”.

8. Siç edhe është shpalosur në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës* ([GC], nr. 26374/18, 1 dhjetor 2020), shprehja “gjkate e krijuar me ligj” sipas nenit 6/1 të Konventës “pasqyron parimin e shtetit të së drejtës i cili është i natyrshëm në sistemin e mbrojtjes të vendosur nga Konventa dhe protokollet e saj dhe që përmendet shprehimisht në preambulën e Konventës (po aty, paragrafi 211). Në këtë çështje, Gjykata theksoi vazhdimisht se “ligji”, nën kuptimin e nenit 6/1 të Konventës, përfshin jo vetëm legjislacionin që parashikon krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore, por edhe çdo dispozitë tjetër të ligjit të brendshëm. Kjo përfshin, në veçanti, dispozitat në lidhje me pavarësinë e anëtarëve të një gjkate dhe paanshmërinë e tyre” (po aty, paragrafi 212). Gjykata theksoi, gjithashtu, se (po aty, paragrafi 232):

“... një organ gjyqësor i cili nuk plotëson kërkesat e pavarësisë ... nuk mund të karakterizohet madje as si një “gjkate” sipas parashikimeve të nenit 6/1. Po ashtu, kur përcaktohet nëse një “gjkate” është “krijuar me ligj”, referimi “në ligj” përfshin çdo dispozitë të ligjit të brendshëm – përfshirë, në veçanti, dispozitat në lidhje me pavarësinë e anëtarëve të një gjkate...”.

9. Çështja në fjalë është edhe më e rëndë se ajo e *Guðmundur Andri Ástráðsson* për sa u përket fakteve të saj dhe ndikimit të mungesës së paansisë dhe pavarësisë në kushtet për një “gjkate të

krijuar me ligj”, sepse ndryshe nga ajo çështje, ku problemi qëndronte te pjesëmarrja e një gjyqtari emërimi i të cilit ishte dëmtuar nga diskrecioni i panevojshëm ekzekutiv pa rishikim dhe korrigjim efektiv nga një gjykatë vendëse, në rastin aktual mungesa e paanësisë dhe pavarësisë së KPK-së nuk ishte diçka që prekte vetëm subjektin dhe faktet e çështjes në fjalë; ishte mungesë paanësie institucionale dhe funksionale.

10. Për më tepër, situata e pakëndshme e përmendur më sipër për mungesë të pavarësisë dhe paanësisë institucionale apo funksionale nga ana e KPK-së, e cila buronte nga vetë ligji nr. 84/2016, nuk mund të korrigohej ose kompensohej me anë të një vendimi nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit për një çështje të caktuar, si, për shembull, për çështjen në fjalë, por vetëm nga ligjvënësi, një herë e mirë, duke lënë jashtë kompetencave të KPK-së çdo pushtet që thjesht nuk ishte në përputhje me kompetencat e tij gjyqësore.

11. Ishte parashtruar se pa një gjykatë të shkallës së parë “të krijuar me ligj”, themeli i të gjithë sistemit të vetingut do të shembej. Në këtë rast do të përdor dy shprehje ligjore latine të cilat mund t’i përshtaten argumentin që parashtrohet këtu: “*parte quacunque integrante sublata tollitur totum*” (nëse hiqet një pjesë përbërëse, tërësia do të priset – shih 9 publikimet e Sir Eduard Coke, 41); dhe “*sublato fundamento cadit opus*” (nëse do të hiqni themelin, struktura do të bjerë – shih Jenkins, *Centuries or Reports*, 106).

12. Si rezultat, shkak u kryesor për konstatimin e shkeljes së nenit 6/1 në çështjen aktuale, për mendimin tim modest, është vetë ligji nr. 84/2016, i cili i mohoi kërkuarit apo çdo kërkuar me një situatë të ngjashme, të kishin një gjykim të drejtë përpara një “gjykatë të krijuar me ligj”.

13. Pa dyshim që, funksioni dhe roli i gjykatës së apelit është të ushtrojë, në apel, kompetencën e saj për të ndryshuar ose jo një vendim të një gjykatë të një niveli më të ulët. Kur një sistem ligjor, siç është sistemi i rivlerësimit në Shqipëri, synon të ketë dy nivele gjykatash; një kërkesë e domosdoshme që shkakton ushtrimin e kompetencës ose pushtetit të gjykatës së apelit është paraqitja e një “ankimi”, i cili është i pakonceptueshëm pa ekzistencën e një “gjykatë të shkallës së parë të krijuar me ligj”. Për këtë arsye, kam dyshime të forta nëse Kolegji i Posaçëm i Apelit në çështjen në fjalë apo në sistemin e rivlerësimit në përgjithësi, mund të kishte një funksion, rol dhe kompetencë në boshllëk, ose nëse KPA-ja mund të qëndrojë i vetëm në atë sistem ligjor, nëse nuk do të kishte një “gjykatë të shkallës së parë të krijuar me ligj” sipas nenit 6/1, dhe si rezultat nëse nuk do të kishte asnjë ankim të vlefshëm institucional të paraqitur përpara tij.

14. Do të ishte një paradoks, dhe sigurisht nuk do të ishte roli i një gjykatë apeli, të veprojë si gjykatë e shkallës së parë dhe gjykatë e shkallës së dytë në të njëjtën kohë – pavarësisht se mund të ketë ndonjë kompetencë më të gjerë apo juridiksion më të plotë që mund t’ia ketë dhënë ligji.

15. Neni 6/1 nuk i detyron shtetet anëtare të krijojnë një sistem gjykatash apeli (shih, *ndër të tjera, Çështjen “në lidhje me disa aspekte ligjore për përdorimin gjubësor në sistemin arsimor në Belgjikë”* (mbi themelin), 23 korrik 1968, f. 33, paragrafi 9, seria A nr. 6). Megjithatë, nëse një shtet krijon gjykata të tilla apeli, këto gjykata nuk mund të ekzistojnë dhe të funksionojnë pa ekzistencën e një “gjykatë të shkallës së parë të krijuar me ligj”. Kjo sepse, funksionimi i gjykatave të apelit do të ishte në kundërshtim me ligjin që i ka themeluar ato dhe si rezultat edhe në kundërshtim me nenin 6/1 të Konventës.

16. Nëse KPK-ja nuk do të ishte një “gjykatë e shkallës së parë e krijuar me ligj”, jo vetëm që nuk do të kishte asnjë ankim të vlefshëm të paraqitur përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit, por nuk do të kishte edhe “akuzë” të vlefshme, pasi gjithçka që trajtohet nga KPK-ja do të ishte e parregullt dhe e pavlefshme. Nëse, nga ana tjetër, KPA-ja do të angazhohej, gjithashtu, në ngritjen e “akuzës”, atëherë e njëjta çështje e mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë institucionale si ajo e KPK-së do të ekzistonte edhe për Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

17. Duhet të sqarohet se ky parashtrim i imi nuk nënkupton se Gjykata apo Kolegji i Apelit nuk ekziston apo nuk funksionon ligjërisht në sistemin gjyqësor shqiptar në përgjithësi. Ajo që unë po argumentoj, është se një gabim rrënjësor apo një parregullsi në paanshmërinë dhe pavarësinë e KPK-së, duke mos e lejuar atë të konsiderohet “një gjykatë e krijuar me ligj” në sistemin shqiptar të rivlerësimit, mund të ketë një ndikim dëmtues në sistemin në tërësi, duke rezultuar në zhveshjen e KPA-së nga funksioni, roli dhe kompetencat brenda sistemit dhe, për këtë arsye, edhe duke mos e

lejuar të konsiderohet një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas nenit 6/1. Dhe, natyrisht, një sistem i cili bie, për shkak të mungesës së një “gjykate të krijuar me ligj”, institucionalisht të pavarur dhe të paanshme, nuk mund të jetë një sistem efektiv.

18. Në këndvështrimin tim modest, një sistem rivlerësimi i cili është rrezuar institucionalisht dhe rrenjesisht, siç edhe është parashtruar më sipër, dhe që ka rezultuar në përfundimin e karrierës profesionale të një gjykatësi të rangut të lartë dhe me përvojë, nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me standardet e Konventës.

19. Nga ana tjetër, nëse kërkesat e pavarësisë dhe paanësisë nuk do të konsideroheshin si pjesë përbërëse e kushtit për një “gjykatë të krijuar me ligj”, siç sugjerohet më lart në çështjen e *Guðmundur Andri Ástráðsson* (cituar më lart), atëherë asnjëri prej këtyre dy organeve gjyqësore të rivlerësimit, KPK-ja dhe KPA-ja, nuk do të kishte ndonjë problem për të mos qenë një “gjykatë e krijuar me ligj” në bazë të parashikimeve të nenit 6/1. Kështu që çështja nëse kërkesat e paanësisë dhe pavarësisë janë apo jo elementet përbërëse të kushtit për një “gjykatë të krijuar me ligj”, nuk është vetëm në teori, por mund të kenë pasoja serioze praktike nëse në një çështje të caktuar ka pasur apo jo shkelje të nenit 6/1. Qëndrimi në fjalë, siç edhe është miratuar nga Gjykata në rastin e *Guðmundur Andri Ástráðsson* (po aty) favorizon më shumë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe ‘viktimën’ e pretenduar sesa mbajtjen e një qëndrimi të kundërt. Dikush mund të argumentojë se qasja e ndjekur nga Gjykata në atë çështje të Kolegjit të Lartë mund të mbështetet fuqimisht nga parimi i efektivitetit – një parim kryesor i Konventës që mbështet çdo dispozitë të Konventës që siguron një të drejtë njerëzore – si në cilësinë e saj si një normë e së drejtës ndërkombëtare dhe si metodë interpretimi (shih për këtë parim në të dy cilësitë e tij, paragrafët 15–19 të mendimit tim paralel në çështjen e *Mubamed dhe Mubamed kundër Rumanisë* [GC], nr. 80982/12, 15 tetor 2020).

20. Për ta përmbledhur dhe për ta sqaruar më tej, ky mendim argumenton se: a) se parimi i efektivitetit mbështet qasjen e miratuar nga Gjykata në çështjen e *Guðmundur Andri Astráðsson* (cituar më lart), ku kërkesat e pavarësisë dhe paanësisë janë komponentët e nevojshëm të kushtit për një “gjykatë të krijuar me ligj” në bazë të parashikimeve të nenit 6/1 të Konventës; dhe b) se parimi i përmendur do të vihej në rrezik nëse kërkesa e nenit 6/1 për një “gjykatë të krijuar me ligj” do të interpretohej dhe zbatohet në mënyrë të tillë që të mbulonte: i. një organ i cili ishte institucionalisht, që nga ligji i themelimit të tij, i predispozuar të mos ishte i pavarur dhe i paanshëm për shkak të faktit të akumulimit brenda kompetencës së tij, përveç funksioneve gjyqësore, funksione të tjera të papajtueshme me të parën; dhe ii. një kolegji apelimi brenda një sistemi ligjor që synon në mënyrë specifike të vendosë për “ankimet” që vijnë nga një organ gjyqësor që i mungon pavarësia dhe paanësia institucionale.

21. Për më tepër, sipas meje, duke qenë se seanca publike përpara KPK-së nuk mund të konsiderohet si një seancë publike para një “gjykate të krijuar me ligj”, dhe duke qenë se Kolegji i Posaçëm i Apelit – pavarësisht nëse ishte apo jo “gjykatë e krijuar me ligj” – nuk mbajti një seancë publike, kërkesa e nenit 6/1 për një seancë të tillë në çështjen në fjalë nuk u përmbush dhe për këtë arsye ka pasur shkelje të kësaj dispozite bazuar në sa më sipër.

22. Për fat të keq, sipas këndvështrimit tim modest, ndërsa qëllimi i ligjit nr. 84/2016, siç përmendet në nenin 1 të atij ligji, ishte “të garantonte funksionimin e duhur të shtetit të së drejtës, pavarësinë e vërtetë të sistemit gjyqësor, si dhe rikthimin e besimit të publikut në institucionet e [atij] sistemi” (shih paragrafin 120 të vendimit), në fund të fundit mund të thuhet se rezultoi se ligjit i mungonte në vetvete ajo se çfarë ai synonte të parandalonte. Kjo është një pasojë shumë serioze në një fushë të ligjit që është shumë e ndjeshme në Shqipëri, por, në të njëjtën kohë, mund të ketë, gjithashtu, pasoja për sundimin e ligjit në përgjithësi, duke përfshirë, sigurisht, administrimin e drejtësisë, pavarësinë e gjyqtarëve dhe ndarjen e pushteteve.

23. Pasi kam arritur në përfundimin se nuk pati një “gjykatë të krijuar me ligj” për të dëgjuar dhe vendosur mbi themelin e çështjes së kërkuësës, nuk e konsideroj të nevojshme të merrem me dy shkaqet e tjera të ngritura nga kërkuësja në lidhje me mungesën e pavarësisë dhe paanësinë e KPK-së, që janë, se: i. ishte i përbërë nga anëtarë jogjyqtarë të cilët nuk kishin profesionalizmin dhe përvojën e duhur, dhe ii. se anëtarët e KPK-së u emëruan nga parlamenti pa u përfshirë fare anëtarë nga sistemi gjyqësor.

24. Siç ka bërë edhe kolegu im i nderuar, gjyqtari Dedov, në mendimin e tij të pakicës, bashkëlidhur vendimit për çështjen në fjalë, edhe unë do të doja t'i referohesha asaj që Gjykata vuri në dukje në çështjen *Baka kundër Hungarisë* [GC], 20261/12, paragrafi 172, 22 qershor 2016, që ka të bëjë me parimin e mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve si një element kryesor për ruajtjen e pavarësisë së tyre.

“Për më tepër, edhe pse kërkuesi qëndroi në detyrë si gjyqtar dhe kryetar i një seksioni civil të ri të *Kúria*, ai u shkarkua nga posti i kryetarit të Gjykatës së Lartë tre vjet e gjysmë përpara përfundimit të afatit të caktuar sipas legjislacionit në fuqi në kohën e zgjedhjes së tij. Kjo vështirë se mund të pajtohet me vëmendjen e veçantë që duhet t'i kushtohet natyrës së funksionit gjyqësor si një degë e pavarur e pushtetit shtetëror dhe parimit të mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve, i cili – sipas jurisprudencës së Gjykatës dhe instrumenteve ndërkombëtarë dhe atyre të Këshillit të Evropës – është një element kryesor për ruajtjen e pavarësisë gjyqësore... Në këtë kontekst, duket se largimi i parakohshëm i kërkuesit nga pozicioni i tij si Kryetar i Gjykatës së Lartë, më shumë sesa i shërbeu, rrëzoi vetë qëllimin e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit”.

25. Referenca duhet t'i bëhet edhe çështjes së *Kamenos k. Qipros* (nr. 147/07, 31 tetor 2017). Në këtë çështje, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) në Qipro kishte akuzuar, gjykuar dhe dënuar kërkuesin duke e shkarkuar nga posti i tij gjyqësor. Gjykata konstatoi shkelje të parimit të paanësisë dhe, për këtë arsye, ajo arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 6/1. Shprehimisht, Gjykata është shprehur (paragrafi 109):

“Për këtë arsye, Gjykata konstaton se duke u bazuar në faktet e çështjes dhe duke marrë parasysh parregullsitë funksionale që ajo ka identifikuar, paanësia e Gjykatës së Lartë ishte qartësisht e dyshimtë. Ajo çka kërkuesi druante në këtë drejtim mund të konsiderohet si objektivisht e justifikuar.

26. Vendimi i *Kamenos* (po aty) mbështet mendimin e propozuar se KPK-ja nuk ishte një gjykatë e paanshme, pasi, përveç gjykimit dhe vendimit mbi çështjen e kërkueses, ishte, gjithashtu, e angazhuar në ngritjen e “akuzës” kundër saj. Mungesa e paanshmërisë në rastin e KPK-së është në një nivel më të lartë sesa në rastin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në çështjen *Kamenos*, pasi në çështjen që pasoi, gjyqtari hetues/relator për veprën e pretenduar disiplinore nuk ishte anëtar i KLD-së, por një gjyqtar tjetër, kryetari i atëhershëm i Gjykatës së Rrethit të Nikosias. Për më tepër, ndryshe nga KPK-ja dhe KPA-ja në sistemin e rivlerësimit në Shqipëri, KLD-ja ishte e vetmja gjykatë në Qipro që merrej me procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve, e përbërë nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, duke qenë kështu gjykata më e lartë në vend. Duhet të theksohet se në çështjen *Kamenos* u shqyrtua vetëm çështja e dyshimit në lidhje me paanësinë e KLD-së. Çështja nëse KLD ishte një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas parashikimeve të nenit 6/1, nuk u ngrit dhe diskutua fare. Kështu që nuk mund ta nënkuptojmë se çështja *Kamenos* ndan ekzistencën e një “gjykate të krijuar me ligj” nga paanësia dhe pavarësia e tij. Gjithsesi, vendimi dhe gjykimi i dhënë në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson* (cituar më lart) nga Kolegji i Lartë dhe parimi i tij, siç shpjegohet më sipër, domethënë që një organ gjyqësor nuk mund të karakterizohet si një “gjykatë e krijuar me ligj” në kuptimin e nenit 6/1 nëse nuk përmbush kërkesat e paanësisë dhe pavarësisë, duhet të merret parasysh edhe në rastin konkret.

27. Nën dritën e sa është parashtruar më lart, për mua është e qartë që jo vetëm që nuk janë përmbushur kërkesat e nenit 6/1, kërkesat për një “gjykatë të krijuar me ligj” kërkesat për një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme”, si dhe kërkesat për një “seancë publike”, por ka pasur, gjithashtu, mospërmbushje të testit për një “proces të rregullt” dhe për të mbështetur parimin e sigurisë ligjore, gjithashtu, të parashikuar në atë dispozitë. Të gjitha kërkesat e mësipërme mund të konsiderohen si përbërës të domosdoshëm ose aspekte të së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 6/1 dhe kurdo që ndonjëra prej tyre nuk përmbushet, e drejta në fjalë do të shkelet. Sa i përket mungesës së sigurisë ligjore, unë mbështes pikëpamjet e kolegut tim të shquar, gjyqtarit Dedov, në mendimin e tij të pakicës për çështjen në fjalë.

28. Pra, duke adresuar ankimin e ngritur ndaj nenit 8, me gjithë respektin, unë nuk pajtohem me pikën 8 të dispozitivit të vendimit në të cilin është shprehur se nuk është konstatuar asnjë shkelje. Sipas mendimit tim, vendimet e KPK-së dhe KPA-së ishin shkatërruese për jetën profesionale të

kërkueses me pasoja të rënda edhe për jetën e saj private. Unë mendoj se ka një shkelje të nenit 8 të Konventës pasi nuk u parashtruan shkaqe dhe arsye të mjaftueshme për shkarkimin e kërkueses nga detyra. Si rezultat, për mendimin tim, nuk u zhvillua asnjë test i balancës së drejtë dhe nuk u zbatua parimi i proporcionalitetit. Dhe përsëri, siç edhe kam parashtruar disa herë, shkarkimi i kërkueses nuk është bërë nga një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 6/1 të Konventës në mënyrë të tillë që kjo shkelje e Konventës e ka bërë edhe më të rëndë ndikimin e vendimeve të organeve gjyqësore të rivlerësimit në jetën profesionale dhe private të kërkueses.

29. Unë do të propozoja që kërkueses t'i jepej një shpërblim për dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar, si dhe kostot dhe shpenzimet e bëra nga ajo për qëllim të këtij procesi, shumën e të cilave nuk është e nevojshme ta përcaktoj duke qenë se jam në pakicë.

30. Me shpresën se kjo çështje do të ofrojë një mundësi që sistemi i rivlerësimit në Shqipëri të rishikohet dhe përmirësohet duke mbështetur, *ndër të tjera*, pavarësinë dhe paanshmërinë institucionale të KPK-së, dhe në këtë mënyrë ta bëjë atë të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 6/1 të Konventës.

MENDIM PAKICE I GJYQTARIT DEDOV

1. Ndjej keqardhje për vendimet e marra kundër kërkueses, e cila u shkarkua nga pozicioni i gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese në vend, në kontekstin e një fushate antikorrupsion ose të ashtuquajturit proces rivlerësimi. Kam dyshime serioze nëse procedura e rivlerësimit, në funksion të rrethanave të çështjes në fjalë, ishte në përputhje me standardet e Konventës.

2. Jam i mendimit se vendimi u mor pa vendosur një ekuilibër midis interesit publik dhe masave mbrojtëse që synojnë mbrojtjen e imunitetit gjyqësor, pavarësinë dhe mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve. Gjykata ka theksuar (shih *Baka kundër Hungarisë* [GC], nr. 20261/12, 23 qershor 2016, paragrafi 172) rëndësinë e “parimit të mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve, i cili – sipas jurisprudencës së Gjykatës dhe instrumenteve të Këshillit të Evropës – është një element kryesor për ruajtjen e pavarësisë gjyqësore”.

3. Kërkuesja është një gjyqtare e zakonshme e cila nuk ishte përfshirë në ndonjë skandal apo aktivitet korruptiv. Ajo nuk kishte lidhje apo kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar. Për të nuk kishte ndonjë të dhënë për sjellje të pahijshme, shkaktare të dhënies së gabuar apo mohimit të drejtësisë që mund të ketë cenuar besimin e publikut në Gjykatën Kushtetuese. Për sa u përket aftësive profesionale, karriera e saj gjyqësore prej gati 25 vjetësh dhe emërimi në Gjykatën Kushtetuese të vendit më lejojnë të them se kërkuesja është një ndër specialistet më të kualifikuara në vend.

4. Për më tepër, kërkuesja nuk përfitoi ndonjë pasuri të tepruar, të atillë që të krijonte prova të besueshme dhe dyshime të arsyeshme për korrupsion, të cilat do të lejonin organet ta shkarkonin atë nga funksioni gjyqësor. Pasuria më e vlefshme që kërkuesja përfitoi, së bashku me bashkëjetuesin e saj, që nga fillimi i karrierës së saj si gjyqtare në vitin 1995 ishte apartamenti i banimit prej 101 m² me vlerë 61,050 euro (pjesa kryesore e së cilës u mbulua nga shitja e një apartamenti paraprak në shumën prej 56,000 euro). Meqenëse organet në vend nuk ishin të kënaqur me përputhshmërinë e dokumenteve që tregonin burimet e saj të të ardhurave, atyre iu duk joreale, që dy specialistë të kualifikuar (kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj) të fitonin dhe të kursenin rreth 5,000 euro brenda 13 vjetësh (1992–2005); apo të përftonin 61,050 euro brenda 25 vjetësh karrierë.

5. Ky përfundim, në kontekstin e mungesës së arsytimit dhe masave mbrojtëse kundërpeshuese, ngre dyshime në lidhje me objektivitetin e procesit të rivlerësimit. Organet rivlerësuese nuk morën parasysh mungesën e një ndryshimi thelbësor midis të ardhurave dhe pasurive si një faktor kundërpeshimi që anon në favor të kërkueses.

6. Arsyeja për akuzën e bërë është paksa e habitshme – deklarimi i rremë dhe fshehja e apartamentit të banimit – pavarësisht se bashkëjetuesi i saj e kish deklaruar këtë apartament menjëherë pas blerjes në vitin 2005 dhe kërkuesja e deklaroi këtë apartament më vonë në vitin 2011 kur titulli i saj i pronësisë u regjistrua zyrtarisht dhe shumë kohë para fillimit të procesit të rivlerësimit në vitin 2018. Siç e dimë, deklarimi i pasurisë nga bashkëjetuesi është një mbrojtje e

rëndësishme indirekte për të siguruar që vetë gjyqtarja nuk ishte e përfshirë në korrupsion dhe kjo mbrojtje nuk u mor parasysh nga vendimmarrësit.

7. “Mospërputhje” të tjera të vërejtura nga organet e rivlerësimit janë aq të vogla sa që nuk janë të mjaftueshme për të shkarkuar një gjyqtar nga detyra. Në çdo rast, gjetjet në çështjen në fjalë nuk mbështesin korrupsionin në shkallë të gjerë të deklaruar nga këto organe. Në lidhje me këtë, argumenti se gjyqtarëve u kërkohet të përmbushin standarde veçanërisht të larta integriteti për mënyrën sesi menaxhojnë çështjet e tyre private – ky argument është bërë për të mbështetur vendimin e organeve kombëtare – është i vështirë të pranohet si i rëndësishëm për qëllimin e procesit të rivlerësimit, përkatësisht, për luftën kundër korrupsionit. Duke marrë parasysh vlerësimin e aftësive profesionale të kërkueses dhe gjyqtarëve të tjerë pa pasur nevojë për ndonjë arsye të besueshme, mund të konkludojmë se qëllimi i procesit të rivlerësimit ishte shumë më i gjerë sesa thjesht lufta kundër korrupsionit dhe se organet tejkaluan marzhin e tyre të vlerësimit. Vlen të përmendet se pothuajse të gjithë gjyqtarët e gjykatave të larta të vendit u hoqën nga pozicionet e tyre. Mos vallë asnjëri prej tyre nuk arriti të përmbushte standardet e larta të integritetit?

8. Më duhet të përmend disa garanci të tjera mbrojtëse që duhen marrë në konsideratë në mbrojtjen e integritetit dhe mosheqjes nga detyra të kërkueses si gjyqtare: siguria ligjore dhe seancat publike. Më shqetëson shumë siguria ligjore dhe vërej një problem sistematik këtu, sepse kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj duhej të paraqisnin dokumente shumë të vjetra – të para 25 viteve – shumica e tyre nga Italia. Për më tepër, një barrë e tillë e ashpër prove iu kalua kërkueses dhe bashkëjetuesit të saj pa ndonjë mbrojtje siç është afati i parashkrimit. Përfundimi i shumicës se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës nuk është në përputhje me parimet dhe analizën e mëtejshme të bërë nga Gjykata në vendimin Oleksandr Volkov (*Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, nr. 21722/11, GJEDNJ 2013, në veçanti paragrafi 137). Do të sillja ndërmend se në atë rast kërkuesi u mor në pyetje në lidhje me ngjarjet që kishin ndodhur 6–7 vjet para procedimit disiplinor dhe Gjykata gjeti një shkelje në atë rast. Këtu është propozuar që të arrihet në një përfundim të kundërt edhe pse kërkuesi u vendos në një situatë shumë më të vështirë (kishin kaluar më shumë se 20 vjet, mungesë e dyshimit të arsyeshëm për sjellje të pahijshme).

9. Në vendimin e saj për çështjen *Ramos Nunez De Carvalho e Sá kundër Portugalisë* ([GC], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, 6 nëntor 2018, në veçanti, paragrafët 179, 190 dhe 191) Gjykata vendosi disa parime dhe evidentoi situata ku seancat publike ishin të nevojshme, për shembull, kur rrethanat kërkojnë që gjykata të krijojë përshtypjen e saj për palët ndërgjyqëse duke u dhënë atyre të drejtën për të shpjeguar situatën e tyre personale. Këta vlejné edhe për çështjen objekt shqyrtimi, duke marrë parasysh: faktin që Kolegji i Posaçëm i Apelit është i vetmi organ gjyqësor brenda procesit të rivlerësimit; seriozitetin e pasojave për kërkuesin; dhe nevojën për të shpjeguar marrëdhëniet e saj komplekse të pronësisë me bashkëjetuesin e saj. Gjithsesi, KPK-ja nuk mund të konsiderohet një gjykatë e pavarur dhe e paanshme pasi ajo ndërthur në të njëjtën kohë hetimin, akuzën dhe kompetencat vendimmarrëse.

10. Nuk jam kundër një procesi rivlerësimi nëse qëllimi i tij i vërtetë është të luftojë korrupsionin. Megjithatë, çështja në fjalë mund t’ju tregojë institucioneve të rivlerësimit se ky proces nuk është optimal. Mund të shërbejë, gjithashtu, për të vendosur standarde të rëndësishme për të ardhmen. Komisioni i Venecias në Opinionin e tij nr. 978/2020 i datës 19 qershor 2020 mbi emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese Shqiptare (CDL-AD (2020) 010) ngriti, gjithashtu, disa shqetësime në lidhje me procesin e rivlerësimit (shih paragrafin 82 të Opinionit):

“Delegacioni mësoi se herë pas here vështirësitë shkaktoheshin nga nevoja për të justifikuar të ardhurat prej shumë kohësh të bashkëshortëve ... gjithashtu, kishte një zbatim tepër të ngurtë të afateve procedurale shumë të shkurtra (dy javë), në disa raste dokumente të certifikuara duhej të merrej nga jashtë”.

Komisioni i Venecias ngriti më tej shqetësime në lidhje me largimin intensiv të gjyqtarëve nga gjykatat e Larta të vendit, gjë që e bëri të pamundur, për shembull, që Gjykata e Lartë të emëronte kandidatë për Gjykatën Kushtetuese. Të gjithë faktorët e përmendur më lart japin përshtypjen se procesi i rivlerësimit nuk është optimal dhe sigurisht që duhet të korrigjohet.